INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

UNFPA

TË RINJTË NË SHQIPËRI

SFIDAT NË KOHËT QË NDRYSHOJNË

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

UNFPA

TË RINJTË NË SHQIPËRI

SFIDAT NË KOHËT QË NDRYSHOJNË

TË RINJTË NË SHQIPËRI: SFIDAT NË KOHËT QË NDRYSHOJNË

Nëntor 2015

Drejtor Botimi:

Dr. Gjergji Filipi

Autorët:

Bart de Bruijn
Dr. Gjergji Filipi
Majlinda Nesturi, INSTAT
Emira Galanxhi, INSTAT

Ndihmuan:

Olgeta Dhono
Alma Kondi
Pranvera Elezi

Përkthimi në shqip:

Lisena Gjebrea

Copyright © INSTAT 2015

Mendimet e shprehura në këtë studim janë përgjegjësi e INSTAT. Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në çdo formë pa autorizim paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Shënim:

Ky publikim është realizuar me ndihmën e zyrës së UNFPA në Shqipëri dhe Qendrës Kombëtare për Studime Sociale (QKSS), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

ISBN: 978-9928-188-34-2

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Bul. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri
Tel: +(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
Fax: +(355) 4 2228300
E-mail: info@instat.gov.al
Web: www.instat.gov.al

Grafika: Eyes advertising

Shtypi: Gent•grafik

PARATHËNIE DHE FALENDERIME

INSTAT në bashkëpunim të ngushtë me UNFPA ka zhvilluar një proces analize të thelluar të të dhënave të Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011, duke i krahasuar ato edhe me tregues të tjerë administrativë apo vrojtime të ndryshme. Në vijimësi të këtij bashkëpunimi është kryer një studim i thelluar mbi rininë për të parë se si të rinjtë përballen me ndryshimet dhe sfidat e kohës.

"Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë", do të shërbejë më së miri për të pasur një vlerësim më të qartë të jetesës së të rinjve shqiptarë, përfshirë popullsinë e grupmoshës 15 deri në 29 vjeç. Kjo fazë e jetës shënon një periudhë me përvoja dhe ngjarje të rëndësishme, duke pëfshirë përfundimin e shkollimit, tranzicionin nga shkolla në tregun e punës, martesën dhe krijimin e familjes, seksualitetin, etj. Sjellja dhe vendimet e përfshira në këto përvoja dhe ngjarje shpesh paraqesin sfida për të rinjtë, në aspektin social, ekonomik dhe emocional. Njëkohësisht, këto zgjedhje në jetë i vendosin të rinjtë në pozicionin e agjentit kryesor të ndryshimit social.

Kjo analizë i bashkohet serisë së analizave të mëparshme që INSTAT ka kryer në bashkëpunim më donatorë të tjerë. INSTAT gjen rastin të shprehë mirënjohje dhe falenderime për kontributin e çmuar të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Qendrës Kombëtare për Studime Sociale (QKSS), INSTAT dhe ekspertëve të tjerë vendas dhe të huaj për këtë botim.

Dr. Gjergji Filipi

Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT

TABELA E PËRMBAJTJES

Kapitulli 1: Hyrje 9

Kapitulli 2: Demografia e të Rinjve 11
2.1 Hyrje 11
2.2 Struktura e popullsisë në vitin 2011 11
2.3 Ndryshimi i popullsisë 12
2.4 Profili demografik i të rinjve 16
2.5 Lindshmëria dhe jetëgjatësia e të rinjve 18

Kapitulli 3: Migracioni 21
3.1 Hyrje 21
3.2 Migracioni shqiptar 21
3.2.1 Emigrantët 21
3.2.2 Migrantët e kthyer 24
3.3 Migracioni ndërkombëtar i të rinjve 26

Kapitulli 4: Familja dhe përbërja e saj 31
4.1 Hyrje 31
4.2 Karakteristikat e Njësisë Ekonomike Familjare 31
4.3 Sjellja ndaj martesës dhe divorcit 34

Kapitulli 5: Kushtet e jetesës 35
5.1 Hyrje 35
5.2 Ndërtesat dhe banesat 35
5.3 Karakteristikat e Banesës 36
5.3.1 Statusi i pronësisë së banesës 36
5.3.2 Aksesi në shërbimet bazë 37
5.3.3 Shfrytëzimi i banesës 38
5.4 Mirëqenia materiale 39
5.4.1 Të rinjtë në varfëri 39
5.4.2 Zotërimi i pajisjeve afatgjata 39

Kapitulli 6: Arsimi 41
6.1 Hyrje 41
6.2 Forcimi i aftësive për jetën: ndjekja e arsimit dhe vitet e shkollimit 41
6.2.1 Ndjekja e arsimit 41
6.2.2 Tërësia e viteve të shkollës 43
6.3 Niveli arsimor dhe braktisja e arsimit 45
6.3.1 Niveli arsimor 45
6.3.2 Të diplomuar në universitete 47
6.3.3 Braktisja e shkollës 47
6.4 Alfabetizmi 48

Kapitulli 7: Punësimi 51

7.1 Hyrje 51
7.2 Përfshirja institucionale në krijimin e punësimit 51
7.3 Në punë apo jo? Pjesëmarrja në tregun e punës 52
7.3.1 Pjesëmarrja në forcën e punës 52
7.3.2 Arsyet e të mos punuarit 52
7.4 Punësimi dhe karakteristikat e punësimit 54
7.4.1 Të rinjtë në punësim 54
7.4.2 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: shumë prej tyre në punësim të pambrojtur 55
7.4.3 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: cilët janë sektorët ku punojnë të rinjtë? 56
7.4.4 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: çfarë profesione kanë ata? 56
7.4.5 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: a janë të përshtatshëm për punën e tyre? 57
7.4.6 Puna e fëmijëve 58
7.5 Burime të pashfrytëzuara për të rinjtë: papunësia dhe nën-punësimi 59
7.5.1 Papunësia dhe nën-punësimi 59
7.5.2 Kohëzgjatja e papunësisë 61
7.6 Tranzicioni në punë të denjë: në kërkim të një pune shpërblyese 61

Kapitulli 8: Shëndeti 63

8.1 Hyrje 63
8.2 Gjendja shëndetësore 63
8.3 Shëndeti riprodhues 65
8.3.1 Përdorimi i kontraceptivëve 65
8.3.2 Aborti 66
8.3.3 HIV/AIDS 68
8.4 Çështje të përgjithshme shëndetësore 70
8.4.1 Duhani dhe përdorimi i alkoolit 70
8.4.2 Aftësia e kufizuar 72
8.5 Vdekshmëria 74
8.5.1 Jetëgjatësia 74
8.5.2 Shkaqet e vdekjes 75

Kapitulli 9: Përmbledhje 77

9.1 Hyrje 77
9.2 Rinia është faktor kyç në ndryshimin demografik 77
9.3 … dhe në migracion 78
9.4 Të rinjtë në tregun e punës: sfida e politikë bërësve 78
9.5 Arsimi: përgatitja për jetën 79
9.6 Shëndeti i të rinjve: zgjedhje kritike 79
9.7 Ndryshimi në strukturën e NjEF-ve 81
9.8 Kushtet e jetesës: duke u përmirësuar, por përsëri të këqija 82

Aneksi 83

Aneksi I Koncepte dhe përkufizime 83
Aneksi II International Standard Classification of Education (ISCED) 85

Referencat 86

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1: Raportet e varësisë sipas censusit dhe vitit të projeksionit 15
Tabela 3.1: Popullsia me shtetësi shqiptare në vendet e përzgjedhura (në mijë) 23
Tabela 4.1: Kryefamiljarët e grupmoshës 15-29, sipas gjinisë dhe gjendjes civile 33
Tabela 6.1: Norma neto e ndjekjes së arsimit (NNN), Norma bruto e ndjekjes së arsimit (NBN) dhe indeksi i barazisë gjinore sipas niveli arsimor dhe gjinisë 42
Tabela 6.2 : Tërësia e viteve të shkollës sipas gjinisë dhe moshës së përzgjedhur 44
Tabela 6.3 : Popullsia 25 vjeç e lart, sipas grupmoshës, gjinisë dhe niveli arsimor (në përqindje)
Tabela 6.4 : Popullsia e të rinjve të grupmoshës 15-29 sipas vitit të censusit, gjinisë dhe sipas nivelit më të lartë të përfunduar të arsimit 45
46
Tabela 7.1: Përqindja e pjesëmarrjes në forcën e punës sipas gjinisë dhe grupmoshës kryesore 52
Tabela 7.2 : Popullsia inaktive e grupmoshës 15-64 sipas grupmoshës kryesore, gjinisë dhe arsyes për inaktivitet (në përqindje) 53
Tabela 7.3: Raporti punësim-popullsi sipas gjinisë dhe grupmoshës kryesore 54
Tabela 7.4: Popullsia në moshë pune sipas statusit në punësim, gjinisë dhe grupmoshës kryesore 55
Tabela 7.5: Popullsia në moshë pune e punësuar sipas aktivitetit ekonomik, gjinisë dhe grupmoshës 56
kryesore 57
Tabela 7.6: Popullsia në moshë pune e punësuar sipas profesionit dhe gjinisë, grupmoshës kryesore
Tabela 7.7: Shkalla e papunësisë, shkalla e papunësisë e lidhur me kohën dhe shkalla e punësimit jo 59
fitimprurës sipas gjinisë dhe grupmoshës kryesore 62
Tabela 7.8: Popullsia e grupmoshës 15-29 vjeç sipas statusit të tranzicionit të tregut 67
Tabela 8.1: Lindje, aborte dhe raporti i aborteve, sipas vitit kalendarik (1994-2011)

LISTA E FIGURAVE

Figura 2.1: Popullsia sipas moshës dhe gjinisë (në mijë) 12
Figura 2.2: Emigrantët shqiptarë 1979-2011, sipas moshës dhe gjinisë (në mijë) 13
Figura 2.3: Përbërja e popullsisë, sipas grupmoshës kryesore, censusit dhe të dhënave të projeksioneve 14
Figura 2.4: Projeksionet e raporteve të varësisë së të rinjve dhe të të moshuarve, 2011-2031 15
Figura 2.5: Mosha mesatare dhe medianë e popullsisë 16
Figura 2.6: Popullsia e të rinjve, sipas vitit të censusit, 1979-2011 (në mijë) 16
Figura 2.7: Projeksionet e popullsisë së të rinjve, sipas grupmoshës, 2011-2031 (në mijë) 17
Figura 2.8: Përqindja e të rinjve ndaj popullsisë gjithsej, sipas qarkut 17
Figura 2.9: Popullsia e të rinjve sipas gjinisë, 1979-2011 18
Figura 2.10: Koeficientët specifikë të lindshmërisë sipas vitit të censusit 19
Figura 3.1: Imigracioni i shtetasve shqiptar për në Gjermani, Greqi dhe Itali, sipas grupmoshës (në përqindje) 22
Figura 3.2: Shqiptarët që aktualisht jetojnë jashtë vendit, sipas gjinisë dhe grupmoshës (2011) (në përqindje) 22
Figura 3.3: Emigrantët shqiptarë 2001-2011, sipas moshës dhe gjinisë (në mijë) 23
Figura 3.4: Migrantët e kthyer prej vitit 2001, sipas moshës dhe gjinisë (në mijë) 25
Figura 3.5: Migrantët e kthyer prej vitit 2001, sipas gjinisë dhe arsyes kryesore të kthimit (në përqindje) 25
Figura 3.6: Migrantë të kthyer, meshkuj dhe femra, të grupmoshës 18-29, sipas arsyeve të përmendura të emigracionit 26
Figura 3.7: Migrantë meshkuj dhe femra të grupmoshës 18-29, sipas momentit në historinë e migracionit dhe sipas statusit në punësim 27
Figura 3.8: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29 sipas vendit të fundit të emigracionit (në përqindje) 28
Figura 3.9: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29 vjeç sipas arsimit të përfunduar përpara dhe gjatë migracionit 28
Figura 3.10: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29, sipas arsyeve të përmendura të kthimit 29

Figura 3.11: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29, sipas qëllimit të ri-emigrimit 29
Figura 4.1: Të rinjtë 15-29 vjeç, sipas moshës dhe përbërjes së NJEF (në përqindje) 32
Figura 4.2: Te rinjtë meshkuj dhe femra 15-29 vjec, sipas moshës dhe lidhjes me personin e referencës (në përqindje) 33
Figura 4.3: Përqindja e popullsisë së martuar në grupmoshën 15-29 sipas gjinisë dhe moshës 34
Figura 5.1: Njësitë Ekonomike Familjare me një ose më shumë pjesëtarë të grupmoshës 15 deri në 29 vjeç dhe njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të grupmoshës 15 deri në 29 vjeç sipas llojit të banesës (në përqindje) 36
Figura 5.2: Njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të moshës 15-29 vjeç sipas statusit të pronësisë së banesës dhe vitit të censusit 36
Figura 5.3: Njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të grupmoshës 15-29 vjeç dhe popullsia e grupmoshës 15-29 vjeç sipas sistemit të furnizimit me ujë dhe llojit të tualetit (2011) 37
Figura 5.4: Përqindja e popullsisë së të rinjve që jetojnë në një banesë të mbipopulluar sipas qarkut, 2001 dhe 2011 38
Figura 5.5: Zotërimi i pajisjeve afatgjata 40
Figura 5.6: Përqindja e popullsisë së të rinjve që jetojnë në NjEF që ka në zotërim pajisjet e specifikuara 40
Figura 6.1: Norma e ndjekjes së arsimit, sipas gjinisë dhe moshës 42
Figura 6.2: Përqindja e të rinjve që ndjekin arsimin sipas grupmoshës 43
Figura 6.3: Norma bruto e regjistrimit në arsimin e lartë, sipas vitit shkollor dhe gjinisë 43
Figura 6.4: Tërësia e viteve të shkollës dhe jetëgjatësia nga mosha 6 vjec për vendet e përzgjedhura 44
Figura 6.5: Të rinjtë e grupmoshës 25-29 vjeç, sipas vitit të censusit, gjinisë dhe sipas nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar (në përqindje) 46
Figura 6.6: Të diplomuar universitarë sipas fushës kryesore të studimit dhe sipas gjinisë (në përqindje) 47
Figura 6.7: Popullsia e grupmoshës 6-29 vjeç që nuk ndjek arsimin, sipas gjinisë, dhe moshës (në mijë); dhe përqindja e braktisjeve të reja sipas gjinisë dhe sipas moshës 48
Figura 6.8: Shkalla e alfabetizmit sipas moshës dhe statusit të ndjekjes së shkollës; përqindja e atyre që nuk kanë ndjekur arsimin, sipas moshës 49
Figura 7.1: Përqindja e pjesëmarrjes së forcës së punës sipas moshës dhe gjinisë 52
Figura 7.2: Popullsia inaktive e grupmoshës 15-29 vjeç sipas gjinisë dhe moshës dhe arsyes së inaktivitetit (në përqindje) 53
Figura 7.3: Norma e mospërputhjes së kualifikimeve të popullsisë me të paktën arsim të mesëm, sipas nivelit më të lartë arsimor dhe sipas vitit të anketimit 58
Figura 7.4: Shkalla e papunësisë së të rinjve sipas nivelit më të lartë arsimor dhe gjinisë 60
Figura 7.5: Përqindja e të papunëve afatgjatë mes të rinjve të papunë sipas arsimit më të lartë dhe sipas gjinisë 61
Figura 8.1: Të rinjtë perceptojnë shëndetin si "të mirë" ose "shumë të mirë", 2002-2012 (në përqindje) 64
Figura 8.2: Të rinjtë sipas gjendjes shëndetësore të vetë-vlerësuar, 2012 (në përqindje) 64
Figura 8.3: Përdorimi aktual i kontraceptivëve nga (a) gra të martuara dhe (b) gra të pamartuara seksualisht aktive (2008-09) (në përqindje) 65
Figura 8.4: Numri i rasteve të raportuara me HIV pozitiv, sipas gjinisë, 1993-2013 68
Figura 8.5: Rastet e raportuara me HIV sipas grupmoshës 1993-2013 (në përqindje) 69
Figura 8.6: Infektimi me HIV i personave të moshës 15-29 vjeç sipas mënyrës së transmetimit, 1993-2013 (në përqindje) 69
Figura 8.7: Përqindja e popullsisë në grupmoshën 15 dhe 49 vjeç që pi duhan sipas gjinisë dhe moshës 71
Figura 8.8: Të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç sipas gjinisë dhe shpeshtisë së konsumimit të alkoolit në muajin përpara intervistës së anketës (në përqindje) 71
Figura 8.9: Përqindja e popullsisë me aftësi të kufizuara të moshës 15 vjeç e lart, sipas gjinisë dhe grupmoshës 72
Figura 8.10: Popullsia me aftësi të kufizuara në moshën 15 vjeç e lart sipas grupmoshës (në përqindje) 73
Figura 8.11: Të rinjtë me aftësi të kufizuara të moshës 15 deri në 29 vjeç, sipas llojit të aftësisë së kufizuar (në përqindje) 73
Figura 8.12: Jetëgjatësia në mosha të ndryshme sipas gjinisë (në vite) 74
Figura 8.13: Të rinjtë që kanë vdekur në moshën 15-29 vjeç sipas shkakut të vdekjes, 2010 (në përqindje) 75

SHKURTIME

ADHS	Studimi Shqiptar për Demografinë dhe Shëndetin
SPOK	Sëmundje Pulmonare Obstruktive Kronike
CPR	Shkalla e Mbulimit me Kontraceptivë
CYP	Vitet e mbulimit me kontraceptivë të popullsisë
PNP	Program i Nxitjes së Punësimit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
DIU	Diapozitiv intrauter
KILM	Treguesit Kyç të Tregut të Punës
AFS	Anketa e Forcës së Punës
SIML	Sistemi i Informacionit dhe Menaxhimit Logjistik
AMNJ	Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës
OZHM	Objektiva të Zhvillimit të Mijëvjeçarit
NCD	Sëmundje jo të Transmetueshme
NEET	Përqindja që nuk është në punësim, arsim ose trajnim
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
IKS	Instituti Kombëtar i Statistikave
CPB	Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011
SDT	Tranzicioni i Dytë Demografik
SMAM	Mosha Mesatare e Martesës së Parë
SST	Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme
ISF	Indeksi Sintetik i Fekonditetit
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Veprimtaritë e Popullsisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

1 HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë një vlerësim të jetesës së të rinjve shqiptarë, përfshirë popullsinë e grupmoshës 15 deri në 29 vjeç. Kjo fazë e jetës shënon një periudhë me përvoja dhe ngjarje të rëndësishme, sidomos ato në lidhje me përfundimin e shkollimit, tranzicionin nga shkolla në tregun e punës dhe martesën dhe krijimin e familjes, seksualitetin, etj. Sjellja dhe vendimet e përfshira në këto përvoja dhe ngjarje shpesh paraqesin sfida për të rinjtë, në aspektin social, ekonomik dhe emocional. Njëkohësisht, këto zgjedhje në jetë i vendosin të rinjtë në pozicionin e agjentit kryesor të ndryshimit social.

Kushtet e jetesës lidhen me shumë aspekte të jetës. Ky raport në mënyrë analitike ndan këto aspekte në kapituj të ndryshëm tematikë, por përpiqet që të theksojë lidhjen e tyre sipas rastit. Për të vendosur kushtet aktuale të jetesës së të rinjve në një këndvështrim më të gjerë, shpesh treguesit për të rinjtë krahasohen me ato të popullsisë më të vjetër në Shqipëri, me ato të të rinjve në vende të tjera të rajonit ose në Bashkimin Europian dhe me ato në periudhave të mëparshme.

Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 përbën shtyllën e analizës. Rezultatet e censusit 2011, kur është e mundur dhe e rëndësishme, krahasohen me rezultatet e censuseve të mëparshme, sidomos me censusin e vitit 2001. Të dhëna administrative të regjistrit civil dhe Ministrisë së Arsimit, si edhe të dhëna nga sondazhe të ndryshme plotësojnë dhe japin më shumë detaje për informacionin e censusit. Në veçanti, rezultatet e Anketës 2013 për Migracionin e Kthimit dhe Riintegrimin, Studimit Shqiptar mbi Demografinë dhe Shëndetin 2008-09 dhe Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2012. Gjithashtu, informacioni është marrë nga Instituti i Shëndetit Publik si edhe nga raporte të ndryshme dhe botime shkencore. Megjithatë, për tema të ndryshme, informacioni i saktë i përditësuar është i pakët. Kjo ndihet veçanërisht në fushën e shëndetësisë dhe sidomos shëndetit riprodhues, i cili është me rëndësi të veçantë për të rinjtë.

Kapitulli 2 për popullsinë dhe demografinë paraqet panoramën e përgjithshme ku veprojnë të rinjtë në Shqipëri. Kapitulli 3 për migracionin lidhet ngushtë me ndryshimin e popullsisë dhe kontributin e rëndësishëm të të rinjve në këtë ndryshim. Kapitulli 4 (sistemimi në banesë) dhe 5 (kushtet e jetesës) trajton kontekstin social dhe material të jetës të të rinjve, ndërsa kapitulli 6 - për arsimin- dhe 7 - për punësimin mbulon dy fusha kryesore të ndërlidhura mes tyre për zhvillimin e jetës së të rinjve. Kapitulli 8 trajton shëndetin e të rinjve dhe sidomos fokusohet në shëndetin riprodhues si një nga fushat kryesore të politikave për të rinjtë. Kapitulli 9 rimerr gjetjet kryesore të raportit në një përmbledhje përmbyllëse.

2 DEMOGRAFIA E TË RINJVE

2.1 HYRJE

Shoqëria shqiptare ka përjetuar ndryshime thelbësore shoqërore në dekadat e fundit përfshirë një ekonomi të modernizuar, individualizëm, simetri në rritje në rolet gjinore dhe organizata më fleksibël. Këto transformime kanë ndikuar në proceset demografike të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit dhe kanë rezultuar në ndryshime të mëdha në përmasat dhe përbërjen e popullsisë. Këto ndryshime janë regjistruar në Censusin e Popullsisë dhe Banesave 2011 i cili tregon rënie të madhe të popullsisë me 8.8 përqind që nga censusi i mëparshëm në vitin 2001 dhe pothuajse 12.0 përqind që nga censusi i vitit 1989. Po njësoj i dukshëm ka qenë ndryshimi në përbërje sipas gjinisë drejt feminizimit të popullsisë dhe sidomos ndryshimi në përbërje sipas moshës i orientuar fuqishëm drejt plakjes. Inercia e shumë prej këtyre proceseve pritet që të ketë ndikim të vazhdueshëm në ritrajtëzimin e popullsisë shqiptare, siç sugjeron projeksioni i INSTAT-it për popullsinë.

Ky kapitull paraqet një vështrim të përgjithshëm të ndryshimit të popullsisë në Shqipëri dhe dinamikën demografike në themel të saj. Prandaj, fokusi vihet në pozicionin specifik të të rinjve, në shkaqet dhe pasojat e këtij ndryshimi. Seksioni 2.2 fillon me një fotografim të popullsisë siç jepet në Censusin e Popullsisë dhe Banesave 2011 dhe seksioni 2.3 e vendos këtë fotografi në një kontekst më të gjerë të ndryshimit të popullsisë, si në të shkuarën, ashtu edhe në të ardhmen. Seksioni 2.4 fokusohet në ndryshimet e profilit demografik të të rinjve dhe seksioni i fundit shtjellon dinamikat specifike të lindshmërisë dhe jetëgjatësisë së të rinjve.

2.2 STRUKTURA E POPULLSISË NË VITIN 2011

Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 regjistroi 2.8 milion banorë në Shqipëri me një numër pothuajse të barabartë mes meshkujve (50,1 përqind) dhe femrave (49,9 përqind). Numri i të rinjve të grupmoshës 15-29 vjeç u llogarit në 704 mijë, duke përfaqësuar vetëm një të tretën (25,2 përqind) e të gjithë popullsisë. Me rreth 363 mijë meshkuj dhe djem të grupmoshës 15-29 vjeç kundrejt rreth 342 mijë femrave dhe vajzave të kësaj grupmoshe, meshkujt me 51,5 përqind janë vetëm pak më shumë të përfaqësuar mes të rinjve krahasuar me të gjithë popullsinë. Mbipërfaqësimi më i madh i meshkujve është në grupmoshën 20-24 vjeç (52,6 përqind kundrejt 47,4 përqind femra).

Popullsia e të rriturve 30-64 vjeç përfaqëson 42.8 përqind të popullsisë, ndërsa të moshuarit 65 vjeç e lart dhe fëmijët nën 15 vjeç përbëjnë segmentin më të vogël të popullsisë me 11,3 dhe 20,7 përqind përkatësisht. *Figura 2.1* paraqet përbërjen e popullsisë sipas gjinisë dhe grupmoshës 5 vjeçare, me grupmoshën e të rinjve të treguar me ngjyra të errëta. Figura tregon që grupmosha e të rinjve 15-29 dhe 20-24 vjeç momentalisht është grupi më i madh i popullsisë.

Figura 2.1: Popullsia sipas moshës dhe gjinisë (në mijë)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Me këtë përbërje të moshës, popullsia e Shqipërisë është mes popullsive më të reja në Europë. Në BE me 28 shtete anëtare, personat nën 15 vjeç përbëjnë vetëm 15.6 përqind të të gjithë popullsisë, por personat e moshuar përbëjnë 18.5 përqind (Eurostat 2015b; të dhënat i referohen 1 janarit 2014). Mosha mesatare e popullsisë së Shqipërisë ka qenë 35.2 vjeç në vitin 2011 dhe mosha medianë[1] ka qenë 32.6 vjeç, ndryshe nga mosha medianë e BE-28SHA me 42.4 vjeç në vitin 2014. Asnjë nga 28 SHA të BE-së nuk është nën moshën medianë të Shqipërisë dhe vendet fqinje gjithashtu përfshirë Malin e Zi dhe Maqedoninë kanë moshë më të lartë. Në rajon, vetëm Kosova ka moshën medianë më të ulët.

Popullsia shqiptare është nga më të rejat në Europë

Raporti total i varësisë[2] tregon nivelin e mbështetjes që i jepet personave më të rinj dhe/ose më të vjetër nga popullsia në moshë pune. Përbërja e moshës e regjistruar në censusin e vitit 2011 tregon që për çdo 100 persona në moshën më produktive ekonomikisht nga 15 në 64 vjeç, 47 persona i përkasin moshës së varësisë 0-14 dhe 65 vjeç e lart. Ky raport total i varësisë me 47 përqind mund të ndahet në raportin e varësisë të moshës së të rinjve[3] me 30 përqind dhe raportin e varësisë së të moshuarve[4] me 17 përqind, ndërsa në 28 SHA të BE-së, raporti i varësisë së të rinjve është më i ulët sesa raporti i varësisë së të moshuarve.

2.3 NDRYSHIMI I POPULLSISË

Rënia e popullsisë nga 3.1 milion në vitin 2001 në 2.8 milion në censusin e vitit 2011 tregon rënie me 8.8 përqind në periudhën e fundit ndërmjet censusit. Ky është përforcim i procesit që u regjistrua në periudhën e mëparshme ndërmjet censusit 1989-2001 ku popullsia ra me 3.5 përqind. Dy proceset demografike kryesore të rënies së lindshmërisë dhe emigracionit në masën që shkaktuan këtë rënie të popullsisë, së bashku me jetëgjatësinë në rritje, kanë ndikuar edhe në përbërjen e moshës së popullsisë së Shqipërisë. Në *Figurën 2.2* ky ndikim i madh u bë i dukshëm duke krahasuar strukturën e popullsisë të vitit 1979 me atë të vitit 2011. Në vitin 1979, grupi më i madh i popullsisë i përkiste moshës 0-24 vjeç, të të lindurve pas vitit 1955. Në vitin 2011, po kjo grupmoshë është moshuar me 30 vjet dhe është zhvendosur në grupmoshën 30-54 vjeç. Megjithatë, për shkak të migracionit në masë në dy dekada

1 Mosha medianë është mosha që ndan popullsisë në dy gjysma të njëjta numerike.
2 Raporti total i varësisë është raporti i popullsisë të moshës 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart me popullsisë e grupmoshës 15-64 vjeç, i shprehur në përqindje.
3 Raporti i varësisë së të rinjve është raporti i popullsisë të moshës 0-14 vjeç me popullsinë e grupmoshës 15-64, i shprehur në përqindje.
4 Raporti i varësisë së të rinjve është raporti i popullsisë të moshës 65 vjeç e lart me popullsinë e grupmoshës 15-64, i shprehur në përqindje.

përpara censusit, këto grupe janë pakësuar ndjeshëm, dhe kjo është veçanërisht e dukshme tek 25-34 vjeçarët. Ndërsa popullsia e të rinjve të grupmoshës 15-29 është numerikisht e njëjtë në vitin 1979 dhe 2011, numri i fëmijëve nën 15 vjeç ka qenë më i madh në vitin 1979 sesa në vitin 2011. Nga ana tjetër, për çdo grupmoshë më të vjetër mbi moshën e të rinjve, shifrat janë rritur shumë krahasuar me vitin 1979, sidomos nga mosha 40 dhe lart.

Figura 2.2: Emigrantët shqiptarë 1979-2011, sipas moshës dhe gjinisë (në mijë)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave në 1979 dhe 2011

Figura 2.3 e vendos zhvillimin e strukturës së moshës në perspektivë afatgjatë dhe më të detajuar, duke dhënë rezultatet e katër censuseve të fundit (1979 deri në 2011) dhe përbërjen e pritshme, bazuar në projeksionet e popullsisë nga INSTAT (INSTAT 2014d; tregohet me ngjyra të lehta). Ndryshimi më i dukshëm në terma absolute (tabela a) është rënia e madhe e numrit të fëmijëve nën 15 vjeç nga 960 mijë në vitin 1979 në 579 mijë në vitin 2011 pas një kulmi në vitin 1898 (1051 mijë). Njëkohësisht, në një popullsi përgjithësisht në rënie, vërehet një rritje e mprehtë e numrit të të moshuarve 65 vjeç e lart nga 136 në 318 mijë. E gjithë popullsia në moshë pune ka mbetur mjaft e qëndrueshme që në censusin e vitit 1989 me mbi 1.9 milion njerëz, por përqindja më e vjetër e 30-64 vjeçarëve është më e madhe sesa popullsia e të rinjve 15-29 vjeçarë: 1.2 kundrejt 0.7 milion, ndërsa në vitin 1979 shifrat absolute kanë qenë pothuajse të njëjta (përafërsisht 750 mijë).

Në terma relative (*Figura 2.3 pjesa b*), profili i popullsisë shqiptare ka ndryshuar edhe më ndjeshëm, duke treguar plakjen e popullsisë gjatë dekadave të fundit. Në vitin 1979, fëmijët nën 15 vjeç kanë qenë grupi më mbizotërues (37 përqind), por përqindja e tyre është ulur në vetëm 21 përqind në vitin 2011. Nga ana tjetër, përqindja e popullsisë së të moshuarve në të njëjtën periudhë më shumë se u dyfishua nga 5 përqind në 11 përqind. Përqindjet e popullsisë të të rinjve dhe të të moshuarve në moshë pune imitojnë të njëjtat pasoja të plakjes, por në një shkallë më të ulët: 30-64 vjeçarët fitojnë epërsi (nga 29 në 43 përqind) dhe të rinjtë humbasin pak epërsi (nga 29 në 25 përqind).

Llogaritjet e INSTAT projektojnë një vazhdimësi të këtyre tendencave në dekadat e ardhshme. Përqindja e fëmijëve do të ulet më tej (në 17 përqind në vitin 2020, gjysma e përqindjes të vitit 1989) dhe ajo e të moshuarve do të trefishohet në 15 përqind krahasuar me vitin 1989. Popullsia në moshë pune do të mbetet e qëndrueshme, por ekuilibri i brendshëm do të zhvendoset më tej nga grupmosha 15-29 e të rinjve në segmentin e grupmoshës 30-64 e më të moshuarve.

Figura 2.3: Përbërja e popullsisë, sipas grupmoshës kryesore, censusit dhe të dhënave të projeksioneve



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave dhe të dhënat e projeksioneve të popullsisë 2011-2031 (INSTAT 2014d)

PROJEKSIONET E POPULLSISË SIPAS INSTAT NË 2011-2031

Projeksionet e popullsisë japin një panoramë të popullsisë në të ardhmen bazuar në një sërë supozimesh për lindshmërinë, vdekshmërinë dhe migracionin.

Projeksionet e popullsisë prodhohen nga INSTAT bazuar në metodën e komponentit të brezit. Shtrirja e projeksioneve kufizohet në 20 vjet deri në vitin 2031 dhe tre skenarë të ndryshme të tendencave të popullsisë japin informacion për masën e pasigurisë. Krahasuar me raundet e mëparshme të INSTAT, raundi i tretë përdor një metodologji pak më të ndryshme për të parashikuar më mirë emigracionin dhe kjo metodologji është më e shpërndarë gjeografikisht sepse rezultatet jepen për çdo qark të Shqipërisë.

Projeksioni i paraqitur në këtë seksion lidhet me atë që quhet "skenari i mesëm" i cili konsiderohet skenari më i mundshëm i tre skenareve.

Me ndryshimin e përqindjeve të grupmoshave të ndryshme, popullsia shqiptare ka hyrë në një periudhë me raport të favorshëm ndërmjet personave në moshë produktive dhe atyre në moshë varësie. Ndërsa në vitin 1979, ka pasur 73 persona në moshë më pak produktive të të rinjve dhe të të moshuarve për 100 banorë në moshë më shumë produktive, në vitin 2011 kjo shifër ka qenë vetëm 47. Me këtë raport të ulët varësie me 47 përqind, Shqipëria ndodhet në mes të dritares së mundësisë ekonomike që shtrihet përafërsisht në fillim të viteve 2020 (shihni Tabela 2.1). Nëse vendi përfiton apo jo nga ky episod i "dividentit demografik" - me një popullsi të madhe që mund të jetë në moshë produktive relative me numrin e vogël të të rinjve dhe të të moshuarve- varet nga masa e zbatimit të politikave të efektshme për të përgatitur si duhet forcën e punës për tregun e punës dhe nëse politika të duhura sociale dhe ekonomike zbatohen për t'ju ofruar njerëzve punë produktive (p.sh. Bloom, Canning dhe Sevilla 2003). Kjo vlen veçanërisht për të rinjtë që kanë nevojë për arsim dhe përvojë dhe vende pune të përshtatshme kur hyjnë në tregun e punës. Nga ana tjetër, zhvendosja e ekuilibrit nga të rinjtë (0-15 vjeç) tek më të vjetrit (65 dhe lart) brenda popullsisë së varësisë, tregon edhe që politikat duhet të fokusohen gjithnjë e më shumë tek të moshuarit që kanë nevojë të mbështeten nga popullsia në moshë pune. Në një periudhë dhjetë vjeçare, raporti i varësisë së të moshuarve tejkalon raportin e varësisë së të rinjve. *Figura 2.4* tregon tendencat e pritshme të të dy raporteve për një projeksion 20 vjeçar përtej censusit të vitit 2011, duke treguar një rënie të vogël në raportin e varësisë së të rinjve dhe një dyfishim të raportit të varësisë së të moshuarve.

Në vitin 2001, fëmijët nën 15 vjeç ishin katër herë më shumë sesa të moshuarit 65 vjeç e lart. Në vitin 2024, të moshuarit do të jenë më shumë se fëmijët.

Tabela 2.1: Raportet e varësisë sipas censusit dhe vitit të projeksionit

Viti	Raporti gjithsej i varësisë	Raporti i varësisë së të rinjve	Raporti i varësisë së të moshuarve
1979	73	64	9
1989	62	54	9
2001	58	46	12
2011	47	30	17
2020	46	26	20
2030	55	25	30
2040	55	21	34
2050	56	20	36
2060	67	21	46

Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave dhe të dhënat e projeksioneve të popullsisë 2011-2060 (INSTAT 2014d)

Figura 2.4: Projeksionet e raporteve të varësisë së të rinjve dhe të të moshuarve, 2011-2031



Burimi: Projeksionet e popullsisë 2011-2031 (INSTAT 2014d)

Implikimet e politikave rrjedhin jo vetëm nga zhvendosjet në përmasat relative të grupmoshave të ndryshme. Edhe ndryshimet në terma absolute mund të kenë implikime të mëdha. Kështu, sistemi arsimor duhet që të përgatitet për një ulje të vazhdueshme të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet arsimore dhe rrjedhimisht ulje të mësueseve, lektorëve dhe shërbimeve. Njëkohësisht, sistemi i shëndetësisë dhe pensioneve duhet të përgatitet për ofrimin më të madh të shërbimit për të moshuarit. Në përgjithësi, kostot e shoqërisë për të mbështetur një person të moshuar janë më të mëdha sesa kostoja mesatare e mbështetjes së një fëmije. Në periudhë afatgjatë, e gjithë forca e punës ndoshta do të kontraktohet për shkak të uljes së popullsisë në moshë pune, një proces që ka filluar tashmë për forcën e punës së të rinjve. Plakja e forcës së punës do të ketë edhe implikime në plotësimin e vendeve të punës që në mënyrë specifike kërkojnë të rinj, si për shembull punët me kërkesa fizike.

Në përgjithësi, mosha medianë e popullsisë së Shqipëri është rritur me 10 vjet që në censusin e vitit 1979, nga 25.2 në 35.2 vjeç (*Figura 2.5*) dhe pritet që të rritet më tej me plakjen e popullsisë. Nëse shohim moshën medianë gjatë periudhës në fjalë, shpejtësia e ndryshimit është rritur siç është rritur nga 3 vjet ndërmjet 1979 dhe 1989 në 6 vjet ndërmjet 2001 dhe 2011.

Mosha medianë e popullsisë shqiptare është rritur me pothuajse 6 vjet ndërmjet dy censuseve të fundit 2001-2011

Figura 2.5: Mosha mesatare dhe medianë e popullsisë



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave dhe të dhënat e projeksioneve të popullsisë 2011-2060 (INSTAT 2014d)

2.4 PROFILI DEMOGRAFIK I TË RINJVE

Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 regjistron 705 mijë persona të moshës 15 dhe 29 të cilët përbëjnë 25 përqind të të gjithë popullsisë shqiptare. Në terma absolute, popullsia e të rinjve është rritur ndërmjet censusit të vitit 1979 dhe 1989 dhe ka arritur shifrën më të lartë në 921 mijë (*Figura 2.6*). Pas censusit të vitit 1989, numri absolut i të rinjve ka rënë si pasojë e proceseve të kombinuara të zëvendësimit nga grupe më të vogla të lindjeve dhe emigracionit në masë.

Figura 2.6: Popullsia e të rinjve, sipas vitit të censusit, 1979-2011 (në mijë)



Burimi: Censuset e Popullsisë dhe Banesave

Sipas skenarit të mesëm të projeksioneve më të fundit të popullsisë (2011-2031), numri i të rinjve (15-29) ka mundësi që të jetë 479 mijë në vitin 2031, pra 260 mijë më pak sesa në vitin 2011.[5] *Figura 2.7* tregon intervalin kohor në ndryshimin e vëllimit për grupmoshën 5 vjeçare të të rinjve shqiptarë. Grupmosha më e re 15-29 vazhdon të ulet, pas rënies së lindshmërisë në dekadat e fundit. Plakja e grupit me më shumë lindje pritet që rritet pak në grupmoshën mesatare 20-24 që pas censusit të vitit 2011, por deri tani edhe ky grup ka filluar të pakësohet. Grupmosha e të rinjve më të vjetër (25-29) do të ndjekë këtë model nga rritja në rënie rreth pesë vjet më vonë, në vitin 2019.

5 Vlerësimi i popullsisë në 1 janar

Figura 2.7: Projeksionet e popullsisë së të rinjve, sipas grupmoshës, 2011-2031 (në mijë)



Burimi: Projeksionet e popullsisë 2011-2031

Shifrat e projektuara të të rinjve që në censusin e vitit 2011 përfaqësojnë ndryshime të konsiderueshme në periudhë kohore relativisht të shkurtër. Kjo do të ketë ndikim të ndjeshëm në furnizimin me studentë në nivelet e larta arsimore dhe furnizimin me fuqi punëtore në vitet e ardhshme. Kështu, ndërsa rreth 483 mijë persona janë në moshë pune 20-29 vjeç në vitin 2015, kjo shifër do të jetë vetëm 324 mijë - 33 përqind më pak- në vitin 2031. Rrjedhimisht do të nevojitet përshtatshmëri nga sistemi arsimor dhe tregu i punës dhe paraprirje nga politikbërësit.

Qarku i Tiranës ka përqindjen më të madhe të të rinjve: 29 përqind- në terma absolute më shumë sesa 202 mijë të rinj. Nisur nga epërsia e popullsisë së përgjithshme të Tiranës krahasuar me të gjitha qarqet (27 përqind), kjo nuk është e papritur. Meqë mundësitë e arsimit dhe punësimit përqendrohen, ka përputhje me pritshmëritë që një numër relativisht i madh i të rinjve të qëndrojë në qarkun e Tiranës. 27 përqind kundrejt mesatares kombëtare prej 25 përqind. Është disi e papritur që edhe qarqet më të largëta dhe më pak të zhvilluara të Dibrës dhe Kukësit kanë përqindje relativisht të madhe të popullsisë së të rinjve (*Figura 2.8*). Kjo ndoshta lidhet me rënien më të ngadaltë të shkallës së lindshmërisë në këto fusha (shihni p.sh INSTAT 2004), që kundërvepron me migracionin dalës relativisht të lartë nga këto qarqe (INSTAT 2014e).

Figura 2.8: Përqindja e të rinjve ndaj popullsisë gjithsej, sipas qarkut



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Gjirokastra dhe Berati kanë përqindje mjaft më të vogël të të rinjve në popullsinë e tyre. Këtu, struktura e moshës së popullsisë është trazuar për shkak të migracionit dalës dhe emigracionit të të rinjve. Nga këndvështrimi i politikave

kjo është situatë shqetësuese sepse pasqyron punësimin e dobët dhe kushtet e përgjithshme të jetesës në këto fusha, por në të njëjtën kohë përqindjen e vogël të popullsisë që është ekonomikisht më produktive dhe e aftë që të mbështesë shifrat më të varura të të moshuarve në komunitet.

Përbërja gjinore e popullsisë së të rinjve tregon një mbipërfaqësim të meshkujve, përveçse për censusin e vitit 2001 (*Figura 2.9*). Ky përjashtim është pasojë e emigracionit në masë të meshkujve gjatë periudhës 1990-2001. Që atëherë emigracioni është bërë më i ekuilibruar në lidhje me gjininë, ndërsa migracioni i kthimit ka përfshirë më shumë meshkuj (shihni gjithashtu Kapitullin 3).

Figura 2.9: Popullsia e të rinjve sipas gjinisë, 1979-2011



Burimi: Censuset e Popullsisë dhe Banesave

2.5 LINDSHMËRIA DHE JETËGJATËSIA E TË RINJVE

Faktorët kryesorë të procesit të plakjes të popullsisë shqiptare janë lindshmëria në rënie (plakja ose "ngushtimi i bazës së piramdës së popullsisë") dhe jetëgjatësia në rritje ("zgjerimi i majës së piramidës"). Rënia e lindshmërisë që ekziston në Shqipëri në dekadat e fundit ndikon sidomos në segmentin e të rinjve në popullsi. Pothuajse 74 përqind e të gjitha lindjeve ndodhin nga gratë e grupmoshës 15-29 vjeç. Kjo përqindje ka mbetur shumë e qëndrueshme në statistikat e regjistrimit të të dhënave jetësore që në vitin 2001, pavarësisht rënies së madhe në nivelin e përgjithshëm të lindshmërisë.[6] Edhe mosha mesatare e lindjes ka mbetur mjaft e qëndrueshme rreth nivelit 27.2 (INSTAT, 2014d, fq 44). Njëkohësisht, Shkalla e Përgjithshme e Lindshmërisë (SHPL)[7] ka rënë nga 2.3 fëmijë për gratë në vitin 2001 në 1.7- shumë më poshtë nivelit të zëvendësimit me 2.1 - në vitin 2011, duke vazhduar rënien e lindshmërisë nga 1960 dhe më tej kur Shqipëria me një SHPL me 7 fëmijë për grua, ka qenë vendi me lindshmëri më të lartë në Europë. Në terma absolute, të dhëna të regjistrimit tregojnë që lindjet nga të rejat nën 30 vjeç kanë rënë ndjeshëm nga 40 mijë në vitin 2001 në 26 mijë në vitin 2014 si efekt i kombinuar i lindshmërisë më të ulët dhe grupit më të vogël të grave në moshë riprodhimi.

Figura 2.10 tregon ndryshimin në nivelin e lindshmërisë sipas vitit të censusit për grupmosha të ndryshme të grave në grupmoshën riprodhuese 15 deri në 49 vjeç. Ajo tregon që rënia e lindshmërisë ndahet mes të gjitha grupmoshave 20-24 vjeç dhe më të vjetra. Analiza e mëtejshme tregon që rënia relative në lindshmërinë e moshës specifike është më e madhe për çdo grupmoshë të njëpasnjëshme. Kështu, për femrat e grupmoshës 20-29 vjeç në vitin 2011, numri mesatar i fëmijëve të lindur prej tyre është 0.6 herë numri i të lindurve nga femrat e të njëjtës moshë në vitin 1989, ndërsa femrat e grupmoshës 40-49 vjeç në vitin 2011 kanë pasur vetëm 0.2 herë numrin e fëmijëve si motrat e tyre të të njëjtës moshë në vitin 1989. I papritur është vëzhgimi i rritjes së vazhdueshme të lindshmërisë nga adoleshentet. Lindshmëria në moshë specifike nën 20 vjeç është rritur nga 0.016 në vitin 1989 në 0.018 në vitin 2001 dhe 0.020 në

6 Në vitet 2002 dhe 2003, kjo shifër është më e vogël, por besohet që kjo lidhet me probleme të të dhënave.
7 Shkalla e Përgjithshme e Lindshmërisë është numri mesatar i fëmijëve që do të lindin të gjallë nga një grua gjatë jetës së saj nëse ajo do të ketë normat aktuale të lindshmërisë specifike për moshën gjatë jetës së saj.

vitin 2011. Edhe pse numrat absolute të lindjeve nga adoleshentët janë relativisht të vogla - 2.8 mijë në vitin 2011- dhe po bien për shkak të shifrave në rënie të grave të grupmoshës 15-19 vjeç, tendenca në rritje e lindshmërisë nga adoleshentet është diçka që kërkon vëmendje nga politikbërësit e fushës së shëndetësisë.

Figura 2.10: Koeficientët specifikë të lindshmërisë sipas vitit të censusit



Burimi: Censuset e Popullsisë dhe Banesave

Jetëgjatësia në rritje është një nga arsyet parësore të rritjes së moshës medianë të popullsisë shqiptare, siç vërehet në seksionin 2.3. Që në vitin 2000, Shqipëria ka bërë progres të mëtejshëm në jetëgjatësinë e saj. Numri i viteve të jetëgjatësisë në lindje për të dyja gjinitë të kombinuara është rritur me rreth 2,5 vjet nga 74,6 vjet në 77,1 në vitin 2014. Jetëgjatësia në lindje është mjaft më e lartë për femrat sesa për meshkujt. Në lindje pritet që gratë të jetojnë 79,4 vjet, 4,6 vjet më shumë sesa meshkujt, që kanë jetëgjatësi 74,8 vjet. Asnjë nga vendet e rajonit të Ballkanit, me përjashtim të Greqisë nuk ka jetëgjatësi më të lartë se ajo e Shqipërisë në vitin 2011: Mali i Zi (76,1), ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (75,1), Rumani (74,4), Serbi (74,4) dhe Bullgari (74,2)[8] Për shkak të niveleve relativisht të larta të vdekshmërisë së foshnjave dhe fëmijëve, Shqipëria duhet të kompensohet me nivelet më të ulëta të vdekshmërisë në mosha më të vjetra, të arrijë pozicionin e saj të përgjithshëm më të favorshëm sa i përket jetëgjatësisë në lindje.

Jetëgjatësia më e madhe në lindje përkthehet gjithashtu në jetëgjatësi më të madhe për të rinjtë. Ndërmjet 2005 dhe 2014 ka pasur rritje me më shumë se 2,9 vjet në jetëgjatësinë e të rinjve që kanë arritur grupmoshën 15-19 vjeç, nga 61,3 në 64,2 vjet. Edhe pse jetëgjatësia e të rejave femra është më e lartë sesa ajo e të rinjve meshkuj, jetëgjatësia e të rinjve meshkuj të grupmoshës 15-19 vjeç është rritur me ritëm disi më të shpejtë sesa ajo e të rejave femra, duke u rritur me më shumë se 3,4 vjet krahasuar me një rritje prej 2,3 vjet për të rejat femra.

8 Burimi: Eurostat (demo_mlexpec)

3 MIGRACIONI

3.1 HYRJE

Migracioni ndërkombëtar ka qenë forcë e rëndësishme për ndryshimin e popullsisë në dy dekadat e fundit. Arsyeja kryesore e rënies së popullsisë e vëzhguar gjatë dy censuseve të fundit është emigracioni në masë i shtetasve shqiptarë. Sipas një studimi të Bankës Botërore, deri në vitin 2005 të paktën një në tre familje ka pasur një pjesëtar të vet jashtë shtetit (Banka Botërore 2007). Disa vite më pas, pothuajse dy në pesë familje kanë pasur të paktën një pjesëtar jashtë vendit. Në Shqipëri, si zakonisht në vende të tjera, migracioni përfshin veçanërisht të rinj të rritur, të cilët migrojnë për arsye punësimi dhe mundësi shkollimi dhe për arsye familjare. Rrjedhimisht, të rinjtë figurojnë në statistikat e migracionit dhe janë kontribuesit kryesor në rënien e regjistruar të popullsisë në Shqipëri.

Ky kapitull fillon me përshkrimin e migracionit në përgjithësi në të shkuarën e afërt të Shqipërisë (seksioni 3.2) me qëllim prezantimin e kontekstit të rolit specifik të migracionit të të rinjve, i cili shtjellohet në seksionin 3.3. Burimi kryesor i të dhënave të përdorura janë censusi i popullsisë dhe banesave 2011 dhe Anketa për migracionin e kthimit dhe ri-integrimin, të kryera nga INSTAT në vitin 2013 (INSTAT dhe IOM 2014). Meqë këto burime mbulojnë vetëm pjesërisht emigracionin, burimet e jashtme janë shtuar për të plotësuar panoramën, sidomos atë nga Eurostat dhe Institutet Kombëtare të Statistikave (IKS). Një pjesë e informacionit të paraqitur këtu është nxjerrë nga publikime të mëparshme të INSTAT për migracionin.

3.2 MIGRACIONI SHQIPTAR

3.2.1 Emigrantët

Emigracioni është arsyeja e vetme kryesore për rënien e popullsisë në Shqipëri përpara vitit 2001 dhe ndërmjet viteve 2001 dhe 2011. Heqja e barrierave ndaj emigracionit dhe trazirat sociale në vitet 1990 gjeneruan valë të njëpasnjëshme emigracioni gjatë këtyre viteve. Disa qindra e mijëra shqiptarë u larguan nga vendi (p.sh Carletoo et al. 2006), një humbje që nuk u kompensua nga imigracioni dhe rritja natyrore. Emigracioni masiv ishte shkaku kryesor për përmbysjen e plotë nga një rritje e përvitshme e popullsisë në periudhën ndërmjet censusit 1979-1989 me 2.0 përqind në një rritje negative (-0.3 përqind në vit) në periudhën pasuese ndërmjet censusit 1989-2001. Në terma absolute, rritja e popullsisë me pothuajse 600 mijë persona e cila u vu re në periudhën ndërmjet censuseve përpara 1989, u kthye në rënie me më shumë se 100 mijë në periudhën pas vitit 1989. Censusi 2011 tregoi që emigracioni ka qenë faktori më i rëndësishëm për humbjen neto të popullsisë me 269 mijë persona ndërmjet 2001 dhe 2011, të shprehur në përqindje si 8.8 përqind e popullsisë në vitin 2001 (INSTAT 2014c). Sipas vlerësimeve indirekte të INSTAT, gjatë kësaj periudhe rreth 482 mijë shqiptarë janë larguar nga vendi, një shifër që është kompensuar vetëm pjesërisht nga imigracioni dhe rritja natyrore.

Një shpjegim për vazhdimësinë e emigracionit mund të kërkohet në karakteristikat e ndryshueshme të emigracionit shqiptar (INSTAT 2014c). Mendohet që gjatë viteve 1990, migracioni është dominuar nga individë të rinj meshkuj që kërkojnë punë jashtë vendit në kohën e trazirave në Shqipëri. Në dekadën e parë të këtij mijëvjeçari, duket se migracioni ka ndryshuar: migracioni akoma dominohet nga të rinj të rritur, por përveç meshkujve, femrat po shkojnë gjithnjë e më shumë jashtë vendit. Është rritur në një farë mase edhe përqindja e fëmijëve dhe ky është tregues i qartë i procesit të bashkimit familjar dhe migracionit për qëllime martesore i cili shpesh ndjek migracionin e hershëm "pionier" të valës së parë të dominuar nga meshkujt. Ky proces i bashkimit familjar dhe migracionit për qëllime martesore mundëson nivele të vazhdueshme të larta të migracionit të paktën për disa vite pas valës së parë të migracionit.

Të dhëna nga Eurostat dhe institutet e statistikave të vendeve të tjera ndihmojnë për ilustrim në lidhje me destinacionet më të rëndësishme europiane. Imigracioni për në Gjermani dhe Greqi në dekadën e fundit përfshin 56 përqind meshkuj dhe për në Itali 51 përqind meshkuj. Migracioni për në Gjermani ndoshta është akoma i orientuar

tek punësimi (dhe studimi), siç tregohet nga përqindja e ulët e fëmijëve. Ndryshe nga këtu, Italia dhe sidomos Greqia kanë një përhapje madhe të grupmoshës që është tregues i migracionit të orientuar tek familja. Kjo përhapje e imigracionit sipas moshës - gjinisë pasqyrohet tek të dhënat për strukturën e popullsisë së shqiptarëve që aktualisht qëndrojnë jashtë vendit, siç raportohet nga Censusi i vitit 2011 (*Figura 3.1*). Kjo përhapje e imigracionit sipas moshës - gjinisë pasqyrohet në të dhëna për strukturën e popullsisë së shqiptarëve që aktualisht qëndrojnë jashtë vendit, siç raportohet nga Censusi i vitit 2011 (*Figura 3.2*).

Figura 3.1: Imigracioni i shtetasve shqiptar për në Gjermani, Greqi dhe Itali, sipas grupmoshës (në përqindje)



Burimi: Eurostat dhe Instituti Kombëtar i Statistikave

Figura 3.2: Shqiptarët që aktualisht jetojnë jashtë vendit, sipas gjinisë dhe grupmoshës (2011) (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Profili i moshës dhe gjinisë së emigrantëve shqiptarë është përshkruar qartë në *Figurën 3.3*. Përqendrimi në moshën e të rinjve të rritur është tipik për modelet e migracionit, por ja vlen të theksohet ekuilibri i drejtë gjinor në popullsinë e emigrantëve. Përgjithësisht, ka më shumë mundësi që meshkujt të largohen nga vendi krahasuar me femrat, por diferenca nuk është shumë e madhe gjatë periudhës ndërmjet censusit të fundit. Kjo bie në kundërshti me modelet e migracionit të vërejtura në vitet 1990 ku meshkujt kanë emigruar më shumë se femrat. Në vitet e fundit, më shumë femra kanë migruar jashtë vendit, më së shumti për qëllim bashkimi familjar, si edhe për studime ose punësim.

Figura 3.3: Emigrantët shqiptarë 2001-2011, sipas moshës dhe gjinisë (në mijë)



Burimi: INSTAT 2014e

Statistika nga Eurostat dhe IKS për vendet europiane tregojnë popullsinë me rreth 988 mijë shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në vitin 2011, popullsia e gjashtë e huaj në BE sipas madhësisë (Eurostat 2011 dhe të dhënat nga IKS dhe baza e të dhënave Eurostat) dhe popullsia e tretë më e madhe e shtetasve jo të BE-së (pas turqve dhe marokenëve). Nëse i shtojmë këtyre shifrave të dhënat e shqiptarëve të lindur në Kanada dhe Australi (10 mijë të tjerë) dhe në Shtetet e Bashkuara (rreth 77 mijë), shifra arrin 1 milion (Aneksi I), që nënkupton se një në katër shqiptarë jeton jashtë vendit.[9]

Gjatë kohës së censusit 2011, Italia dhe Greqia pritën përqindjen më të madhe të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit (mbi 80 përqind). Ato ndiqen nga SHBA, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Belgjika, Franca, Australia, Spanja dhe Austria (*Tabela 3.1*). Kjo shpërndarje e destinacioneve mbështetet nga të dhënat e censusit 2011 të cilat sugjerojnë se rreth 80 përqind e shqiptarëve aktualisht jetojnë jashtë vendit, në Greqi ose Itali.

Tabela 3.1: Popullsia me shtetësi shqiptare në vendet e përzgjedhura (në mijë)

Vendi i qëndrimit	Viti	Numri (në mijë)
Shtetësi shqiptare		
Greqi	2011	480.8
Itali	2011	482.6
Gjermani	2011	10.5
Mbretëri e Bashkuar	2005	10.5
Belgjikë	2011	5.2
Francë	2005	5
Spanjë	2011	1.6
Austri	2009	1.5
Lindur në Shqipëri		
SHBA	2010	77.4
Kanada	2006	7.5
Australi	2006	2.0

Burimi: Eurostat dhe Instituti Kombëtar i Statistikave

9 Duhet të theksohet që shtetësia është një karakteristikë e ndryshueshme, sepse njerëzit mund të fitojnë shtetësinë e vendit të huaj të qëndrimit të tyre. Gjatë viteve 2008-2009, 22.8 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë greke; në Itali 14 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë italiane. Kështu së bashku me një numër të panjohur të shqiptarëve të paregjistruar, popullsia e shqiptarëve jashtë vendit do të ishte më e madhe sesa një milion. Nga ana tjetër, popullsia me shtetësi shqiptare jashtë vendit përfshin një brez të dytë të fëmijëve të lindur jashtë Shqipërisë, të cilët nuk duhet të konsiderohen emigrantë.

Punësimi dhe bashkimi familjar janë arsyet kryesore për emigrimin e shqiptarëve. Për 77 përqind të njerëzve që jetojnë jashtë vendit, por që më përpara kanë qenë pjesëtarë të një familjeje të numëruar në census, punësimi është përmendur si arsyeja kryesore për largimin e tyre nga Shqipëria. Shkollimi ka qenë arsyeja e emigrimit të 7 përqind të tyre dhe arsyet familjare për 13 përqind. Të dhëna nga lejet e qëndrimit të lëshuara për herë të parë në Greqi tregojnë që ato janë dhënë për bashkim familjar. Në Itali, lejet për qëllime familjare kanë qenë më të pakta: 35 përqind, ndërsa 22 përqind janë kategorizuar "për shkaqe të tjera" (të pa studiuara). Përveç migracionit për arsye familjare, migracioni për punësim ose studim ka qenë i vazhdueshëm gjithashtu, ndoshta për meshkuj dhe për femra. Përsëri katër nga dhjetë leje në Itali dhe Greqi në periudhën 2008-2009 janë lëshuar për qëllime punësimi.[10]

Arsyet për emigracionin të raportuara në censusin e vitit 2011 për pjesëtarët e mëparshëm të familjeve janë të ndryshme për meshkujt dhe për femrat. Për 84 përqind të migrantëve meshkuj, punësimi është qëllimi kryesor i lëvizjes; kjo përqindje është më e ulët për femrat - 61 përqind. Nga ana tjetër, shkaqet familjare luajnë rol për një nga katër femra kundrejt 8 përqind të meshkujve. Në përgjithësi shkollimi është një arsye relativisht e vogël për migracionin jashtë vendit, edhe pse më e rëndësishme për femrat (11) sesa për meshkujt (vetëm 6 përqind). Por studentët dukshëm preferojnë disa destinacione më shumë se të tjerat: Gjermania, Franca dhe SHBA janë më të preferuara, ndërsa Greqia qëndron më poshtë mesatares në këtë drejtim.

3.2.2 Migrantët e kthyer

Nisur nga rritja e madhe e numrit të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit gjatë kësaj dekade, migracioni i kthimit nuk mund të jetë shumë i konsiderueshëm. Megjithatë, në censusin e vitit 2011, gjithsej 100 mijë persona raportojnë që janë kthyer nga jashtë që në vitin 2001. Analiza e censusit tregon që kthimi ka qenë në rritje çdo vit, sidomos pas vitit 2008 (INSTAT 2014e). Në përgjithësi, në 15 përqind të banesave në Shqipëri jeton një pjesëtar që ka jetuar jashtë të paktën një herë. Kjo shifër përfaqëson gjashtë përqind të të gjithë popullsisë (172 mijë persona).

Ndërsa disa nga këta migrantë të kthyer vendosen në Shqipëri përgjithmonë, për shumë prej tyre kthimi është i përkohshëm. Në këtë kuptim, migracioni i kthimit i identifikuar në census është një fotografi çasti e migracionit qarkullues të vazhdueshëm. Gjithashtu, shifrat e migracionit bazohen në përkufizimin e pranuar ndërkombëtarisht të një migranti ndërkombëtar si dikush që qëndron jashtë vendit të paktën për një vit. Megjithatë ka mundësi që migracioni shqiptar sidomos në destinacionet e rëndësishme fqinje të Italisë dhe Greqisë të jetë sezonal ose i përkohshëm, sepse njerëzit punojnë dhe qëndrojnë për një pjesë të vitit në Shqipëri dhe pjesën tjetër në Itali ose Greqi, duke lëvizur për shkaqe punësimi dhe familjare. Në këtë situatë, ndikimi i përgjithshëm i migracionit është edhe më i madh sesa tregojnë vlerësimet e mësipërme.

Figura 3.4 tregon që personat që janë kthyer që në vitin 2001 të regjistruar në census janë të përqendruar në grupmoshën 25-39 dhe janë mesatarisht pak më të vjetër sesa migrantët që kanë qenë jashtë vendit në kohën e censusit. Numri i meshkujve që kthehen, krahasuar me gratë që kthehen në Shqipëri është dyfishi, një pasqyrim i dominimit të meshkujve në emigracion gjatë dekadave të fundit. Përfaqësimi i madh i meshkujve mes të kthyerve është sidomos i madh mes personave në moshë pune.

10 Mospërputhja e dukshme ndërmjet të dhënave të censusit dhe lejeve mund të shpjegohet me disa arsye. Përqindja e ulët në census për arsye familjare mund të jetë për shkak të mos raportimit nga familjet ku kanë emigruar të gjithë pjesëtarët. Një tjetër arsye mund të jetë që "puna" mund të jetë raportuar si shkak për vartësit që migrojnë ose që i bashkohen dikujt i cili migron për qëllim punësimi. Lejet zyrtare nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëllimin personal të punësimit: një bashkëshorte mund të marrë leje për bashkim familjar ndërsa motivi i saj personal mund të jetë punësimi.

Figura 3.4: Migrantët e kthyer prej vitit 2001, sipas moshës dhe gjinisë (në mijë)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Në terma numerike, shkaqet e punësimit dhe familjare kanë dominuar në arsyet e kthimit; mungesa e punësimit fillimisht ka qenë shkaku dominues për meshkujt dhe arsyet familjare kanë qenë dominuese për kthimin e femrave (*Figura 3.5*). Duke pasur parasysh vendet nga janë kthyer migrantët, të dhënat e censusit tregojnë që ato përputhen me vendet e emigracionit: Greqia, e ndjekur nga afër nga Italia dhe më pak nga vende të tjera si Mbretëria e Bashkuar, SHBA, Gjermania dhe Turqia.

Figura 3.5: Migrantët e kthyer prej vitit 2001, sipas gjinisë dhe arsyes kryesore të kthimit (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

3.3 MIGRACIONI NDËRKOMBËTAR I TË RINJVE

Figura 3.3 më sipër tregon rolin dominues të të rinjve në migracionin ndërkombëtar në Shqipëri. Grupmoshat 20-24 dhe 25-29 janë më të shumta në numër mes personave që janë vlerësuar se kanë emigruar ndërmjet periudhës së censusit të vitit 2001 dhe 2011. Së bashku me 15-19 vjeçarët, numri i të rinjve që kanë emigruar në këtë periudhë arrin në rreth 225 mijë, pothuajse gjysma (47 përqind) e të gjithë popullsisë së emigrantëve në këtë periudhë.

Anketa për migracionin e kthimit dhe riintegrimin në Shqipëri (INSTAT dhe IOM 2014) jep më shumë detaje për formimin e migrantëve të rinj. Kjo anketë vlerëson se rreth 46 mijë shtetas shqiptarë të grupmoshës 18-29[11] janë kthyer në Shqipëri gjatë periudhës 2009-2013. Duhet të theksohet që objektivi i anketës ishin migrantët e kthyer dhe rezultatet e anketës nuk përfaqësojnë emigrantët që janë akoma jashtë vendit

Mes të kthyerve, gjendja ekonomike është arsyeja mbizotëruese e emigracionit të të rinjve shqiptarë: papunësia, mundësi më të mira punësimi dhe të ardhura më të mira janë tre arsyet kryesore për të emigruar (*Figura 3.6*). Kjo vlen për meshkujt dhe për femrat, por më shumë për meshkujt. Për gra të reja, një arsye tjetër shtesë e rëndësishme - e përmendur nga 43 përqind e të pyeturave femra- është "bashkimi me familjen", që zakonisht i referohet shoqërimit të partnerit mashkull i cili ka ikur jashtë vendit. Arsye të tjera janë përmendur nga pakica e meshkujve dhe femrave në të njëjtën masë. Mbizotërimi i shkaqeve ekonomike konfirmohet nga të dhënat e censusit 2011, ku "punësimi" është arsyeja e 74 përqind personave që janë larguar nga familja për të shkuar jashtë vendit. Arsyeja e dytë më e rëndësishme (për 14 përqind) është ndjekja e mundësive të edukimit jashtë vendit. Fatkeqësisht, kjo arsye nuk është përfshirë në anketën e migracionit të kthimit.

Figura 3.6: Migrantë të kthyer, meshkuj dhe femra, të grupmoshës 18-29, sipas arsyeve të përmendura të emigracionit



Burimi: Anketa e migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013

Rezultatet e migracionit të kthimit konfirmojnë marrëdhënien e ngushtë ndërmjet statusit të personit dhe migracionit, edhe pse marrëdhëniet janë disi të ndryshme për meshkujt dhe për femrat. Të rinj, emigrantë nuk përfshijnë persona - meshkuj ose femra- që kanë pasur punë, si të punësuar apo të vetpunësuar. Përqindja më e madhe (68 përqind e meshkujve dhe 46 përqind e femrave) kanë qenë femra të papuna[12] përpara se të emigronin, në përputhje me rëndësinë e arsyeve ekonomike për migracionin të përmendura më sipër (*Figura 3.7*). Edhe pse 48 përqind e të rinjve meshkuj dhe 28 përqind e të rejave kanë gjetur punësim jashtë vendit, emigracioni nuk është garanci për punësim: gjithashtu 46 përqind e meshkujve dhe 28 përqind e femrave kanë qenë pa punë përpara kthimit në Shqipëri.

11 Anketa nuk përfshin të rinjtë e grupmoshës 15-17.
12 Në anketimin e migracionit të kthimit dhe ri-integrimit, papunësia nuk përkufizohet sipas përkufizimit zyrtar të papunësisë (situata e papunësisë, kërkimi i punës dhe gatishmëria për punë), por siç deklarohet nga të pyeturit.

Figura 3.7: Migrantë meshkuj dhe femra të grupmoshës 18-29, sipas momentit në historinë e migracionit dhe sipas statusit në punësim[a]



Burimi: Anketia e migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013

a Papunësia e deklaruar nga i pyeturi

Shërbimet e riintegrimit përbëjnë elementin themelor të përvojës pas kthimit të të kthyerve. Shumë të rinj të kthyer (35 përqind) mendojnë që këto shërbime duhet të përmirësohen. Megjithatë, një përqindje e lartë e të pyeturve nuk kanë njohuri (30 përqind) për Sportelet e Migracionit ose nuk kanë dijeni për ekzistencën e masave lehtësuese (17 përqind). Vetëm 24 përqind e migrantëve të rinj të kthyer që kanë njohuri për Sportelet e Migracionit u janë drejtuar këtyre sporteleve. Agjencitë u kanë ofruar 43 përqind të këtyre migrantëve mbështetje për karrierën dhe 57 përqind ndërmjetësim ose referim në shërbime të tjera publike ose private.

Grupi i migrantëve të rinj përbën një pjesë tjetër të rëndësishme - rreth një e katërta- të personave që përpara se të shkonin jashtë vendit ndiqnin sistemin arsimor në vend. Vetëm 5 përqind e të rinjve meshkuj kanë vazhduar ose kanë filluar shkollimin në vendin e migracionit, ndërsa tek femrat e reja kjo përqindje është jo më pak se 18. Kjo thekson rëndësinë relative që i kushtohet shkollimit nga femrat, krahasuar me meshkujt (shihni gjithashtu kapitullin 5 për edukimin). Ndryshe nga meshkujt, emigrantet femra përfshijnë edhe një përqindje të rëndësishme (20 përqind) të shtëpiakeve. Kjo përqindje ka mbetur e qëndrueshme për femrat jashtë vendit dhe është rritur në 30 përqind pas kthimit në Shqipëri.

Për migrantët e kthyer, gjetja e një pune jashtë vendit ka qenë ndihmë vetëm e pjesshme dhe e përkohshme. Me kthimin në Shqipëri, përqindja e meshkujve që kanë gjetur punë është rritur nga 7 në 20 përqind, por 66 përqind kanë mbetur të papunë, një përqindje e ngjashme me përqindjen përpara emigracionit. Shumë pak (3 përqind) janë regjistruar përsëri në sistemin arsimor. Për femrat, përqindja e të rejave të papuna ka rënë nga 46 përqind përpara migracionit në 36 përqind pas kthimit. Anketimi sugjeron që përqindja e të rinjve në moshë pune të cilët janë një përvojë migracioni është nën përqindjen e atyre në moshë pune të cilët nuk kanë përvojë migracioni. Për migrantët e kthyer të rinj kjo përqindje është 30 përqind krahasuar me 48 përqind të të gjithë të rinjve meshkuj (shihni gjithashtu seksionin 7.4.1 për punësimin e të rinjve). Shifrat përkatëse për të rejat femra janë 23 dhe 37 përqind.[13] Analiza e mësipërme sugjeron që migrantët e rinj janë në situatë relativisht të pambrojtur me të ardhme relativisht të keqe sa i përket punësimit. Për shumë veta kjo ka qenë e vetmja arsye emigrimi si fillim, por edhe jashtë vendit dhe pas kthimit, ata shfaqen më keq në tregun e punës sesa të rinjtë jo migrantë.

Vendet ku kanë migruar migrantët e kthyer janë të njëjta si ato që raportohen nga migrantët e kthimit në census, edhe pse Greqia (67 përqind) duket se është destinacioni akoma më shumë i preferuar sesa Italia (26 përqind) (*Figura 3.8*). Vende të tjera kanë qenë vende destinacioni vetëm për 7 përqind të migrantëve të rinj të kthyer. Migrantët e rinj zgjedhin përgjithësisht të njëjtat vende destinacioni si emigrantët 30 vjeçarë ose më të rritur. Për këta të fundit, Greqia ka qenë pak më shumë e preferuar dhe Italia disi më pak.

13 Duhet të theksohet që raportet e mësipërme punësim - popullsi për migrantët e kthyer madje mbivlerësojnë vlerat e vërteta, sepse anketimi i migracionit të kthimit ka përjashtuar grupmoshën 15-17 e cila priret të jetë më pak e përfshirë në punësim sesa të rinjtë më të vjetër.

Figura 3.8: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29 sipas vendit të fundit të emigracionit (në përqindje)



Burimi: Anketa e migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013

Shumica e migrantëve të rinj kanë përfunduar arsimin e mesëm (50 përqind) ose të lartë (36 përqind) përpara se të largoheshin nga vendi dhe më pak se 3 përqind kanë përfunduar studimet universitare (*Figura 3.9*). Një në katër të rinj migrantë kanë qenë studentë përpara se të shkonin jashtë vendit dhe një pakicë ka shkuar jashtë vendit si studentë, sidomos migrantet femra (shihni *Figurën 3.7*). Rezultatet e sondazhit të migracionit sugjerojnë që një përqindje e vogël, por e rëndësishme e migrantëve të rinj ka përfunduar arsimin e avancuar jashtë vendit, ndërsa përqindjet e atyre që kanë përfunduar formimin profesional rriten nga 3.5 në 8.5 përqind dhe për titujt akademikë nga 2.6 deri në 7.7 përqind. Kjo tregon që edhe pse mundësitë e punësimit janë arsyeja kryesore për migracionin ndërkombëtar, për ndoshta deri 10 përqind të migrantëve të rinj, migracioni është një strategji për të marrë diploma të arsimit të lartë.

Figura 3.9: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29 vjeç sipas arsimit të përfunduar përpara dhe gjatë migracionit



Burimi: Anketa e migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013

Shumica e të rinjve të kthyer në Shqipëri, 92 përqind, janë kthyer vullnetarisht, por deri tani arsyeja më e rëndësishme e kthimit ka qenë ndërprerja e punësimit në vendin e destinacionit. Rreth 59 përqind e të pyeturve përmendin humbjen e punës si një nga arsyet kryesore të kthimit dhe 19 përqind të tjerë përmendin përfundimin e kontratës së punës (*Figura 3.10*). Ka të ngjarë që në shumë raste migrantët kanë humbur punën për shkaqe që lidhen me krizën financiare e cila ka goditur ekonomitë e vendeve kryesore të migracionit sidomos Greqinë. Përgjithësisht, arsyet

"problem" mbizotërojnë ndaj arsyeve "mundësi". Vetëm 10 përqind e të kthyerve janë kthyer me plane investimi në Shqipëri, 12 përqind kanë patur pritshmëri për mundësi më të mira punësimi në Shqipëri dhe 5 përqind kanë ngritur tashmë një biznes dhe janë kthyer për ta menaxhuar.

Një fakt interesant është që arsyeja emocionale jo-ekonomike si "malli për vendin dhe traditat" është përmendur shpesh (20 përqind e të pyeturve) si arsyeja kryesore e kthimit. Një tjetër arsye që lidhet me këtë e cila është e rëndësishme përfshin "problemet familjare", ose familjen në Shqipëri (22 përqind) ose jashtë vendit (4 përqind). Këto rezultate tregojnë që të rinjtë që migrojnë jo vetëm përballen me sfidat e punësimit, por edhe me sfidat në lidhje me fushat sociale dhe të marrëdhënieve.

Figura 3.10: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29, sipas arsyeve të përmendura të kthimit



Burimi: Anketa e migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013

Një në pesë (21 përqind) të rinj të kthyer kanë shprehur synimin e patundur për të emigruar përsëri, ndërsa 24 përqind do ta konsideronin si mundësi (*Figura 3.11*). Duket se dy faktorë mund të ndikojnë në vendimet e këtyre të fundit: situata ekonomike në vendin e destinacionit dhe të origjinës. Në fakt motivimi më i zakonshëm për ri-emigrim lidhet me shkallën e integrimit të të kthyerve në vendin e emigracionit. Një tjetër konsideratë e rëndësishme është që arsyet shtytëse për ri-emigrimin (papunësia/pamundësia për të ardhmen në vend) janë më të fuqishme se shkaqet tërheqëse (mundësitë e reja të punësimit).

Figura 3.11: Migrantët e kthyer të grupmoshës 18-29, sipas qëllimit të ri-emigrimit



Burimi: Anketa e migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri 2013

4 FAMILJA DHE SISTEMIMI NË BANESË

4.1 HYRJE

Transformimi social dhe demografik që ka kaluar Shqipëria gjatë dekadave të fundit ka pasur ndikim të madh në familje dhe në sistemimin në njësi ekonomike familjare. Shumë ndryshime, edhe pse jo të gjitha, janë në përputhje me Tranzicionin e Dytë Demografik (TDD) që vërehet në shumë vende të tjera europiane. Zhvendosja drejt individualizmit dhe shoqërive më të hapura dhe të pasura ndikon jo vetëm në proceset bazë demografike të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit, të cilat janë në themel të proceseve të plakjes dhe vjetërsisë në Shqipëri (shihni kapitullin 2), por edhe në zhvillime të tjera si ndryshime në modelin e martesës dhe sistemimit në banesë, shkëputje të martesës dhe ndërprerje të riprodhimit dhe në emancipimin e grave (Van de Kaa 2002, Lesthaeghe, Neidert Surkyn 2007, Lesthaeghe 2010).

4.2 KARAKTERISTIKAT E NJËSISË EKONOMIKE FAMILJARE

Censuset e njëpasnjëshme tregojnë që këto ndryshime kanë pasur ndikim në madhësinë e NJFE-ve: ndërsa në vitin 1979 madhësia mesatare e NJFE-ve ka qenë 5.6 persona, ajo ka rënë ndjeshëm në 3.9 në vitin 2011. Në të njëjtën kohë, numri i NJFE-ve është rritur, me përjashtim të periudhës ndërmjet censusit 2001-2011. Ky është tregues që NJFE-të jo vetëm bëhen më të vogla për shkak të uljes së lindshmërisë që në vitet 1960 (shihni kapitullin 5), por edhe për shkak të procesit të familjes bërthamë dhe individualizimit. Në vitin 2011, 16 përqind e të rinjve kanë jetuar në familje të përbëra nga më shumë se një familje bërthamë,[14] krahasuar me 21 përqind në vitin 2001. Ndërsa përqindja e NJEF me një familje të vetme është rritur relativisht (nga 78 në 81 përqind), rritja relative e NJEF me një person dhe NJEF me persona që nuk kanë lidhje familjare mes tyre- sidomos studentë- ka qenë e konsiderueshme duke u trefishuar nga 1.2 në 3.6 përqind në dekadën ndërmjet censusit 2001-2011.

Figura 4.1 pasqyron periudhën tranzitore të të rinjve sa i përket përbërjes familjare. Shumica e të rinjve më të rinj (89 përqind e 15-19 vjeçarëve) jeton në NJEF me një familje - zakonisht me prindërit e tyre- dhe vetëm 8 përqind jetojnë në NJEF të cilat përbëhen nga dy ose më shumë familje bërthamë. Përqindja e atyre që jetojnë në NJEF me shumë familje rritet me moshën në 24 përqind për të rinjtë më të mëdhenj (25-29 vjeç). Këta janë më së shumti të rinj që martohen dhe qëndrojnë në shtëpinë e prindërve, ose që kanë motra/vëllezër të cilët martohen dhe qëndrojnë në shtëpinë e prindërve. Duhet të bëhen më shumë kërkime për të identifikuar arsyet në themel për mbizotërimin relativisht të lartë të NJEF me shumë familje. Këto mund të variojnë nga preferenca të bazuara në kulturë për sistemimin në NJEF tek kufizimet në tregun e banesave për çiftet e reja dhe familjet dhe volitshmërinë pragmatike për kujdesin prindëror dhe të fëmijëve.

Në të njëjtën kohë, përqindja e personave që jetojnë jashtë sistemimit në familje - atyre që jetojnë në NJEF me një person ose që jetojnë me persona pa lidhje familjare me ata- fiton epërsi sidomos në grupmoshën e të rinjve 20-24 vjeçarë. Ky grup shpesh përbëhet nga studentë dhe të rinj që janë larguar nga shtëpia e prindërve, por që nuk janë lidhur akoma në martesë dhe nuk kanë filluar familjen e tyre.

14 Familja bërthamë përbëhet nga një çift me ose pa fëmijë ose një prind i vetëm me një ose më shumë fëmijë. NJEF pa familje bërthamë janë ose NJEF me një person, ose NJEF me dy ose më shumë persona që nuk kanë lidhje mes tyre.

Figura 4.1: Të rinjtë 15-29 vjeç, sipas moshës dhe përbërjes së NJEF (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Periudha e tranzicionit të të rinjve pasqyrohet edhe në ndryshimin e pozicionit të të rinjve brenda familjes, edhe pse ndikimi i kësaj zhvendosjeje shpesh më shumë vërehet tek femrat sesa tek meshkujt. *Figura 4.2* tregon që me kalimin e moshës gjatë periudhës së rinisë një përqindje në rritje e meshkujve merr rolin e kryefamiljarit ose personit të referencës, zakonisht duke u martuar dhe krijuar familjen e tyre. Megjithatë, deri në moshën 30 vjeçare, shumica e meshkujve (64 përqind) vazhdon të jetë në pozicionin e fëmijës të kryefamiljarit në shtëpinë e prindërve, pavarësisht gjendjes së tyre civile.

Për femrat, deri në moshën 18 vjeç, pozicioni në familje është shumë i ngjashëm me atë të meshkujve - në shumicën e rasteve janë vajza e kryefamiljarit dhe në më pak raste janë mbesa e kryefamiljarit. Por nga kjo moshë në vazhdim, rrugët gjinore ndryshojnë fuqishëm. Vetëm një përqindje e vogël - 19 përqind- mbetet në shtëpinë e prindërve deri në moshën 29 vjeç dhe shumica ose bëhen bashkëshorte apo partnere bashkëjetuese të kryefamiljarit mashkull, më se shumti në NJEF të sapokrijuara (50 përqind), ose bashkëshorte apo partnere bashkëjetuese të një mashkulli në shtëpinë e prindërve të tij (23 përqind). Gjithashtu, të rejat në moshën 18 deri në 22 vjeç janë më shpesh pjesë e një NJEF jo familjare sesa meshkujt në të njëjtën grup moshë.

Figura 4.2: Të rinjtë meshkuj dhe femra 15-29 vjec, sipas moshës dhe lidhjes me personin e referencës (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Vetëm një përqindje e vogël - 21 përqind, që përfaqëson rreth 8 mijë NJEF- e kryefamiljarëve të rinj janë femra. Profili i tyre social ndryshon thellësisht nga ai i kryefamiljarëve meshkuj të NJEF. Për shembull, mes kryefamiljareve femra shumica (59 përqind) janë femra të pamartuara ndonjëherë, rreth një e treta janë të martuara dhe një përqindje e konsiderueshme prej 7 përqind janë të ndara, të divorcuara ose vejusha (*Tabela 4.1*). Mes të rinjve meshkuj, shumica (71 përqind) janë të martuar, një përqindje e vogël e pakicës prej 29 përqind nuk është martuar asnjëherë dhe një përqindje e parëndësishme ka qenë i martuar më përpara. Këto shifra sugjerojnë që në masë është ruajtur modeli i rolit tradicional ku në martesë bashkëshorti konsiderohet kryefamiljari dhe gruaja personi në varësi.

Tabela 4.1: Kryefamiljarët e grupmoshës 15-29, sipas gjinisë dhe gjendjes civile

Gjendja civile	Të dy gjinitë	Meshkuj	Femra
Gjithsej	100.0	100.0	100.0
Beqar	35.1	28.6	59.2
Të martuar	62.9	70.8	33.9
Të divorcuar/të ndarë	1.1	0.3	4.3
Të ve	0.8	0.4	2.6

Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Megjithatë, nëse kryefamiljarët e rinj krahasohen me kryefamiljarët 30 vjeç dhe më të vjetër, vërehet një ndryshim i cili mund të tregojë ndryshimin në lidhje me barazinë gjinore më të madhe: në 11 përqind të çifteve të martuara me kryefamiljar nën 30 vjeç, gruaja konsiderohet kryefamiljare, ndërsa në çifte më të vjetra, kjo ndodh vetëm në 4 përqind të rasteve. Njëkohësisht është interesante të shohim që në përgjithësi përqindja e NJEF me kryefamiljare femra ka ndryshuar pak në dekadën e fundit ndërmjet censusit (nga 13 përqind në 2001 në 14 përqind në 2011), por që për kryefamiljarët e rinj kjo përqindje është rritur ndjeshëm nga 10 përqind në vitin 2001 në 21 përqind në vitin 2011. Procese të ndryshme shoqërore qëndrojnë në themel të këtij ndryshimi si tendenca në rritje për femra të reja që të krijojnë NJEF të pavarura pasi lënë shtëpinë e prindërve (për shembull gjatë periudhës së studimeve) dhe numri në rritje i divorceve (shihni seksionin 3.3), i cila përsëri çon në rritje të NJEF me kryefamiljare femra.

4.3 SJELLJA NDAJ MARTESËS DHE DIVORCIT

Martesa është një nga tranzicionet më të rëndësishme në periudhën e rinisë. Të dhënat e censusit 2011 tregojnë që në moshën 29 vjeçare, më shumë se gjysma e meshkujve (55 përqind) dhe tre të katërtat e femrave (76 përqind) janë lidhur në martesë gjatë rinisë (*Figura 4.3*). Edhe pse për standardet europiane këto janë shifra relativisht të larta, ato shënojnë një rënie të rëndësishme krahasuar me censusin e vitit 2001. Në kohën e atij censusi, përqindja e të martuarve në moshën 29 vjeç ka qenë 71 për meshkuj dhe 85 për femra. Po kështu, përqindja e të martuarve në moshën 25 vjeç ka rënë nga 72 në 58 për femrat dhe nga 38 në 24 për meshkujt. Mosha Mesatare e Martesës së Parë (SMAM) - që mund të kuptohet si numri i viteve të jetuara vetëm nga ata që martohen deri në moshën 50 vjeçare - është rritur në dekadën 2001-2011 me pothuajse 2 vjet për të dyja gjinitë nga 25.3 në 27.2 vjet (INSTAT 2014c).

Figura 4.3: Përqindja e popullsisë së martuar në grupmoshën 15-29 sipas gjinisë dhe moshës



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Këto shifra tregojnë që mosha e martesës në Shqipëri është rritur. Kjo shtyrje e martesës ndoshta është e lidhur me rëndësinë e karrierave paralele, si vazhdimësia e arsimit, zhvillimet në gjetjen e një pune të përshtatshme në tregun e punës dhe ndikimin e përvojave të migracionit gjatë fazës së jetës të të rinjve të rritur. Gjithashtu ka mundësi që forma të tjera të jetesës ndryshe nga martesa të bëhen më të zakonshme. Një mundësi është që bashkëjetesa pa martesë të fitojë terren, siç tregohet për shembull nga Anketa Demografike dhe e Shëndetit 2008-09 (INSTAT et al. 2010c). Në BE, në vitin 2006 pothuajse 30 përqind e grave të moshës 15-29 dhe 18 përqind e meshkujve të kësaj grupmoshe kanë jetuar në bashkëjetesa konsensuale jashtë martese. Shtyrja e martesës dhe përqindjet më të larta të atyre që mbeten beqarë përtej moshës 40 vjeçare tregon gjithashtu që parimi i martesës universale do të braktiset dhe që një përqindje në rritje e personave mund të zgjedhin vullnetarisht që të jenë të pamartuar. Në këtë drejtim, shoqëria shqiptare mund të ndjekë vende të tjera europiane në trajektoren e Tranzicionit të Dytë Demografik dhe ndoshta do të shohë një variacion më të madh të formave të jetesës, ku të rinjtë do të jenë pararendësit.

Edhe në modele të tjera martese, Shqipëria përballet me ndryshime sociale. Të rinjtë e martuar janë të ekspozuar ndaj rrezikut të divorcit vetëm për një kohë të shkurtër, por përqindja e të rriturve të rinj që janë të ndarë ose të divorcuar është rritur ndjeshëm në terma relative. Mes 25-29 vjeçareve, kjo përqindje është dyfishuar në 1.4 përqind në intervalin e fundit ndërmjet censuseve dhe ka mundësi të bëhet edhe më e dukshme në të ardhmen e afërt. Për meshkujt, rritja relative është akoma më e madhe, por përqindja e të rinjve meshkuj të ndarë dhe të divorcuar është mjaft më e vogël (0.3 përqind), sidomos për shkak se të rinjtë meshkuj janë mesatarisht të ekspozuar ndaj divorcit për një periudhë edhe më të shkurtër, për shkak të moshës së tyre të vonuar të martesës.

Ndryshimi në moshën e martesës së parë ndërmjet meshkujve dhe femrave merr parasysh pabarazitë gjinore në përqindjen e të rinjve të martuar, siç tregohet në *Figurën 3.2*.[15] Mosha mesatare e martesës së parë e bazuar në census për meshkujt në vitin 2011 është 29.2 vjet dhe ajo e grave është 25.1 vjet, duke treguar një diferencë mesatare të moshës ndërmjet bashkëshortëve me rreth 4 vjet. Kjo martesë me diferencë katër vjet e meshkujve gjithashtu shpjegon gjerësisht përqindjen më të vogël të të divorcuarve dhe të të ndarëve mes të rinjve.

15 Përtej moshës 30 vjeçare, përqindja e atyre që janë martuar ndonjëherë përputhet edhe pse veçanërisht në moshë më të madhe përqindja e femrave vejusha bëhet më e madhe sesa përqindja përkatëse e meshkujve të ve (INSTAT et al. 2010c).

5 KUSHTET E JETESËS

5.1 HYRJE

Stili i jetës dhe kushtet e jetesës janë fusha thelbësore për të kuptuar specifikat dhe kulturën e të rinjve, kushtet konkrete sociale të ekzistencës dhe gjithashtu marrëdhënien e ngushtë ndërmjet sjelljes së tyre dhe strukturës së mundësive dhe kufizimeve - të përcaktuara si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel Europian- ku ato ndodhin.

Në kontekst të nivelit material të jetesës dhe mirëqenies, strehimi është një aspekt thelbësor. Aftësia e njerëzve për të përballuar strehimin e nevojshëm me cilësi të denjë në një mjedis të sigurt është çështje me rëndësi për plotësimin e nevojave bazë dhe përcaktues kyç i mirëqenies. Të pasurit e strehimit të përballueshëm nuk lidhet vetëm me specifikat e tregut të shtëpive, por edhe me "barrën e mbajtjes së familjeve të tyre" dhe burimet financiare për ta realizuar këtë. Prandaj, kjo lidhet tepër me shkallën e vështirësisë për të hyrë dhe për të qëndruar të patundur në tregun e punës. Një mënyrë për të tejkaluar problemin e strehimit të të rinjve është ofrimi i banesave sociale të të rinjve që kanë të ardhura të pakta.

Cilësia e strehimit mbulon një gamë të gjerë aspektesh, që lidhen jo vetëm me banesën, por edhe më zonat më të mëdha të banimit ku jetojnë njerëzit. Problemet strukturore të banesës, mbipopullimi dhe mungesa e hapësirës, mangësitë e strehimit dhe mungesat në kërkesat bazë, janë elementë kyç për vlerësimin e cilësisë së strehimit. Njëkohësisht, jetesa në një zonë të zhurmshme, ekspozimi ndaj ndotjes dhe pisllëkut ose pasiguria në zonën e banimit ku ndodhet shtëpia, janë parë si probleme strehimi në lidhje me cilësinë e mjedisit të banimit.

Ky kapitull jep një vështrim të përgjithshëm të kushteve të jetesës së të rinjve. Treguesit e paraqitur në këtë kapitull bazohen në të dhënat që jep Censusi 2011 i Popullsisë dhe Banesave. Ky informacion është mbledhur bazuar në banesat dhe njësitë ekonomike familjare, prandaj për çdo informacion në lidhje me secilën banesë dhe karakteristikat e njësisë ekonomike familjare janë pyetur pjesëtarët e familjes. Përveç popullsisë së të rinjve në përgjithësi, vëmendje e veçantë i kushtohet njësive ekonomike familjare me kryefamiljar të rinj të grupmoshës 15 deri në 29 vjeç. Krahasuar me censusin e vitit 2001, numri i njësive ekonomike familjare me kryefamiljar të ri ka rënë nga 6.2 në 5.2 përqind.

5.2 NDËRTESAT DHE BANESAT

Kostoja dhe cilësia e strehimit janë elemente kyçe që kontribuojnë në nivelin e përgjithshëm të jetesës dhe në mirëqenie. Si të tilla, treguesit që masin cilësinë, ambientet dhe hapësirën në dispozicion brenda banesave mund të japin informacion plotësues për të vlerësuar kushtet materiale të grupeve të ndryshme brenda shoqërisë. Cilësia e strehimit mund të vlerësohet duke parë një sërë mangësish në strehim si mungesa e tualetit.

Ka një dallim relativisht të vogël në numrin e ndërtesave të banimit në vitin 2001 dhe 2011. Në vitin 2001, ky numër ishte 512 mijë, krahasuar me 598 mijë ndërtesa në vitin 2011, një rritje prej 10.4 përqind. Nga ana tjetër, rritja e stokut të banesave[16] është domethënëse sidomos si pasojë e rritjes së numrit të ndërtesave shumëkatëshe sidomos në qytete. Numri i banesave në vitin 2011 ishte 1012 mijë krahasuar me 785 mijë në vitin 2001, një rritje prej 28.9 përqind.

Për të dy llojet e njësive ekonomike familjare, ato me të paktën një pjesëtar të grupmoshës 15-29 vjeç dhe për njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të grupmoshës 15-29 vjeç, lloji më i zakonshëm i ndërtesës në vitin 2011 ka qenë shtëpia private me 72.3 dhe 59.8 përqind përkatësisht, të ndjekura nga apartamentet, ndërsa ndërtesat jo për qëllime banimi si blloqe për jetesë kolektive ose lloj tjetër ndërtese përbëjnë një përqindje shumë të vogël të këtyre njësive ekonomike familjare që jetojnë në këto lloj ndërtesash. Apartamentet preferohen më shumë nga njësitë ekonomike familjare me kryefamiljarë të rinj krahasuar me ato që kanë të paktën një pjesëtar të grupmoshës 15-29 vjeç (përkatësisht

16 Banesa mund të jetë një ndërtesë për qëllim banimi si për shembull shtëpi ose apartament, ose ndërtesë jo për qëllim banimi. Si për shembull, tendë, karavan ose barakë. Për një përkufizim më të plotë të banesës, shihni Aneksin I.

38.3 dhe 26.8 përqind), në një farë mase për shkak se këto njësi ekonomike familjare përbëhen më së shumti nga studentë që jetojnë në apartamente të marra me qira dhe kjo pasqyron rritjen e numrit të studentëve në shoqëri.

Figura 5.1: Njësitë Ekonomike Familjare me një ose më shumë pjesëtarë të grupmoshës 15 deri në 29 vjeç dhe njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të grupmoshës 15 deri në 29 vjeç sipas llojit të banesës (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

5.3 KARAKTERISTIKAT E BANESËS

5.3.1 Statusi i pronësisë së banesës

Një zhvendosje e dallueshme ka ndodhur në pjesën e njësive ekonomike familjare me kryefamiljar të ri që ka në pronësi banesën ku jeton. Në periudhën e fundit ndërmjet censuseve, kjo përqindje ka rënë me më shumë se 15 pikë përqindje (*Figura 5.2*). Kjo ka mundësi që të lidhet me urbanizimin dhe rëndësinë në rritje të banesave apartament. Nga ana tjetër, përqindja e njësive ekonomike familjare si qiramarrëse është më shumë se trefishuar në këtë periudhë.

Figura 5.2: Njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të moshës 15-29 vjeç sipas statusit të pronësisë së banesës dhe vitit të censusit



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave në 2001 dhe 2011

5.3.2 Aksesi në shërbimet bazë

Shërbimi i duhur i furnizimit me ujë dhe pasja e tualetit si edhe hapësirës së mjaftueshme për jetesë në banesë është një tregues jo monetar i nivelit të jetesës. Në vitin 2001, furnizimi me ujë dhe tualeti ka qenë i pamjaftueshëm, por censusi i vitit 2011 tregon një përmirësim të ndjeshëm të situatës.

Përqindja e popullsisë së të rinjve që furnizohet me ujë rrjeti është rritur ndjeshëm nga 72 përqind në vitin 2001 në 84 përqind, por ndërsa në vitin 2001 vetëm 40 përqind kanë ujë rrjeti në banesat e tyre, në vitin 2011 kjo përqindje është rritur në 62 përqind. Në periudhën ndërmjet censuseve është rritur përdorimi i furnizimit me ujë të rrjedhshëm për popullsinë e të rinjve nga 65 në 92 përqind dhe përqindja e atyre që përdorin ujin e rrjedhshëm brenda banesave të tyre është rritur nga 50 në 74 përqind. Përqindja e të rinjve (22 mijë persona) që jetojnë në njësi ekonomike familjare pa furnizim me ujë, është 3 përqind, nga 7 përqind në vitin 2001.

Figura 5.3 tregon shpërndarjen në vitin 2011 të sistemeve të furnizimit me ujë dhe llojet e tualeteve për njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të ri dhe për popullsinë totale të të rinjve në Shqipëri. Pavarësisht përmirësimeve në periudhën ndërmjet censuseve, përsëri 38 përqind të të rinjve shqiptarë nuk kanë furnizimin e dëshiruar me ujë rrjeti në banesë dhe 26 përqind nuk kanë tualet brenda banesës. Situata për njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të ri është disi më e mirë, duke pasqyruar situatën e njësive ekonomike familjare të reja krahasuar me atë të brezit të prindërve.

Figura 5.3: Njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të grupmoshës 15-29 vjeç dhe popullsia e grupmoshës 15-29 vjeç sipas sistemit të furnizimit me ujë dhe llojit të tualetit (2011)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

5.3.3 Shfrytëzimi i banesës

Nëse shumë persona ndajnë një banesë, kjo mund të ketë ndikim negativ në mirëqenien e tyre. Në fakt mbipopullimi është shfaqje e pabarazisë së strehimit dhe është gjithashtu një formë e fshehur e të qenit të pastrehë. UN- Habitat përkufizon mbipopullimin si banesa me tre ose më shumë persona në një dhomë (UN-Habitat 2007). Pasojat e mbipopullimit përfshijnë një risk më të madh të transmetimit të sëmundjeve për një gamë të gjerë të sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes, përfshirë pneumoninë, tuberkulozin dhe shumë alergji dhe sjellje sociale negative, si dhuna në familje dhe abuzimi me fëmijët, dhe rezultate negative në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Nga ana tjetër, banesat ku banojnë më pak se një person në dhomë mund të konsiderohen "të nën-banuara" dhe nëse kjo ndodh në shkallë të gjerë, tregon një funksionim të dobët të tregut të shtëpive. Për Shqipërinë, banesat me 1 deri në 2.9 persona në dhomë konsiderohen "të banuara mjaftueshëm" dhe banesat me tre persona ose më shumë në dhomë përkufizohen "të mbipopulluara".

Nëse konsiderohet ky përkufizim i mbipopullimit, vërehet përmirësim i ndjeshëm ndërmjet vitit 2001 dhe 2011. Përgjithësisht, përqindja e banesave të mbipopulluara në vitin 2001 është rreth një e katërta e asaj të vitit 2001, 3.8 dhe 16.5 përqind përkatësisht. Nga ana tjetër, aktualisht ka 2.4 herë më shumë banesa të nën-banuara në vitin 2011 krahasuar me 10 vjet më parë, kjo si rezultat i një sërë faktorësh që përfshijnë modele të reja të jetesës për njësitë ekonomike familjare në Shqipëri, shpopullim të disa qarqeve në vend, por ndoshta edhe mbi-prodhim të sektorit të strehimit.

Në fakt, të dhënat e censusit ofrojnë një masë të mbipopullimit që bazohet në numrin e dhomave dhe numrin e personave që jetojnë në njësi ekonomike familjare. Në vitin 2001, përqindja e të rinjve që jetojnë në një banesë të mbipopulluar ka rënë në një të tretën e nivelit të vitit 2001, nga 26 në 9 përqind. Kjo tendencë në rënie e të rinjve që jetojnë në banesa të mbipopulluara është vënë re në të gjitha qarqet.

Në vitin 2011, përqindja më e lartë e të rinjve që jetojnë në një banesë të mbipopulluar është vënë re në qarkun e Kukësit (18.6 përqind), të ndjekur nga qarku i Dibrës (17 përqind) siç tregohet në *Figurën 5.4* më poshtë. Qarku i Gjirokastrës ka përqindjen më të ulët të të rinjve që jetojnë në banesë të mbipopulluar (5 përqind). Gjerësisht, i njëjti model është vënë re për të dhënat e vitit 2001, ku qarku i Kukësit dhe Dibrës kanë pasur nivelin më të lartë të mbipopullimit me 37.7 dhe 35.5 përqind, përkatësisht. Në këtë kohë, përqindja më e ulët e jetesës së të rinjve në një banesë të mbipopulluar është vënë re në Korçë (15.5 përqind).

Figura 5.4: Përqindja e popullsisë së të rinjve që jetojnë në një banesë të mbipopulluar sipas qarkut, 2001 dhe 2011



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave në 2001 dhe 2011

5.4 MIRËQENIA MATERIALE

5.4.1 Të rinjtë në varfëri

Të rritesh është një fazë tranzitore për shumë aspekte, si për mbarimin e shkollimit dhe fillimin e punësimit, apo për largimin nga banesa prindërore për t'u bërë i pavarur. Kështu të rinjtë janë më të ekspozuar ndaj risqeve që lidhen me ndryshimet e thella të jetës së tyre.

Për Shqipërinë, Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) jep informacion për vlerësimin e nivelit të varfërisë në vend. Personat dhe njësitë ekonomike familjare konsiderohet se jetojnë në kushte varfërie nëse shporta e mallrave dhe shërbimeve që ata konsumojnë është e pamjaftueshme për të ofruar nivelin minimal të mirëqenies materiale, kufirin e varfërisë. Edhe pse duhet pranuar që varfëria e matur me konsumin për frymë është qartazi një masë vetëm për mirëqenien ekonomike, ndikimi i saj përfshin dukshëm dimensionet më të mëdha, ashtu si në shumicën e situatave, konsumi lidhet ngushtë me dimensione të tjera të mirëqenies, siç janë arsimi ose shëndeti.

Sipas të dhënave të AMNJ 2012, vlerësohet që 15 përqind e popullsisë të moshës 15 vjeç deri në 19 vjeç ka qenë e varfër dhe nuk ka plotësuar standardet bazë të jetesës. Boshllëku i varfërisë jep informacion të mëtejshëm për distancën mesatare ndërmjet niveleve të konsumit të të varfërve dhe kufirit të varfërisë, duke kuptuar në këtë mënyrë nëse të varfrit konsumojnë deri në kufirin e varfërisë apo shumë më pak se aq. Për të rinjtë shqiptarë, kjo "thellësi varfërie" ka qenë 3.2 përqind, duke treguar që 15 përqind e të rinjve të varfër nuk mund të plotësojnë mjaftueshëm nevojat për jetesë të denjë, por niveli i konsumit prej tyre ka qenë- mesatarisht- relativisht afër nivelit që konsiderohet minimumi i kërkuar.

5.4.2 Zotërimi i pajisjeve afatgjata

Në vitin 2010, mbi 70 përqind e të rinjve dhe njësive ekonomike familjare me kryefamiljar të moshës 15 deri në 29 vjeç ka jetuar në banesë që ka pasur makinë larëse, telefon, frigorifer dhe TV (*Figura 5.5*). Përgjithësisht profili i zotërimit të pajisjeve shtëpiake është shumë i ngjashëm për njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të ri dhe popullsinë totale të të rinjve. Megjithatë, njësitë ekonomike familjare me kryefamiljar të ri janë më në nevojë në aspektin që 7.4 përqind e tyre nuk ka pasur asnjë pajisje nga ato të *Figurës 5.5* krahasuar me vetëm 4.0 përqind të popullsisë totale të të rinjve.

Në shoqërinë moderne të informacionit, komunikimi efektiv është i nevojshëm dhe kërkon infrastrukturën e duhur. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit, si kompjuterët dhe telefonat celularë bëjnë të mundur që njerëzit të shkëmbejnë përvojat dhe të mësojnë nga njëri-tjetri, duke sjellë fitime më të mëdha për investimin dhe shmangur probleme të përsëritjes ose humbjes së informacionit. Censusi i vitit 2011 tregon që futja e internetit dhe kompjuterëve në familjet shqiptare ka qenë akoma në nivel të ulët: vetëm 22.1 përqind e popullsisë së të rinjve ka pasur kompjuter dhe vetëm 13.3 ka pasur lidhje interneti në shtëpi. Megjithatë, 88.2 përqind e të rinjve, kanë të paktën një celular në shtëpi.

Figura 5.5: Zotërimi i pajisjeve afatgjata



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Zotërimi në shtëpi i pajisjeve që u regjistrua në censusin e vitit 2001 dhe 2011 është paraqitur në *Figurën 5.6*. Nisur nga pronësia pothuajse universale e TV në vitin 2001, nuk ka rritje të ndjeshme në përqindjen e të rinjve që jetojnë në banesa që kanë TV në vitin 2011. Por grafiku tregon një rritje të ndjeshme të zotërimit në shtëpi të pajisjeve si frigorifer, makinë larëse dhe makina, por edhe pajisje të reja si mikrovala, kondicioneri dhe kompjuteri. Zotërimi i këtij të fundit është i papërfillshëm në vitin 2001 dhe është rritur ndjeshëm në vitin 2011. Kështu, ka pasur 9 herë më shumë të rinj që kanë mikrovalë dhe kondicioner dhe rreth 18 herë më shumë të rinj që kanë kompjuter. Rritja në zotërimin e pajisjeve afatgjata ka qenë më e ngadaltë, por përsëri e rëndësishme. Përqindja e të rinjve që kanë frigorifer është rritur me 18 përqind ndërmjet vitit 2001 dhe 2011, por përqindja e të rinjve që kanë makina larëse është më shumë se dyfishuar. Rreth 28 përqind e të rinjve jetojnë në familje që kanë të paktën në pronësi një makinë në vitin 2011, kundrejt vetëm 8 përqind të tyre në vitin 2001.

Figura 5.6: Përqindja e popullsisë së të rinjve që jetojnë në NjEF që ka në zotërim pajisjet e specifikuara



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave në 2001 dhe 2011

6 ARSIMI

6.1 HYRJE

Arsimi në Republikën e Shqipërisë është përparësi kombëtare në kuadër të emancipimit, ecurisë dhe zhvillimit social të individit. Të gjithë shqiptarët kanë të drejta të barabarta për akses në arsim në të gjitha nivelet pa diskriminim në lidhje me statusin e tyre social, kombësinë, gjuhën, gjininë, fenë, bindjet politike, gjendjen shëndetësore dhe nivelin ekonomik.[17]

Të gjithë fëmijët e moshës 6 vjeç në Shqipëri janë të detyruar të ndjekin arsimin e detyruar që zgjat 9 vjet. Studentëve u kërkohet të ndjekin arsimin e detyruar deri në moshën 16 vjeçare. Arsimi i detyruar ka mision të zhvillojë aftësitë intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike të studentëve për të zhvilluar personalitetin e tyre dhe për t'ju dhënë elementët bazë të kulturës së përgjithshme dhe edukimit qytetar. Sipas legjislacionit, dy nivelet e para të arsimit, arsimi fillor (klasa 1-5) dhe 8-vjeçar (klasa 6-9) janë aktualisht të detyruara në vend.[18]

Arsimi dytësor që ndiqet nga personat të paktën 16 vjeç, synon të zhvillojë në mënyrë më të plotë dhe të harmonizuar personalitetin dhe potencialin e studentëve që të bëjë të mundur që ata të kontribuojnë në mënyrë më shumë aktive në jetën ekonomike, politike, sociale dhe kulturore të vendit. Në lidhje me arsimin dytësor, përparësi e lartë i jepet formimit profesional, sidomos dy vitet e fundit.

Niveli i tretë i arsimit përfshin arsimin e lartë. Në ditët e sotme ka kërkesë më shumë për universitete cilësore dhe të orientuara drejt kërkimit. Veçanërisht i lartë ka qenë interesi në ndjekjen e arsimit të lartë. Në vitin 2014, 60 përqind e të diplomuarve ka përfunduar ciklin e parë të studimeve universitare dhe 40 përqind e tyre ka përfunduar ciklin e dytë të nivelit master ose ekuivalent.[19]

Censusi 2011 i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri përmbante katër pyetje për karakteristikat arsimore duke marrë informacion për shkallën e alfabetizmit, arritjeve mësimore, diplomën më të lartë të fituar dhe vitet e përfunduara të arsimit. Këto pyetje janë përfshirë për të bërë krahasimin me të dhënat e censusit 2001 dhe për të mundësuar llogaritjen e treguesve kyç për arsimin. Informacion shtesë është marrë nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

6.2 FORCIMI I AFTËSIVE PËR JETËN: NDJEKJA E ARSIMIT DHE VITET E SHKOLLIMIT

6.2.1 Ndjekja e arsimit[20]

Regjistrimi dhe norma e ndjekjes të arsimit janë tregues për të vlerësuar funksionimin e sistemit arsimor për t'i shërbyer popullsisë në moshë shkolle në një vend. Norma neto e ndjekjes së arsimit tregon shtrirjen e pjesëmarrjes në një nivel të caktuar shkollimi të fëmijëve që i përkasin grupmoshës zyrtare e cila i korrespondon nivelit specifik të arsimit. Norma neto e ndjekjes së arsimit fillor përdoret si tregues i OZHM për të monitoruar ecurinë drejt qëllimit të arritjes së arsimit fillor universal.

Norma e ndjekjes e bazuar në census treguar në *Figurën 6.1* tregon që ndjekja e shkollës nga fëmijët e moshës të shkollës fillore (mosha 6 deri në 11) është pothuajse universale dhe ajo e fëmijëve të moshës së arsimit dytësor të ulët (12 deri në 14) është vetëm pak më e ulët. Përtej këtij programi për arsimin e detyruar - që i korrespondon moshës 15 deri në 23 vjeç- norma e ndjekjes bie sidomos pas moshës 17 vjeç, kur shumë studentë vendosin ose të vazhdojnë arsimin më të lartë ose braktisin sistemin arsimor. Me 45 përqind të 19 vjeçarëve që ndjekin shkollën, Shqipëria qëndron mjaft nën mesataren e BE-së me rreth 60 përqind (Eurostat 2015d). Përqindjet përkatëse për personat 24 vjeç janë 11 në Shqipëri dhe rreth 25 përqind në vendet e BE-së.

17 Ligji (i përditësuar) nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për arsimin" ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.07.1998 Për disa ndryshime në ligjin 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin e arsimit universitar" sipas nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991
18 Nivelet e arsimit janë në përputhje me ISCED 97 (shihni Aneksin II).
19 Shqipëria në Shifra 2014, www.instat.gov.al, publikimi i INSTAT
20 Ndjekja e arsimit përkufizohet si ndjekja rregullisht e një institucioni ose programi arsimor të akredituar, privat ose publik, për mësimdhënien e organizuar në çdo nivel të shkollimit.

Figura 6.1: Norma e ndjekjes së arsimit, sipas gjinisë dhe moshës



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Vërehet që deri në arsimin dytësor të lartë, norma e ndjekjes për vajzat dhe djemtë është shumë e ngjashme, por që vajzat e braktisin disi më shpesh. Shkalla neto e ndjekjes së arsimit për vajzat në arsimin dytësor të lartë e regjistruar në Censusin e 2011 të Popullsisë dhe Banesave ishte 67 përqind, ndërsa shifra përkatëse për meshkujt ishte 72 përqind (Tabela 6.2). Megjithatë, femrat e reja kanë prirje të ndjekin arsimin e mëtejshëm në nivel më të lartë sesa të rinjtë. Shkalla neto e ndjekjes së arsimit nga femrat për arsimin e lartë të regjistruar në Censusin 2011 të Popullsisë dhe Banesave ishte 34 përqind, ndërsa shifra përkatëse për meshkujt ishte vetëm 25 përqind. Në këtë drejtim, Shqipëria ndjek vendet europiane, ku përgjithësisht studentet femra janë më të shumta në numër se studentët meshkuj (Eurostat 2015c). Raporti i femrave dhe meshkujve pasqyrohet edhe në indeksin e barazisë gjinore[21] i cili është një nga treguesit për të arritur qëllimin e OZHM 3 - *Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave*. Indeksi i barazisë gjinore për arsimin bazë të detyruar (fillor dhe dytësor të ulët) është pothuajse ideal 0.99, por duket se vajzat janë më pak të favorizuara në arsimin dytësor të lartë, për të cilin treguesi është 0.93. Megjithatë, në arsimin e lartë pabarazia e re gjinore ka lindur me meshkujt në pozicion më pak të favorshëm, nisur nga indeksi i lartë i barazisë gjinore me 128 për atë nivel.

Tabela 6.1: Norma neto e ndjekjes së arsimit (NNN), Norma bruto e ndjekjes së arsimit (NBN) dhe indeksi i barazisë gjinore sipas niveli arsimor dhe gjinisë

Gjinia	Niveli arsimor									
	Fillore		8-vjeçare		Mesme		Gjithsej niveli 8-vjeçar dhe i mesëm		Universitet	
	NNN*	NBN**	NNN	NBN	NNN	NBN	NNN	NBN	NNN	NBN
Të dyja gjinitë	66	68	76	134	53	69	62	95	29	52
Meshkuj	67	68	76	134	55	72	63	97	25	46
Femra	66	67	75	133	52	67	61	93	34	58
Indeksi i barazisë gjinore	0.99		0.99		0.93		0.95		1.28	

Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011
*NNN-norma neto e ndjekjes
**NBN-norma bruto e ndjekjes

Kalimi nga arsimi në tregun e punës ose pasivitet ndodh më së shumti gjatë fazës së jetës të të rinjve. Ndërsa shumica (68 përqind pothuajse barabar për vajzat dhe djemtë) e 15-19 vjeçarëve është akoma e përfshirë në arsim, kjo përqindje është vetëm në shifrën 26 për grupmoshën e të rinjve 20-24 vjeç (24 vjeç për meshkuj dhe 29 vjeç për femra) dhe 6 përqind për grupmoshën e të rinjve më të rritur 25-29 (përsëri njësoj për meshkujt dhe për femrat) (*Figura 6.2*).

21 Indeksi i Barazisë Gjinore është përkufizuar si raporti i numrit të studenteve femra të regjistruara në një nivel specifik të arsimit me numrin e studentëve meshkuj në atë nivel. Për të standardizuar pasojat e strukturës së popullsisë të grupmoshave të përshtatshme, indeksi i barazisë gjinore përdoret Norma Bruto e Ndjekjes së arsimit për çdo nivel arsimi.

Figura 6.2: Përqindja e të rinjve që ndjekin arsimin sipas grupmoshës



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Niveli arsimor i të rinjve në Shqipëri po rritet me ritme të shpejta. Regjistrimi i të rinjve në universitete ka qenë në rritje, nga 122 mijë në vitin akademik 2009-10 deri në 174 mijë në vitin 2013-14. Kjo përkthehet edhe në rritje të vazhdueshme të normave bruto të regjistrimit (GER)[22] në arsimin e lartë (*Figura 6.3*).

Vitet e fundit, numri i studenteve femra ka qenë më i lartë sesa ai i meshkujve për universitetet, i cili në periudhën 2013-14 ka arritur në 57 përqind.

Figura 6.3: Norma bruto e regjistrimit në arsimin e lartë, sipas vitit shkollor dhe gjinisë



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe INSTAT

6.2.2 Tërësia e viteve të shkollës

Censusi jep mundësi për të llogaritur për herë të parë vitet e shkollës dhe për të krahasuar këtë tregues jo vetëm me vende të tjera rajonale dhe europiane, por edhe me jetëgjatësinë. Tërësia e viteve të shkollës është tregues që mat numrin e viteve që një fëmijë i cili ka filluar shkollën do të qëndrojë në sistemin arsimor bazuar në normat mbizotëruese të regjistrimit.[23] Tërësia e viteve të shkollës varet nga disa faktorë që strukturojnë çdo sistem arsimor: kohëzgjatjen e arsimit të detyruar, aksesin në arsimin parashkollor dhe modelet, llojet e ndryshme të arsimit që ofrohet (profesional

22 Norma Bruto e Regjistrimit për një nivel specifik të arsimi është numri i studentëve të regjistruar në atë nivel arsimi, pavarësisht moshës, të shprehur si një përqindje të popullsisë në grupmoshën zyrtare që i korrespondon atij niveli të arsimit.

23 Tërësia e viteve të shkollës llogaritet duke shtuar normat neto të regjistrimit në arsim për çdo vit dhe grupmoshë. Normat neto të regjistrimit llogariten duke pjesëtuar numrin e studentëve (ISCED 0 deti në 6) të një moshe ose grupmoshe të caktuar me numrin e personave të popullsisë që janë të të njëjtës moshë ose grupmoshë.

ose të përgjithshëm) në arsimin dytësor të lartë dhe mënyrën e orientimit të nxënësve, llojin e pranimit dhe larminë e ofrimit të arsimit të lartë. Përtej arsimit të detyruar, tërësia e viteve të shkollës preket, mes faktorëve të tjerë (p.sh kushtet socio-ekonomike) nga fakti që prindërit dhe nxënësit shpesh ekuilibrojnë investimin e tyre në arsim kundrejt mundësisë për fitime më të mëdha në të ardhmen dhe mbrojtjen kundër papunësisë.[24]

Tabela 6.2 tregon jetëgjatësinë dhe tërësinë e viteve të shkollës në mosha të ndryshme. Pritshmëria është që një fëmijë i moshës 6 vjeçare - mosha e përcaktuar me ligj për të filluar shkollën në vend- të ndjekë arsimin përafërsisht 14 vjet. Kjo do të thotë që rreth 19 përqind e pjesës që mbetet nga jeta e fëmijës - mesatare 72.6 vjeç- do të kalohet në arsim. Kjo pjesë e jetës në arsim është e njëjtë për vajzat dhe djemtë, por si jetëgjatësia ashtu edhe tërësia e viteve të shkollës për vajzat është më e lartë.

Tabela 6.2: Jetëgjatësia dhe tërësia e viteve të shkollës sipas gjinisë dhe moshës së përzgjedhur

Jetëgjatësia, tërësia e viteve të shkollës, gjinia	Mosha			
	6	15	20	25
Jetëgjatësia				
Të dy gjinitë	72.6	63.8	58.9	54.1
Meshkuj	70.3	61.6	56.8	52.0
Femra	74.9	66.1	61.2	56.3
Tërësia e viteve të shkollës				
Të dy gjinitë	13.8	5.2	1.8	0.6
Meshkuj	13.7	5.1	1.7	0.6
Femra	14.0	5.4	2.0	0.5

Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Një fëmijë që hyn në fazën e jetës së rinisë ka mesatarisht akoma 5.2 vite arsim përpara, vajzat disi më shumë dhe djemtë disi më pak. Kjo shifër në moshën 20 vjeçare është ulur në 1.8 vjet dhe ka rënë më tej në 0.6 vjet për të rinjtë më të mëdhenj të moshës 29 vjeç.

Tërësia e viteve të shkollës për fëmijët shqiptarë të moshës 6 vjeçare është nën atë të çdo vendi të BE-së. *Figura 6.4* tregon tërësinë e viteve të shkollës nga mosha 6 vjeç në Shqipëri dhe vendet e përzgjedhura në rajon dhe më gjerë, mes të cilave Shqipëria është renditur e dyta me moshë më të ulët. Megjithatë, sa i përket jetëgjatësisë, Shqipëria paraqitet mirë mes këtyre vendeve.

Figura 6.4: Tërësia e viteve të shkollës dhe jetëgjatësia nga mosha 6 vjeç për vendet e përzgjedhura



Burimi: Eurostat[25]

24 Të rinjtë në Europë, portret statistikor, Eurostat 2009
25 http://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&pcode=tps00052&plugin=1

6.3 NIVELI ARSIMOR DHE BRAKTISJA E ARSIMIT

6.3.1 Niveli arsimor[26]

Arritjet arsimore janë rezultat i dukshëm i sistemit arsimor dhe një matje e suksesit të tyre. Për individët, nivelet e arritjeve kanë ndikim të madh, si personalisht ashtu edhe profesionalisht, në cilësinë e jetës dhe mundësitë për punë. Edhe pse niveli i arsimit në popullsinë e një vendi nuk është domosdoshmërisht një matje e mirë e cilësisë së arsimit, ai mundëson një përcaktim sasior të krahasueshëm të performancës së arsimit dhe kompetencave të popullsisë, si ndërmjet vendeve ashtu edhe në kohë të ndryshme.

Censusi i 2011 i Popullsisë dhe Banesave përmban dy pyetje për arsimin e përfunduar të popullsisë. *Tabela 6.3* jep një panoramë të nivelit të arsimit të përfunduar të popullsisë 25 vjeç e lart, që supozohet të ketë mbaruar ciklin e plotë të arsimit. Të dhënat tregojnë një përmirësim të qartë të nivelit arsimor të realizuar nga grupmosha më të reja. Përqindja e popullsisë që nuk ka ndjekur asnjëherë shkollën është ulur ndjeshëm nga 15 përqind për personat 65 vjeç e më të mëdhenj në vetëm 3 përqind për personat 25-39 vjeç. Përmirësim më i madh në këtë drejtim i atribuohet grave, sepse ky tregues për grupmoshën e më të rinjve është vetëm rreth një e dhjeta (2 përqind) e atij të grupmoshës më të vjetër (21 përqind).

Tabela 6.3: Popullsia 25 vjeç e lart, sipas grupmoshës, gjinisë dhe nivelit arsimor (në përqindje)

Niveli i shkollimit	Grupmosha								
	25-39			40-64			65 +		
	MF	M	F	MF	M	F	MF	M	F
Nuk ka ndjekur ndonjëherë shkollën	2.6	3.0	2.2	1.8	1.7	1.8	14.7	7.4	21.3
Fillore	2.1	2.8	2.2	5.7	4.4	7.7	37.5	34.1	43.9
8-vjeçare	47.1	45.2	48.9	43.5	39.7	47.2	25.3	28.5	22.5
Mesme	29.8	33.7	25.9	37.7	41.7	33.8	14.3	19.3	9.6
Universitet	18.1	15.2	20.8	11.0	12.4	9.5	6.5	10.7	2.7
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Ndjekja e shkollës së lartë është bërë dëshirë e realizueshme për të rinjtë. Kjo mund të shihet me rritjen e ndjekjes së arsimit të lartë. 18 përqind e popullsisë 25-39 vjeç ka përfunduar këtë nivel, krahasuar me 7 përqind të popullsisë 65 vjeç e lart. Përsëri, përmirësimi më i madh është arritur për gratë. Me 21 përqind, gratë e grupmoshës 25-39 vjeç kanë një përqindje 7 herë më të madhe në arsimin e lartë sesa grupmosha më e vjetër 65 vjeç e lart. Gjithashtu vërehet që përqindja e të rejave të rritura në arsimin e lartë (21 përqind) është më e lartë sesa përqindja korresponduese e të rinjve të rritur (15 përqind).

Me fokus në grupmoshën specifike të të rinjve 15-29 *Tabela 6.4* tregon tendencën e arritjeve arsimore ndërmjet dy censuseve të fundit duke konfirmuar përmirësimin në ndjekjen e arsimit sipas moshës të treguar në *Tabelën 6.3*. Përqindja e të rinjve që kanë vetëm nivelin e detyruar të arsimit 8-vjeçar ka rënë nga rreth dy të treta (64 përqind) në vitin 2001 në një të dytën (50 përqind) në vitin 2011. Zhvendosja më e madhe për lart ka ndodhur jo aq shumë drejt arsimit të mesëm (nga 25 në 32 përqind), por edhe drejt arsimit të lartë të përfunduar, që është rritur nga 4 në 14 përqind. Ndërsa shpërndarja e nivelit të arsimit të përfunduar ndërmjet meshkujve dhe femrave në vitin 2001 ishte shumë e ngjashme, dhjetë vjet më vonë femrat janë diplomuar më shpesh në arsimin e lartë sesa meshkujt (17 kundrejt 11 përqind).

Ndryshimi në arritjen arsimore të të rinjve është gjithashtu i dallueshëm në shifra absolute. Numri i të rinjve që kanë mbaruar vetëm arsimin e detyruar deri në arsimin 8-vjeçar ka rënë nga 526 në 369 mijë. Nga ana tjetër, numri i kualifikimit në arsimin e mesëm të lartë është rritur nga 186 në 218 mijë (një- ekskluzive e meshkujve- shtesë me 19 përqind), ndërsa stoku i të rinjve me arsim e lartë është rritur nga 28 në 97 mijë, një rritje më shumë se e trefishtë. Numri i shtuar i të rinjve me diplomë të arsimit e lartë përbëhet nga rreth 28 mijë meshkuj dhe madje përafërsisht 40 mijë femra.

Arritjet arsimore i referohen nivelit më të lartë të përfunduar me sukses në sistemin arsimor të vendit ku është arsimuar, edhe nëse arsimi është kryer në shkolla dhe universitete jashtë vendit.

Tabela 6.4: Popullsia e të rinjve të grupmoshës 15-29 sipas vitit të censusit, gjinisë dhe sipas nivelit më të lartë të përfunduar të arsimit

Niveli më i lartë i shkollimit të përfunduar	Viti i censusit, gjinia					
	2001			2011		
	Të dy gjinitë	Meshkuj	Femra	Të dy gjinitë	Meshkuj	Femra
a. Në mijë						
Gjithsej	740.4	358.0	382.4	683.0	362.7	341.6
Asnjë nivel i përfunduar	17.3	9.4	8.0	3.5	1.8	1.7
Fillore	31.4	17.7	13.7	22.3	12.5	9.8
8-vjeçare	477.1	232.1	245.0	341.9	176.0	165.9
Mesme	186.2	88.3	97.9	217.9	122.7	95.2
Universitet	28.4	10.5	17.9	97.4	38.9	58.4
b. Në përqindje						
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	97.0	96.9
Asnjë nivel i përfunduar	2.3	2.6	2.1	0.5	0.5	0.5
Fillore	4.2	5.0	3.6	3.3	3.4	2.9
8-vjeçare	64.4	64.8	64.1	50.1	48.5	48.6
Mesme	25.1	24.7	25.6	31.9	33.8	27.9
Universitet	3.8	2.9	4.7	14.3	10.7	17.1

Burimi: Censusi 2001 dhe 2011 i Popullsisë dhe Banesave

Meqë një pjesë e madhe e të rinjve ndjek akoma arsimin, vëzhgimi i nivelit më të lartë të arsimit është i paplotë dhe nuk përfaqëson nivelet përfundimtare të arritura. Një panoramë më e saktë mund të krijohet nëse shohim grupmoshën 25-29 që përbëhet nga persona të cilët kanë kaluar moshën e lejuar të arsimit. Në *Figurën 6.5* mund të shihet që përqindja e atyre që kanë përfunduar vetëm arsimin e detyruar (deri në arsimin dytësor të ulët) ose pa diplomë është ulur dhe sidomos përqindja që ka mbaruar arsimin e lartë është rritur ndjeshëm nga 8 përqind në vitin 2001 në 24 përqind në vitin 2011.

Figura 6.5: Të rinjtë e grupmoshës 25-29 vjeç, sipas vitit të censusit, gjinisë dhe sipas nivelit më të lartë të arsimit të përfunduar (në përqindje)



Burimi: Censusi 2001 dhe 2011 i Popullsisë dhe Banesave

Pavarësisht përmirësimeve, në këndvështrimin europian, Shqipëria akoma mbetet prapa sa i takon arritjeve arsimore. Vetëm mbi katër të pestat (82 përqind) e popullsisë së BE-së me 28 SHA të moshës 20 deri në 24 vjeç ka përfunduar të paktën nivelin dytësor të lartë të arsimit (Eurostat 2015d), krahasuar me 59 përqind të grupmoshës 20-24 vjeç në Shqipëri. Nëse Shqipëria dëshiron të ndjekë kuadrin strategjik për bashkëpunimin Europian në arsim dhe trajnim i cili u miratua në vitin 2009, duhet të veprojë kundrejt një etaloni të përqindjes me të paktën 40 përqind të popullsisë

së grupmoshës 30-34 vjeç me arritje në arsimin e lartë (ibid.) Në censusin e vitit 2011, kjo grupmoshë ka regjistruar vetëm 16 përqind me arsim të përfunduar të lartë (14 përqind për meshkuj dhe 19 përqind për femra).

6.3.2 Të diplomuar në universitete

Numri i të diplomuarve nga arsimi i lartë është rritur ndjeshëm që në censusin e vitit 2001 dhe vazhdon të rritet: shifra e vitit 2014 është pothuajse dyfish e asaj të vitit 2009. Shkencat humanitare dhe artet janë fusha e studimeve universitare që ka nxjerrë numrin më të madh të diplomimeve, duke llogaritur 41 përqind të të gjitha diplomimeve në vitin 2014 (*Figura 6.6*). Fusha të tjera të mëdha janë Shëndetësia dhe Mirëqenia dhe Bujqësia (secila me 13 përqind të diplomimeve), Arsimi dhe Shkencat Sociale, Biznesi dhe Drejtësia (të dyja me 9 përqind) dhe shkencat natyrore (INSTAT 2015).

Rreth 66 përqind e të diplomuarve në universitet janë gra. Fusha e studimit që është dominuar më shumë nga gratë është Arsimi (83 përqind), i ndjekur nga Bujqësia dhe Shëndetësia dhe Mirëqenia me përkatësisht 77 dhe 76 përqind. Shkencat natyrore, inxhinieria, prodhimi dhe ndërtimi (36 përqind), shkencat natyrore (39 përqind) dhe shërbimet (26 përqind) janë të vetmet fusha ku gratë e diplomuara janë në pakicë.

Figura 6.6: Të diplomuar universitarë sipas fushës kryesore të studimit dhe sipas gjinisë (në përqindje)



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sporteve

6.3.3 Braktisja e shkollës

Edhe pse në një moment të jetës çdo person përfundon karrierën e tij arsimore, vëmendje e veçantë kërkohet për ata që braktisin përpara kohe sistemin arsimor. *Figura 6.7* kombinon informacionin për numrin absolut të personave që nuk marrin pjesë në arsim dhe përqindjen jo-në-arsim e cila shtohet sipas moshës.[27] Braktisje shtesë janë të pakta në numër, por rriten disi deri në moshën 15 vjeçare që i korrespondon periudhës së arsimit të detyruar. Sipas moshës së tranzicionit ndërmjet arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm rreth moshës 15 vjeçare, 6 përqind e djemve dhe 9 përqind e vajzave përfundojnë karrierën e tyre arsimore, shumica me një certifikatë të arsimit bazë të përfunduar. Dy vitet e mëpasshme të të rinjve të rritur tregojnë një nivel të ngritur të braktisjes ndërmjet 5 dhe 7 përqind në vit, deri në një kulm braktisjesh që arrihet në moshën 17 dhe 18, me 19 përqind të djemve dhe 15 përqind të vajzave që braktisin shkollën pas përfundimit të arsimit dytësor të përgjithshëm. Gjithashtu studentët e moshës 18 deri në 19 vjeç kanë tendencë që të përfundojnë arsimin e tyre (një shtesë prej 14 përqind studentë meshkuj dhe 9 përqind studente femra), duke përfaqësuar shpesh studentët të cilët vazhdojnë shkollën e mesme të formimit teknik profesional. Kulmi i tretë nga mosha 21 deri në 24 vjeç nënkupton përfundimin e arsimit të lartë profesional dhe akademik.

Figura 6.7: Popullsia e grupmoshës 6-29 vjeç që nuk ndjek arsimin, sipas gjinisë, dhe moshës (në mijë); dhe përqindja e braktisjeve të reja sipas gjinisë dhe sipas moshës



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Modeli i treguar në *Figurën 6.7* tregon që vajzat janë më shumë të prirura për braktisje në tranzicionin nga arsimi 8-vjeçar në të lartë, ndërsa një përqindje më e madhe e djemve nuk vazhdojnë nga arsimi i mesëm në arsimin e lartë. Së bashku, pothuajse 34 mijë fëmijë të grupmoshës 15-17 vjeç (21 përqind) nuk ndjekin arsimin. Norma më e lartë e braktisjes nga femrat nga 21 vjeç e lart pasqyron normën më të lartë të ndjekjes nga femrat të arsimit të lartë dhe rrjedhimisht edhe normë më të lartë të braktisjes me përfundimin e kësaj faze të arsimit.

27 Duhet vënë në dukje që përqindja e atyre që nuk janë në arsim llogaritet në bazë të diferencës të normave së regjistrimit të moshave të njëpasnjëshme dhe jo në bazë të normave aktuale të tranzicionit.

6.4 ALFABETIZMI[28]

Alfabetizmi është e drejtë themelore e njeriut dhe themeli për mësimin gjatë gjithë jetës. Është tërësisht i rëndësishëm për zhvillimin social dhe njerëzor në aftësinë e tij që të ndryshojë jetën. Alfabetizmi lidhet ngushtë me ndjekjen e shkollës dhe arritjet arsimore. *Figura 6.8* paraqet shkallën e alfabetizmit sipas moshës, veçmas për ata që kanë ndjekur ndonjëherë shkollë dhe për ata që nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën. Në të gjithë popullsinë (kolona më të errët), alfabetizmi është pothuajse universal deri në moshën 70 vjeçare. Megjithatë, për grupin e vogël të personave që nuk kanë ndjekur asnjë shkollë (kolona më ngjyrë të lehtë), shkalla e alfabetizmit është dukshëm më e vogël, duke rënë nga 69 përqind mes 20-24 vjeçarëve në 9 përqind mes atyre të moshës 85 vjeç e lart. Shkalla e përgjithshme e alfabetizimit për personat 70 vjeç e lart ulet me moshën për shkak të përqindjes së personave që nuk kanë ndjekur asnjëherë arsimin e cila rritet me moshën (nga 8 përqind për 70-74 vjeçare në 47 përqind mes atyre të grupmoshave më të mëdha; linja e verdhë), por edhe sepse disa të moshuar thonë që nuk mund të lexojnë apo të shkruajnë sepse kanë humbur shikimin; edhe mes atyre me arsim, alfabetizmi në moshë më të madhe shënon rënie.

Figura 6.8: Shkalla e alfabetizmit sipas moshës dhe statusit të ndjekjes së shkollës; përqindja e atyre që nuk kanë ndjekur arsimin, sipas moshës



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Treguesi i shkallës së alfabetizmit për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është përdorur si një nga treguesit për të monitoruar arritjen e qëllimeve të OZHM 2 - *Arritja e arsimit universal fillor*. Ai pasqyron rezultatin e arsimit fillor gjatë 10 viteve të mëparshme ose përafërsisht dhe është masë e efektivitetit të sistemit të arsimit fillor. Në Shqipëri, shkalla e alfabetizmit të të rinjve është pothuajse universale (99 përqind), ndoshta me përqindjen e vogël që mbetet për ata që nuk mund të lexojnë dhe të shkruajnë për shkak të problemeve shëndetësore fizike ose mendore. Gjithashtu, kur përfshihet grupmosha më e re 15-29 vjeç në popullsinë e të rinjve, shkalla e alfabetizmit qëndron në 99 përqind. Alfabetizmi i të rinjve në censusin e mëparshëm ka qenë po aq i lartë sa në vitin 2011. Së bashku, censusi i 2011 ka regjistruar 8.6 mijë të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç që nuk mund të lexojnë dhe të shkruajnë dhe 67.5 mijë në totalin e popullsisë, më shumë se gjysma (58 përqind) e të cilëve janë 70 vjeç ose më shumë.

Raporti i grave dhe meshkujve që dinë shkrim e këndim, 15-24 vjeç, më parë ka qenë tregues për të monitoruar qëllimin 3 të OZHM - *Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave*. Nisur nga arsimi pothuajse universal fillor për vajzat dhe djemtë në dekadat e fundit, nuk është e çuditshme me dy censuset e fundit është regjistruar barazia për këtë indeks të barazisë gjinore për alfabetizimin.

28 Alfabetizmi përkufizohet si aftësia për shkrim e këndim. Një person që mund të lexojë dhe të shkruajë një deklaratë të shkurtër, të thjeshtë për jetën e tij të përditshme nuk është analfabet.

7 PUNËSIMI

7.1 HYRJE

Gjatë ciklit të jetës, moshat e reja zakonisht përfundojnë arsimin, por shumë prej tyre në të njëjtën kohë punësohen dhe krijojnë karrierë profesionale. Megjithatë të rinjtë janë goditur veçanërisht shumë nga pasojat e krizës financiare dhe ekonomike. Censusi 2011 dhe sidomos Anketat e Forcës së Punës (AFP), të përsëritura herë pas here, japin shumë informacion për vlerësimin e situatës së të rinjve në tregun e punës. Meqë AFP është jo vetëm instrumenti më i mirë për të kuptuar ndërlikimet e tregut të punës, por edhe burimi i statistikave zyrtare për punësimin, kjo anketë ofron bazën kryesore për këtë kapitull. Për të parë më shumë në lidhje me kategoritë e moshës brenda popullsisë së re, përdoren rezultatet e censusit sipas të cilave duhet të vërehet që ato janë më të rëndësishme për të identifikuar modelet specifike dhe jo aq shumë nivelet e treguesve të punësimit. Shumica e gjetjeve tregojnë që sa i përket punësimit dhe papunësisë, të rinjtë përbëjnë një segment të popullsisë me nevoja tepër specifike dhe tërheqëse, me lidhje të ndërlikuara gjinore dhe arsimore.

7.2 PËRFSHIRJA INSTITUCIONALE NË KRIJIMIN E PUNËSIMIT

Që në vitin 1999 në Shqipëri janë zbatuar programe të ndryshme për nxitjen e punësimit (PNP) me qëllim uljen e papunësisë dhe punës informale, rritjen e aftësive të punëtorëve për punë dhe lëvizjen e punëtorëve në punësim rregullisht të pa subvencionuar. Në kohën e censusit të vitit 2011, Shërbimi Kombëtar i Punësimit realizoi katër programe kryesore të nxitjes së punësimit:

1. Programe për nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi, përfshirë të papunët afatgjatë që marrin ndihmë sociale, individët që marrin përfitime papunësie, të rinjtë në tregun e punës, persona të grupmoshës 18-25, persona mbi 45 vjeç me arsim të mesëm ose më pak, persona me aftësi të kufizuara, populli rom dhe migrantët e kthimit që përballen me probleme ekonomike.
2. Programi për nxitjen e punësimit nëpërmjet trajnimit në detyrë.
3. Programi për nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë të diplomuar nga universitete shqiptare dhe ndërkombëtare.
4. Programi për nxitjen e punësimit nëpërmjet trajnimit institucional.

Pavarësisht faktit që rinia ka përqindje shumë të lartë papunësie krahasuar me grupmoshat e tjera, vetëm programi i parë i përmendur ka përfshirë të rinjtë në grupet e synuara. Së fundmi, po zbatohen tre programe shtesë një prej të cilëve (Programi 6 i përmendur më poshtë) ka në shënjestër veçanërisht të rinjtë.

5. Programi për nxitjen e punësimit të punëkërkueseve të papuna nga grupe të veçanta.
6. Programi për nxitjen e punësimit të të rejave të papuna të grupmoshës 16-25 vjeç që hyjnë në tregun e punës për herë të parë (më vonë i shtrirë tek të rinjtë deri në moshën 30 vjeç).[29]
7. Programi për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i relevancës, efektshmërisë dhe eficencës së programeve të nxitjes së punësimit në 2014 (Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë 2014) konkludon që nisur nga vazhdimësia e papunësisë të të të rinjve, efektiviteti i programeve të nxitjes së punësimit të të rinjve është konsideruar i diskutueshëm. Një konkluzion tjetër është që duhet të ketë programe më të diferencuara sipas nevojave të grupeve specifike të synuara (kompanitë dhe punëkërkuesit) nëpërmjet larmisë së programeve dhe/ose krijimit të programeve të reja.

29 Ky program më së shumti ka qenë fitimprurës për kompanitë që veprojnë në fushën e shërbimeve të ushqimit dhe pijeve (26 përqind), tregtinë me shumicë dhe pakicë (21.7 përqind) dhe administratën publike (14.2 përqind) në qytete.

7.3 NË PUNË APO JO? PJESËMARRJA NË TREGUN E PUNËS

7.3.1 Pjesëmarrja në forcën e punës

Rezultatet e censusit 2011 dhe AFP 2011 tregojnë që ndërsa të rinjtë përbëjnë 37 përqind të popullsisë në moshë pune (personat 15-64), përqindja e tyre në popullsinë aktive ekonomikisht (forcë pune, përfshirë personat e punësuar dhe të papunë) ishte më pak se 30 përqind. Ky nën-përfaqësim është pasqyruar në nivelet e ulëta të përqindjes së pjesëmarrjes së forcës së punës.[30] Sipas AFP 2011, përqindja e pjesëmarrjes së forcës së punës e grupmoshës 15-29 vjeç është 54.8, krahasuar me 76.7 përqind të popullsisë të grup moshës 30-64 vjeç (*Tabela 1*; AFP 2011).

Tabela 7.1: Përqindja e pjesëmarrjes në forcën e punës sipas gjinisë dhe grupmoshës kryesore

Mosha	Të dy gjinitë	Meshkuj	Femra
Gjithsej	68.5	76.4	60.8
15-29	54.8	62.2	47.0
30-64	76.7	85.2	68.6

Burimi: AFP 2011

Të dhënat e censusit tregojnë një nivel shumë të ulët të pjesëmarrjes së forcës së punës (37 përqind) krahasuar me të dhënat AFP, por lejojnë shqyrtimin e modeleve të pjesëmarrjes së forcës së punës në popullsinë e të rinjve. Ndarja e mëtejshme e grupmoshës në rezultatet e censusit paraqet një rritje të shpejtë të përqindjes së pjesëmarrjes së forcës së punës të të rinjve gjatë periudhës (*Figura 7.1*). Përqindja e pjesëmarrjes së grupmoshës më të re (15-19) është shumë e ulët, por e grupmoshës më të lartë (25-29) i afrohet nivelit që mbahet nga periudha e mbetur për të rriturit deri në fillim të moshës 50 vjeçare.

Figura 7.1: Përqindja e pjesëmarrjes në forcën e punës sipas moshës dhe gjinisë



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

7.3.2 Arsyet e të mos punuarit

Përqindja e pjesëmarrjes së ulët të forcës së punës nuk është *a priori* tregues negativ i performancës të tregut të punës ose aftësisë së popullsisë për t'u punësuar. Vlerësimi i tyre duhet të bëhet në lidhje me arsyet e të qënurit inaktivë, të cilat në mënyrë specifike vlejnë për të rinjtë. Për të rinjtë, karriera arsimore është procesi kryesor që konkurron me përfshirjen në veprimtari ekonomike: pothuajse dy të tretat (65.9) e personave ekonomikisht inaktivë të grupmoshës 15-29 vjeç janë inaktivë për shkak të përfshirjes në arsim dhe trajnim (*Tabela 7.2*; të dhënat e AFP 2011). Për popullsinë e grupmoshës 30-64 vjeç, rëndësia e kësaj arsyeje është domethënëse.

30 Raporti i personave të punësuar dhe të papunësuar në popullsinë e aftë për punë (15-64) me popullsinë totale të aftë për punë, e shprehur në përqindje.

Tabela 7.2: Popullsia inaktive e grupmoshës 15-64 sipas grupmoshës kryesore, gjinisë dhe arsyes për inaktivitet (në përqindje)

Gjinia	Mosha 15-29			Mosha 30-64		
	Të dy gjinitë	Meshkuj	Femra	Të dy gjinitë	Meshkuj	Femra
Student	65.9	73.9	59.8	0.1	0.2	0.0
Shtëpiak	10.5	0.0	18.5	19.7	0.8	28.2
Të dekurajuar	7.2	8.2	6.5	19.7	24.5	17.5
Tjetër	16.3	17.9	15.2	60.5	74.5	54.3
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Anketa për forcën e punës 2011

Për të rejat femra, krijimi i familjes dhe punët shtëpiake janë karrierë shtesë siç pasqyrohet në përqindjen që nuk punon për shkak të punëve shtëpiake (18.5 përqind). Për të rinjtë meshkuj - si edhe për të rriturit meshkuj- kjo arsye për të mos qenë aktivë ekonomikisht është vitualisht inekzistente, ndërsa tregon që rolet tradicionale gjinore vazhdojnë të ekzistojnë në shoqërinë shqiptare. Roli shtesë i mamasë, shtëpiakes dhe kujdestares është shkaku kryesor për përqindje të pjesëmarrjes së ulët të forcës të punës së të rejave femra (47.0 përqind kundrejt 62.2 përqind për të rinjtë meshkuj; shihni *Tabelën 7.1*; shihni gjithashtu *Figurën 7.1*). Në një masë më të vogël, shkalla më e lartë e regjistrimit të femrave në arsim (shihni kapitullin 6) i shtohet boshllëkut gjinor në veprimtarinë ekonomike të të rinjve. Edhe pse të dyja arsyet ulin pjesëmarrjen e forcës së punës së femrave mes të rinjve, në perspektivën afatgjatë pasojat e tyre ka mundësi që të jetë të kundërta. Ndërsa përfshirja në punë shtëpiake në përgjithësi mund të rrezikojë pavarësinë dhe integrimin e femrave në tregun e punës, regjistrimi më i gjatë në arsim do të forcojë pozicionin e femrave dhe do të rrisë mundësitë në tregun e punës.

Një ndarje tjetër e të rinjve sipas grupmoshës bazuar në të dhënat e censusit tregon që pasoja e arsimit si shkak për mos përfshirjen në aktivitet në tregun e punës është e përqendruar në grupmoshën më të re 15-19 vjeç, më pak në grupmoshën 20-24 dhe pothuajse nuk përmendet fare në grupmoshën e të rinjve më të rritur (25-29) (*Figura 7.2*).[31] Kjo pasqyron përafërsisht regjistrimin përgjithësisht të lartë në arsimin e mesëm, më pak regjistrime në arsimin e lartë dhe arsimin e përfunduar në grupmoshat përkatëse. Edhe pse ky model është i ngjashëm për meshkujt dhe femrat, arsyet që zëvendësojnë arsimin si arsyeja kryesore për të mos qenë aktivë ekonomikisht kanë specifika gjinore. Për femrat janë më së shumti arsyet që lidhen me punë shtëpiake, ndërsa për meshkujt ka arsye të tjera, përfshirë arsyet shëndetësore dhe mungesa e nxitjes për të gjetur një vend pune.

Figura 7.2: Popullsia inaktive e grupmoshës 15-29 vjeç sipas gjinisë dhe moshës dhe arsyes së inaktivitetit (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

31 Duhet të theksohet që arsyet për të mos qenë aktivë të përmendura në census janë të ndryshme nga ato në AFP. Megjithatë, ngjashmëria e kategorive është konsideruar e mjaftueshme për analizën në fjalë.

Konceptualizimi i punësimit dhe papunësisë

Shqipëria zbaton standarde ndërkombëtare[a] për përkufizimin e treguesve të punës. Kështu, *persona të punësuar* përfshijnë të gjithë personat 15 vjeç dhe mbi 10 vjeç të cilët gjatë javës së referencës përpara mbledhjes së të dhënave kanë punuar kundrejt një page ose shpërblimi për të paktën një orë. *Persona të papunë* përfshihen ata persona (mosha 15-74), që kanë qenë (a) pa punë gjatë javës së referencës, (b) aktualisht të gatshëm për punë dhe (c) që kërkojnë punë në mënyrë aktive gjatë katër javëve në përfundim të javës së referencës.[b] Ky raport kufizon moshën më të madhe deri në 64 kur bëhet krahasimi i popullsisë së të rinjve me atë të të rriturve më të vjetër.

Pranohet që për shumë vende, dikotomia standarde e të punësuarve-të papunëve në mënyrë të pamjaftueshme merr parasysh karakteristikat përkatëse të tregut të punës. I tillë është veçanërisht rasti për vendet me sistem të pa maturuar të sigurimeve shoqërore - si sistemi i papunësisë dhe pensioneve - dhe ekonomi informale me punësim me paga të ulëta dhe produktivitet të ulët. Në këto vende, shifrat e papunësisë nuk identifikojnë mungesën e punës së denjë dhe produktive që kërkohet për të siguruar burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme ose mjete jetese. Për të identifikuar këtë pjesë të të punësuarve, ky raport bën dallimin e të *personave të nënpunësuar,* që janë personat që (a) kanë punuar 35 orë ose më pak në javën e referencës dhe (b) janë të gatshëm të punojnë më shumë orë (nënpunësimi i lidhur me kohën). Së bashku me të papunët, të nënpunësuarit përbejnë popullsinë e *të punësuarve që nuk fitojnë*.

a Shihni ICLS 1982.
b Për përkufizime më të plota shihni p.sh INSTAT 2014b.

7.4 PUNËSIMI DHE KARAKTERISTIKAT E PUNËSIMIT

7.4.1 Të rinjtë në punësim

Në vitin 2011, AFP vlerëson që popullsia e punësuar e grupmoshës të aftë për punë është mbi 1.1 milion njerëz, nga të cilët mbi 306 mijë (27.2 përqind) të kategorisë së moshës së të rinjve 15-29 vjeç. Nga këta të rinj në punë 177 mijë janë meshkuj dhe 130 mijë janë femra. Përbri normës së papunësisë (seksioni 7.5.1), raporti punësim-popullsi është treguesi kryesor për të matur aftësinë e një ekonomie për të krijuar punësim. Ky raport është një nga treguesit për të matur progresin drejt objektivit 1B të OZHM për "realizimin e punësimit të plotë dhe me rendiment dhe punë të denjë për të gjithë, përfshirë gratë dhe të rinjtë". Ky tregues i OZHM për Shqipërinë në vitin 2011 bazuar në të dhënat AFP ishte 58.7 përqind në vitin 2011 (*Tabela 7.3*). Për të rinjtë, raporti punësim - popullsi është mjaft më i ulët - 42.8 përqind- sepse përqindja më e madhe e të rinjve është inaktive ekonomikisht (sidomos për shkak të arsimit) ose e papunë (shihni seksionet 7.3 dhe 7.5.1).

Tabela 7.3: Raporti punësim-popullsi sipas gjinisë dhe grupmoshës kryesore

Mosha	Të dy gjinitë	Meshkuj	Femra
Gjithsej	58.7	65.7	51.8
15-29	42.8	48.0	37.3
30-64	68.2	76.7	60.1

Burimi: AFP 2011

Ka një dallim të ndjeshëm në përqindjen e atyre që punojnë sipas moshës dhe gjinisë brenda të gjithë kategorisë së të rinjve. Niveli është më i ulët për të rejat sesa për të rinjtë (37.3 kundrejt 48.0 përqind; *Tabela 7.3*) dhe diferenca sipas moshës është më tepër e shprehur. Sipas të dhënave të censusit, raporti i të punësuarve nga grupmosha e më të rinjve (15-19) është përafërsisht vetëm një e gjashta e shifrës për popullsinë në moshë pune. Nga ana tjetër, për grupmoshën e të rinjve më të mëdhenj (25-29), niveli është mbi atë të popullsisë totale për meshkujt dhe madje mjaft më i lartë për femrat (nuk ka të dhëna).

Që në vitin 2011, situata e punësimit ka rënë ndjeshëm dhe ka ndikuar të rinjtë më shumë sesa popullsia e grupmoshës 30-65 vjeç, ndërsa raporti punësim- popullsi ka rënë nga 68.2 në vitin 2011 në 62.7 përqind në vitin 2014 (një rënie me 8 përqind), ajo e të rinjve nga 42.8 në 28.2 përqind (rënie me 34 përqind). Për të rejat femra, shifra ka qenë vetëm 23.3 (rënie me 38 përqind), që do të thotë se në vitin 2014 më pak se një në katër gra ka qenë në punë.

7.4.2 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: shumë prej tyre në punësim të pambrojtur

Klasifikimi i personave të punësuar sipas statusit në punësim jep të dhëna për llojin e riskut ekonomik me të cilin përballet i punësuari në punë, forcën e lidhjes institucionale ndërmjet personit dhe punës dhe llojin e autoritetit mbi institucionet dhe punëtorët e tjerë. Ekonomitë e avancuara synojnë të kenë përqindje të lartë të punëtorëve në punësim me pagë ose normë ndërsa ekonomitë informale dhe të nën-zhvilluara synojnë të kenë përqindje të madhe të punëtorëve për llogari të tyre. Rëndësia e punëtorëve që kontribuojnë në familje zakonisht tregon edhe zhvillimin e dobët, rritjen jo të madhe të punësimit, varfërinë e përhapur dhe shpesh një ekonomi gjerësisht rurale. Treguesi OZHM 1.7 për të matur progresin drejt punësimit të plotë dhe produktiv dhe punën e denjë për të gjithë (Objektivi 1.B) i grupon këto dy kategoritë e fundit për vlerësimin e përqindjes në "punësim të pambrojtur". Punëtorë për llogari të tyre dhe që kontribuojnë për familjen kanë mundësi më të pakta për të patur marrëveshje formale pune dhe prandaj ka më shumë të ngjarë që të mos i kenë elementët që lidhen me punësimin e denjë si për shembull sigurime të mjaftueshme shoqërore dhe një zë në punë.

Tabela 7.4 tregon për Shqipërinë karakteristikat e një ekonomie të nën-zhvilluar dhe informale me një përqindje relativisht të ulët te punëmarrësve të paguar dhe më pagë dhe përqindje mjaft të larta të punëtorëve të vetpunësuar dhe që kontribuojnë në familje. Shumica e 58.1 përqind e popullsisë së punësuar është klasifikuar si popullsi në punësim të pambrojtur. Punëtorët e rinj nuk e dallojnë shumë veten nga punëtorët e rritur më të vjetër sa i përket statusit në shpërndarjen e punësimit, përveç faktit që përqindja e punëtorëve për llogari të vet është më e vogël dhe ajo e atyre që kontribuojnë në familje - zakonisht brezi i të rinjve që ndihmojnë një biznes familjar- është më e madhe. Në përgjithësi, përqindja në punësim të pambrojtur mes të rinjve (60.6 përqind që i korrespondon 186 mijë të rinjve) është vetëm pak më shumë se ajo e grupmoshës 30-64 (57.2 përqind). Po kështu, raporti i punëmarrësve mes të rinjve (38.2 përqind, 117 mijë persona) është vetëm pak më i vogël sesa popullsia në moshë më të madhe (40.6 përqind).

Tabela 7.4: Popullsia e punësuar sipas statusit në punësim, gjinisë dhe grupmoshës kryesore

Gjinia dhe grupmosha	Gjithsej	I punësuar me pagë	I vetpunësuar me punëtorë	I vetpunësuar pa punëtorë	Punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes	Punësuar me pagesë si raport ndaj popullsisë gjithsej	Pëqindja e punësimit vulnerabël
Të dy gjinitë	100.0	40.0	1.9	27.3	30.8	40.0	58.1
15-29	100.0	38.2	1.2	16.7	43.9	38.2	60.6
30-64	100.0	40.6	2.1	31.3	25.9	40.6	57.2
Meshkuj	100.0	43.3	2.4	32.8	21.6	43.3	54.3
15-29	100.0	41.3	0.8	17.8	40.1	41.3	57.9
30-64	100.0	44.1	3.0	38.6	14.3	44.1	52.9
Femra	100.0	35.8	1.2	20.5	42.5	35.8	63.0
15-29	100.0	34.0	1.7	15.1	49.2	34.0	64.3
30-64	100.0	36.4	1.0	22.4	40.1	36.4	62.5

Burimi: AFP 2011

Profilet gjinore tregojnë dallime më të mëdha me një përqindje relativisht të lartë të të rinjve meshkuj të punësuar me pagë dhe shpërblim me normë (41.3 përqind) dhe një përqindje relativisht të lartë të të rejave femra që punojnë si pjesëtare kontribuese në familje (49.2) Rrjedhimisht, punëtoret e reja kanë normë më të lartë punësimi të pambrojtur sesa meshkujt (64.3 kundrejt 57.9 përqind).

Të dhënat e AFP 2014 sugjerojnë një ndryshim pozitiv në kuptimin që norma e përgjithshme e punësimit të pambrojtur ka rënë për shkak të ndryshimit të shpërndarjes në statusin e punësimit nga punëtori që punon për llogari të vetes dhe ai që kontribuon në familje tek punëmarrësit formalë. Ky kalim është përqendruar pothuajse në mënyrë ekskluzive tek kategoria e të rinjve dhe sidomos e të rejave femra. Norma e punësimit të pambrojtur të të rinjve u ul nga 60.6 në 47.7 përqind (përfaqëson 95 mijë persona) me pothuajse të njëjtin nivel për të dyja gjinitë.

7.4.3 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: cilët janë sektorët ku punojnë të rinjtë?

Bujqësia mbetet deri tani sektori më i rëndësishëm i veprimtarisë ekonomike në Shqipëri sa i përket punësimit. AFP 2011 tregon që 44.1 përqind e personave në punë janë të punësuar në këtë sektor të ndjekur nga shërbimet e tregut (20.7 përqind)[32] dhe shërbimet jo të tregut (15.9 përqind) (*Tabela 7.5*).[33] Për të rinjtë, sidomos për femrat e reja, sektori i bujqësisë është akoma më i rëndësishëm për mundësitë e punësimit (për 51.1 përqind), në shumë raste për punëtorët që kontribuojnë në familje. Ky sektor ka punësuar rreth 157 mijë të rinj në vitin 2011. Shërbimet e tregut dhe ndërtimi së bashku thithin 37.0 përqind të të rinjve të punësuar (65 mijë meshkuj), ndërsa shërbimet e tregut dhe jo të tregut së bashku përfshijnë 30.1 përqind të të rejave të punësuara (39 mijë), sidomos në funksionet administrative.

Tabela 7.5: Popullsia në moshë pune e punësuar sipas aktivitetit ekonomik, gjinisë dhe grupmoshës kryesore

Mosha	Gjithsej	Bujqësi	Prodhim	Ndërtim	Miniera dhe gurore, energji elektrike, gaz dhe ujësjellës	Tregti	Shërbime jo tregtare
Të dy gjinitë	100.0	44.1	7.9	8.4	3.0	20.7	15.9
15-29	100.0	51.1	6.7	10.3	1.6	18.8	11.5
30-64	100.0	41.5	8.3	7.7	3.6	21.4	17.5
Meshkuj	100.0	36.9	6.9	13.9	4.6	23.4	14.4
15-29	100.0	44.7	6.3	15.8	2.8	21.2	9.3
30-64	100.0	33.8	7.1	13.1	5.4	24.2	16.4
Femra	100.0	53.3	9.1	1.5	1.0	17.4	17.8
15-29	100.0	59.9	7.2	2.9	0.0	15.6	14.4
30-64	100.0	50.9	9.8	1.0	1.4	18.0	18.9

Burimi: AFP 2011

Njësoj si zhvendosjet e vërejtura në statusin e punësimit, ndryshimet në shpërndarjen e sektorëve të punësimit të orientojnë tek një transformim i ekonomisë shqiptare, i cili ka prekur në veçanti punësimin e të rinjve. Në vitin 2014, sektori i bujqësisë ka punësuar vetëm 38.1 përqind të të rinjve (13 pikë përqindje më pak se në vitin 2011: nuk jepen të dhëna). Gjithashtu sektori i ndërtimit ka humbur një pjesë të dukshme të personave të punësuar, kryesisht meshkuj, (4.2 pikë përqindje), ndërsa sektorët e shërbimeve të tregut dhe prodhimit janë bërë relativisht më të rëndësishme (përkatësisht 10.1 dhe 4.2 pikë përqindje). Duhet theksuar që të gjithë sektorët ekonomikë kanë pësuar rënie të personave të punësuar në terma absolute,[34] për shkak të zhvendosjes së përgjithshme nga punësimi në papunësi dhe sidomos inaktivitet.

7.4.4 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: çfarë profesione kanë ata?

Në përputhje me shpërndarjen e punësimit në sektorin ekonomik, grupi i profesioneve që përfshin punëtorët në bujqësi është kategoria më e madhe dhe përsëri sidomos për të rinjtë e punësuar (62.8 përqind) (*Tabela 7.6*). Është interesante të vërehet që edhe pse numri i përgjithshëm i meshkujve dhe femrave të punësuara në profesione me kualifikime më të mëdha (menaxherë, profesionistë dhe teknikë) është pothuajse i njëjtë; në shumicën e femrave të reja mbizotëron ky grup profesionesh (vlerësohet 21 mijë kundrejt 16 mijë meshkujve) për të cilin arsimimi i gjatë i femrave është ndoshta faktor kontribues.

32 Tregtia, transporti, akomodimi dhe ushqimi dhe shërbimet e biznesit dhe administrative
33 Administrata publike, shërbime komunitare, sociale dhe të tjera dhe veprimtari
34 Me përjashtimin e mundshëm të sektorit të prodhimit.

Tabela 7.6: Popullsia e punësuar në moshë pune sipas profesionit dhe gjinisë, grupmoshës kryesore

Mosha	Gjithsej	Nënpunës të lartë, drejtues dhe teknikë	Nënpunës, punonjës të shitjeve dhe shërbimeve	Punëtorë të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit	Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	Punëtorë	Forca të armatosura
Të dy gjinitë	100.0	12.9	17.0	55.5	7.0	6.8	0.7
15-29	100.0	11.9	13.7	62.8	4.5	6.4	0.7
30-64	100.0	13.2	18.3	52.8	8.0	7.0	0.8
Meshkuj	100.0	11.7	17.5	53.3	9.9	6.3	1.3
15-29	100.0	9.1	14.5	62.0	6.1	7.1	1.2
30-64	100.0	12.7	18.6	49.8	11.5	6.0	1.3
Femra	100.0	14.3	16.5	58.3	3.4	7.4	0.1
15-29	100.0	15.8	12.6	63.8	2.3	5.5	0.0
30-64	100.0	13.8	17.8	56.4	3.8	8.1	0.1

Burimi: AFP 2011

Kategoria e menaxherëve, profesionistëve dhe teknikëve është gjithashtu i vetmi grup profesionesh që është rritur në përmasa në terma absolute dhe relative ndërmjet 2011 dhe 2014, ndërsa grupi i profesionit që përfshin punëtorët në bujqësi ka humbur shumicën e personave të punësuar në terma relative dhe absolute gjatë kësaj periudhe.

7.4.5 Karakteristikat e të rinjve të punësuar: a janë të përshtatshëm për punën e tyre?

Mospërputhja e kualifikimeve është një nga sfidat kryesore të hasura nga ekonomitë. Prova empirike tregojnë që, në shumë raste, punëtorët nuk përputhen me punën që bëjnë. Disa janë të mbi-kualifkuar për punën që bëjnë - ata janë në gjendje të kryejnë detyra më komplekse dhe kualifikimet e tyre nuk përdoren mjaftueshëm- ndërsa të tjerët janë jo mjaft të kualifikuar për punën e tyre aktuale- atyre u mungon kualifikimi që normalisht nevojitet. Nën-kualifikimi ka mundësi që të ndikojë negativisht në rendimentin dhe cilësinë e punës. Mbi-kualifikimi mund të çojë në humbje të kualifikimeve dhe të burimeve që janë përdorur për të fituar këto aftësi. Gjithashtu, punëtorët e mbi-kualifikuar fitojnë më pak se punëtorët të cilët janë përputhur mirë me punën e tyre dhe janë më të pakënaqur në punë. Kjo situatë gjeneron më shumë rotacion të punëmarrësve dhe kjo mund të ndikojë në rendimentin e kompanisë.

Në bazë të të dhënave AFP, është llogaritur një "masë normative" e mospërputhjes së kualifikimeve dhe i cakton kualifikimet e kërkuara arsimore grupeve specifike të profesioneve.[35] Mospërputhje ndodh kur një person ka kualifikim më të lartë ose më të ulët sesa niveli që kërkohet në punën e personit. *Figura 7.3* tregon që të rinjtë e punësuar me arsim dytësor punojnë në një punë që përshtatet me nivelin e tyre arsimor: vetëm 4.5 përqind punojnë në punë që kërkon më pak ose më shumë se arsimin e mesëm. Nga ana tjetër, norma e mospërputhjes për punëtorët e rinj në arsim e lartë ka qenë shumë e lartë - 33.5 përqind në vitin 2011. Meqë ky është grupi me arsimin më të lartë, mospërputhja nënkupton që personat janë të mbi-kualifikuar për punën e tyre. Këto norma të larta mospërputhjeje janë tregues ose i tregjeve të punës me papunësi të lartë ose përputhje e keqe ndërmjet atyre që dalin nga sistemi arsimor dhe kërkesës së tregut të punës ose kombinim i të dyjave. Kërkime të mëtejshme duhet të bëhen për të parë mundësitë që sistemi arsimor të përshtatet më mirë me kërkesat e tregut të punës. Të dhënat AFP 2014 tregojnë rritje në nivelin e mospërputhjes së kualifikimeve, e cila është tendencë në përputhje me vende të tjera në Europë gjatë krizës ekonomike (ILO 2014).

35 Metodologjia bazuar në klasifikimet ISCED dhe ISCO për arsimin dhe profesionin, përshkruhet në ILO 2014a.

Figura 7.3: Norma e mospërputhjes së kualifikimeve të popullsisë me të paktën arsim të mesëm, sipas nivelit më të lartë arsimor dhe sipas vitit të anketimit



Burimi: AFP 2011 dhe 2014

Duhet theksuar që shkalla e mospërputhjes së paraqitur bazohet në kualifikime më shumë sesa në aftësi. Vlerësimi i Nevojave për Kualifikime në Shqipëri 2014 tregon që - nga këndvështrimi i bizneseve, problemi kryesor nuk është niveli i kualifikimit, por më shumë është përshtatshmëria e llojit të aftësive të fituara në arsim dhe trajnim që ka munguar (ILO 2014b). Megjithatë, kjo përsëri vë në dukje rëndësinë e përmirësimit të relevancës së kurrikulave të arsimit dhe njohja e kualifikimeve profesionale dhe të lartë nuk është garanci për punësim ose punë të denjë.

7.4.6 Puna e fëmijëve

Në kontekstin shqiptar të një ekonomie tepër informale dhe bujqësore dhe rëndësisë së punëtorëve që kontribuojnë në familje, epërsia e punës së fëmijëve ka mundësi që të jetë relativisht e lartë. Puna e fëmijëve është kategori e punës së kryer nga fëmijët e moshës 5-17 që, për nga natyra ose kohëzgjatja, konsiderohet e dëmshme për një fëmijë të një moshe specifike (ILO 2008). Segmenti i kësaj grupmoshe që është 15-17 vjeç mbivendoset me grupin e synuar të të rinjve që është objekti i këtij raporti. Të dhëna të anketës mund të japin informacion të kufizuar për punën e fëmijës për këtë segment të vogël, por problemet e identifikuara në bazë të të dhënave të përgjithshme të punës së fëmijës kërkojnë mjaftueshëm vëmendje për fëmijët 15-17 vjeç gjithashtu.

Anketa 2010 Kombëtare për Punën e Fëmijëve tregon që në Shqipëri 5.1 përqind e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç (6.2 përqind e djemve dhe 3.9 përqind e vajzave) janë të përfshirë në punën (ILO dhe INSTAT 2012). Shumica e këtyre fëmijëve (80.6 përqind) punojnë në bujqësi dhe si pjesëtarë të papaguar të familjes (95.2 përqind). Për shkak të punës me orë të zgjatura dhe/ose kushteve të rrezikshme, punëtorët fëmijë janë në disavantazh krahasuar me fëmijët e tjerë. Kështu, 89.1 përqind e të rinjve jo në moshë pune, të grupmoshës 15-17 vjeç kanë ndjekur shkollën, krahasuar me vetëm 54.0 përqind të punëtorëve fëmijë në këtë segment moshe. Gjithashtu, mes të gjithë fëmijëve punëtorë, 10.8 përqind kanë vuajtur plagë dhe/ose sëmundje si rezultat i punës së kryer prej tyre.

7.5 BURIME TË PASHFRYTËZUARA PËR TË RINJTË: PAPUNËSIA DHE NËN-PUNËSIMI

7.5.1 Papunësia dhe nën-punësimi[36]

Papunësia e të rinjve dhe mundësitë e punësimit të të rinjve shihen si një çështje e rëndësishme politikash për shumë vende. Të rinjtë janë më shumë të pambrojtur dhe të zhgënjyer nga mundësitë e jetesës dhe kjo ndikon negativisht në aftësinë e të rinjve për të filluar një jete të pavarur dhe të plotë. Të rinjtë janë gjithashtu të ndikuar nga kriza e fundit ekonomike (KE 2013, ILO 2012) dhe papunësia e përhapur mes të rinjve mund të jetë shkak i rëndësishëm i trazirave sociale që prekin komunitetet dhe mbarë shoqërinë.

Shkalla e papunësisë[37] është tregues kyç për të matur kapacitetin e tregut të punës për t'i dhënë mundësi punësimi popullsisë dhe për të matur përdorimin e forcës së punës. Për Shqipërinë, AFP 2011 tregon një shkallë papunësie për të rinjtë në 21.9 përqind (*Tabela 7.7*), duke sugjeruar që rreth 86 mijë persona të moshës 15-29 vjeç- 52 mijë të rinj meshkuj dhe 34 mijë të reja femra- nuk mund të gjenin punë. Shifra për të rinjtë është dy herë më e lartë sesa ajo për popullsinë e mbetur të të rriturve (11.1 përqind) e cila është gjetje e përbashkët për shumë vende. Të dhënat e censusit 2011 tregojnë që shkalla e papunësisë është veçanërisht e lartë në grupmoshën e të rinjve më të vegjël (15-19). 40 përqind më e lartë sesa ajo e të gjithë popullsisë të grupmoshës 15-29 vjeç.

Tabela 7.7: Shkalla e papunësisë, shkalla e papunësisë e lidhur me kohën dhe shkalla e punësimit jo fitimprurës sipas gjinisë dhe grupmoshës kryesore (2011)

Mosha	Shkalla e papunësisë			Shkalla e nën-punësimit të lidhur me kohën			Shkalla e punësimit jo fitimprurës		
	Të dyja gjinitë	Meshkuj	Femra	Të dyja gjinitë	Meshkuj	Femra	Të dyja gjinitë	Meshkuj	Femra
Gjithsej	14.3	14.0	14.7	10.7	12.2	8.8	25.0	26.2	23.6
15-29	21.9	22.8	20.6	14.2	15.9	11.9	36.1	38.7	32.5
30-64	11.1	10.0	12.4	9.2	10.5	7.7	20.3	20.4	20.1

Burimi: AFP 2011

Ulja e përqindjes së punësuar ndërmjet 2011 dhe 2014 (seksioni 7.4.1) është pasqyruar në një rritje të ndjeshme të papunësisë gjatë të njëjtës periudhë. Kjo rritje përjetohet veçanërisht nga të rinjtë për të cilët norma e papunësisë është rritur nga 21.9 përqind në 2011 në 32.5 përqind në 2014 (rritja me 49 përqind). Për një grupmoshë më të vjetër të të rriturve 30-64, rritja korresponduese është shprehur më pak: nga 11.1 në 13.3 përqind (një rritje prej 20 përqind). Në përgjithësi, meshkujt preken më shumë se femrat, ku shkalla e papunësisë për të rinjtë dhe të rriturit rritet me 56 dhe 41 përkatësisht.

Në statistika ndërkombëtare, treguesi standard për papunësinë e të rinjve i referohet grupmoshës 15-24 vjeç. Për Shqipërinë, shkalla e papunësisë 2011 për grupmoshën 15-24 vjeç ishte 23.9 përqind, por u rrit ndjeshëm në 39.0 përqind në vitin 2014 (Anketa e Forcës së Punës në Shqipëri).[38] Shkalla mesatare e papunësisë të të rinjve në 28 vende të BE në vitin 2012 ishte 23.3 përqind (banka e të dhënave të Eurostat), edhe pse vendet ne rajon shpesh kanë pasur shkallë mjaft më të larta papunësie të të rinjve. Greqia 55.3 përqind, Kroacia 42.1 përqind, Kosova 55.3 përqind.

Shifrat e censusit 2011 tregojnë një marrëdhënie inverse ndërmjet nivelit arsimor dhe shkallës së papunësisë: sa më i lartë niveli arsimor, aq më e ulët shkalla e papunësisë (p.sh INSTAT 2014b). Megjithatë, kjo mund të jetë një panoramë e trazuar për shkak të raportimit të paplotë në census të fermerëve që prodhojnë për konsumin e tyre.[39] AFP sugjeron një marrëdhënie të kundërt: norma e papunësisë të të rinjve rritet me arsimin e përfunduar nga 18 përqind për ata që kanë mbaruar vetëm arsimin fillor, 23 përqind për ata që kanë mbaruar arsimin e mesëm dhe afërsisht 30 përqind për personat që kanë mbaruar arsimin e lartë (*Figura 7.4*). Nëse e shohim nga afër, kjo lidhje më së shumti shkaktohet nga një lidhje akoma më shumë e shprehur ndërmjet arsimit dhe papunësisë së grave, me rreth një në tre gra me arsim e lartë të cilat janë të papuna. Nga ana tjetër për meshkujt në kategorinë e moshës 15-29 vjeç ka shumë pak ndryshim në shkallën e papunësisë duke pasur parasysh arritjet arsimore.

36 Për përkufizimin e papunësisë dhe nën-punësimit shihni kutinë në seksionin 7.4
37 Norma e papunësisë llogaritet si përqindje e forcës së punës (të përbërë nga të punësuar dhe të papunë), që është e papunë.
38 Procedura standarde të matjes nuk përdoren për nëngrupin e 15-24 vjeçarëve. Prandaj këto shifra i nënshtrohen kufirit më të lartë të gabimit.
39 Meqë ka mundësi që përfshirja në bujqësi për konsum vetja të jetë e lidhur negativisht me arsimin e kryer, raportimi i pasaktë i papunësisë ka më shumë të ngjarë të ndodhë në lidhje me ata që kanë arsim më të ulët.

Analizë më e thellë kërkohet për të shpjeguar marrëveshjet specifike gjinore ndërmjet arsimit dhe papunësisë në AFP, por kjo është përtej qëllimit të këtij raporti. Një linjë shpjegimi mund të eksplorojë ndikimin e parimit të mashkullit që fiton bukën e gojës. Kjo kërkon që meshkujt të sigurojnë të ardhura për familjen, e cila nisur nga mundësitë e pakta për punë mund t'i nxisë që të pranojnë çdo punë, edhe nëse është nën nivelin e aftësive të tyre. Me bashkëshortët që sigurojnë të ardhura në familje, gratë mund të jenë më tepër selektive në gjetjen e një pune dhe mund të zgjedhin që të kenë një periudhë papunësie. Gjithashtu, gra më arsim të lartë kanë tendencë që të kenë partnerë me arsim të lartë të cilët janë relativisht të prirur që të paguhen mirë, gjë kjo që mund të ndikojë në kërkimin e përzgjedhur të punës nga ana e grave.

Figura 7.4: Shkalla e papunësisë së të rinjve sipas nivelit më të lartë arsimor dhe gjinisë



Burimi: AFP 2011

Përveç papunësisë së qartë, shumë të rinj janë të punësuar në punë që nuk janë shpërblyese dhe mjaftueshëm produktive, siç tregohet nga 14.2 përqind e forcës së punës së të rinjve në situatë nën-punësimi (Tabela 7.7.) Së bashku me të papunët, kjo rezulton në 36.1 përqind të forcës së punës së të rinjve - 142 mijë persona - të cilët nuk janë në punësim fitimprurës. Kjo situatë më tej theksohet nga gjetja që për pjesën e mbetur të forcës së punës së të rriturve (mosha 30-64), norma e përgjithshme e të punësuarve pa fitim është e njëjtë për meshkujt dhe për fermat (vetëm mbi 20 përqind). Një shpjegim i mundshëm i kësaj pasoje është performanca më e përmirësuar edukative e brezave të të rinjve të grave krahasuar me atë të meshkujve.

Duhet të theksohet që situata e punësimit të vajzave dhe grave të reja sa i përket papunësisë dhe nën-punësimit është më e mirë sesa ajo e djemve dhe e meshkujve të rinj. Rreth 32.5 përqind e të rejave femra është në punësim jo fitimprurës krahasuar me 38.7 përqind të meshkujve të rinj.

Tjetër tregues për të matur potencialin e pashfrytëzuar të të rinjve është përqindja që nuk është në punësim, arsim ose trajnim (NEET). Këta të rinj janë veçanërisht në rrezik në tregun e punës dhe për përjashtimin social sepse as nuk përmirësojnë aftësinë e tyre të punësimit në të ardhmen nëpërmjet investimit në aftësi, as nuk fitojnë përvojë përmes punësimit. Norma NEET e Shqipërisë në vitin 2011 tregon që 30.0 përqind e personave të moshës 15-29 vjeç nuk janë përfshirë në punësim, arsim ose trajnim dhe kjo është shumë e lartë krahasuar me vendet e BE-së. Seria e AFP tregon një rritje graduale në nivelin e NEET nga 27.4 përqind në vitin 2007 në 34.5 përqind në vitin 2014.

Edhe pse normat e regjistrimit të femrave në arsim janë më të larta sesa normat përkatëse të meshkujve (shihni kapitullin 5***) tërheqja specifike gjinore e përgjegjësive shtëpiake rezulton në norma vazhdimisht më të larta të NEET për gratë (në vitin 2011 33.6 përqind krahasuar me 26.6 për femrat).

7.5.2 Kohëzgjatja e papunësisë

Edhe pse papunësia përgjithësisht është një gjendje e pa-preferuar, papunësia afatgjatë - e përkufizuar si punësim që zgjat 12 muaj ose më shumë - mund të ketë pasoja të rënda për personat e përfshirë. Studimi empirik ka treguar që kohëzgjatja e papunësisë ndikon negativisht në mundësinë për të gjetur një punë (të re). Të jesh i papunë domethënë të humbasësh aftësitë e fituara dhe të bëhesh person më pak tërheqës për punëdhënësit e mundshëm. Veçanërisht e rëndësishme për të rinjtë e papunë është fakti që papunësia e zgjatur në fillim të karrierës së dikujt mund të reduktojë përgjithmonë fitimet e ardhshme, të ulë mundësitë për punë dhe të vonojë fitimin e aftësive të çmuara në punë. Përqindja e të papunëve afatgjatë në numrin total të të papunëve është informacion i rëndësishëm për politikë bërësit.

Përqindja e të papunëve afatgjatë në numrin total të të rinjve të papunë ishte 63.1 përqind në vitin 2011 (*Figura 7.5.*). Kjo përqindje është më e lartë se çdo vend tjetër në BE në të njëjtin vit dhe meriton vëmendje të veçantë nga politikë bërësit. Përqindja e të papunëve afatgjatë është më e lartë tek të rinjtë me arsim të mesëm (70.8 përqind) dhe më e ulët - por përsëri shumë e lartë- tek ata me arsim e lartë. Të rejat zënë pjesën më të vogël të femrave të papunave afatgjata krahasuar me meshkujt, përveç femrave me arsim e lartë (këtu nuk jepen të dhëna).

Figura 7.5: Përqindja e të papunëve afatgjatë mes të rinjve të papunë sipas arsimit më të lartë dhe sipas gjinisë



Burimi: AFP 2011

7.6 TRANZICIONI NË PUNË TË DENJË: NË KËRKIM TË NJË PUNE SHPËRBLYESE

Politikat e punësimit dhe planifikimi i fuqisë punëtore synon shfrytëzimin e plotë të punës ekzistuese dhe dhënien e mundësive për punë të denjë, që është punë produktive dhe shpërblyese dhe që mund të kryhet në kushtet e lirisë, barazisë, sigurisë dhe dinjitetit të njeriut (ILO, 2014a). Analizimi i pengesave për të siguruar punë të denjë mund të mbështesë politikë bërësit për zhvillimin e programeve të efektshme të punësimit.

Një këndvështrim i rëndësishëm në këtë drejtim është analiza e tranzicionit në punë të denjë. *Tabela 7.8* përshkruan se si të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç janë të shpërndarë në tre faza të tranzicionit- përpara tranzicioni, në tranzicion dhe pas përfundimit të tranzicionit – dhe në statuset e ndryshme brenda këtyre fazave të cilat identifikojnë grupet e mundshme të synuara për programet e punësimit. Ajo tregon që vetëm një përqindje e vogël (rreth 9 përqind në 2011 dhe 2014) nga gjithë popullsia e të rinjve janë të punësuar në kushte pune të denja. Përqindja e të punësuarve por në tranzicion për në punë më të mira në vitin 2011 ishte 34 përqind dhe përfshinte personat që jo me dëshirën e tyre punojnë me orë të shkurtuara pune (nën-punësimi i lidhur me kohën) ose punojnë përkohësisht, persona që punojnë në punësim të pambrojtur (punëtorë për llogari të tyre dhe punëtorë që kontribuojnë në familje) dhe punëtorë kushtet e punës së të cilëve nuk plotësojnë standardet e tyre ose standardet për punë të denjë.

Gjithashtu, personat në tranzicion për punë të denjë përfshijnë personat e papunë në situata të ngjashme me papunësinë, për shembull studentët që kërkojnë punë dhe punëtorët e pa inkurajuar (personat që janë të gatshëm për punë, por që nuk kërkojnë punë në mënyrë aktive, sepse mendojnë që nuk do të gjejnë punë), përbëjnë rreth 15 përqind të 15-29 vjeçarëve. Në përfundim, përqindja që nuk u përfshi (akoma) në tranzicionin për punë përbëhet nga studentë që nuk po kërkojnë (akoma) punë dhe persona që kanë mbetur inaktivë për arsye të tjera. Në vitin 2011, përqindja e të rinjve pa tranzicion ishte përafërsisht 42 përqind. Ajo u rrit në rreth 52 përqind në vitin 2014 kryesisht për shkak të përqindjes më të madhe në shkolla. Vazhdimi i shkollës ose kthimi në arsim është strategji e përbashkët për të rinj kur mundësitë për punësim bëhen të pakta.

Tabela 7.8: Popullsia e grupmoshës 15-29 vjeç sipas statusit të tranzicionit të tregut

Faza e tranzicionit, statusi i tranzicionit	2011	2014
Të gjithë të rinjtë e grupmoshës 15-29	100.0	100.0
Pa tranzicion	41.9	51.7
Në shkolla	29.8	37.3
Inaktiv	12.1	14.4
Në tranzicion	49.3	39.1
Punëtorë të dekurajuar	3.3	6.5
Në shkollë dhe në kërkim për punë	1.7	1.1
Punëtor me kohë të pjesshme pa dëshirën e tij	3.8	5
Punëtor i përkohshëm pa dëshirën e tij	1.3	1.6
Të tjerë të papunë	10.3	12.5
Në punësim të pambrojtur	22.7	9.2
Punëtorë që dëshirojnë të ndryshojnë punën	1.4	0.7
Punëtorë me mungesa në punë të denjë	4.9	2.5
Tranzicioni në punë të denjë i realizuar	8.7	9.2

Burimi: AFP 2011

Shuma e shifrave mund të jetë 100 përqind për shkak të rrumbullakosjes.

8 SHËNDETI

8.1 HYRJE

Shëndeti është i rëndësishëm për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë gjatë dhe të shëndetshëm, të mbrohen nga aksidente dhe sëmundje dhe të marrin shërbimet e duhura të kujdesit shëndetësor. Shëndeti është gjithashtu një element kyç i cilësisë së jetës dhe një popullsi e shëndetshme është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e një vendi. Të rinjtë bëjnë disa zgjedhje në jetën e tyre të cilat mund të rrisin rrezikun e sëmundjes si edhe të çojnë në jetëgjatësi më të ulët.

Gjatë adoleshencës dhe rinisë, njerëzit përjetojnë tranzicion të rëndësishëm biologjik, fizik, kognitiv dhe social. Kjo grupmoshë përballet me shumë sfida dhe vendimet që mund të marrin ata mund të ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e tyre në periudhën afatgjatë. Shumë zgjedhje të rëndësishme për stilin e jetesës, që mund të përfshijnë sjellje jo të shëndetshme, bëhen gjatë tranzicionit nga fëmijëria në moshë madhore. Të gjesh një përkufizim për sjellje të rrezikshme është e vështirë, sepse ka shumë forma dhe shkaqet për këto sjellje janë komplekse dhe të larmishme. Elementi i përbashkët dhe i detyrueshëm i të gjitha llojeve të sjelljeve është fakti që të rinjtë ekspozojnë jetën dhe trupin e tyre ndaj rreziqeve, në shumë raste, duke e ditur që rezultati mund të jetë negativ. Sjellje të rrezikshme mund të shprehen në disa zgjedhje të pashëndetshme të stilit të jetesës, që variojnë nga përdorimi i duhanit dhe pijes dhe drejtim automjeti, dhe madje sjellje seksuale, ndërsa ndikimi i tyre në shëndet mund të shfaqet nëpërmjet rreziqeve në rritje për të përballuar kushtet si sëmundjet kardiovaskulare, kanceri, shëndeti mendor dhe sëmundjet e transmetuara seksualisht.

Të rinjtë përballen me sfida të reja dhe probleme me të cilat brezat e mëparshme shqiptare nuk janë hasur. Në Shqipëri, shumë ndryshime në stilin e jetës kanë ndodhur për shkak të reformës sociale dhe politike që ka ndodhur në vitet 1990 dhe 2000; ka të dhëna që institucione tradicionale sociale dhe rrjete po dobësohen dhe që vlera e tyre po transformohet. Ndërsa të rinjtë duket se tani kanë më shumë mundësi dhe zgjedhje sesa prindërit, ata përballen edhe me më shumë rreziqe. Të rinjtë tani kalojnë më shumë kohë në shkollë (shihni kapitullin 6), jetojnë në njësi ekonomike familjare më të vogla (kapitulli 4) dhe kanë akses më të madh në mas media dhe më shumë liri lëvizjeje. Për shkak të tranzicionit ekonomik dhe politik, të rinjtë tani jetojnë në kushte ku sistemet arsimore dhe familjare kanë ndryshuar thellësisht. Pavarësisht disa ndryshimeve në dukje pozitive, të rinjtë përballen me sfida të shumta ekonomike dhe sociale.

Ky kapitull paraqet një sërë treguesish të shëndetit të të rinjve në Shqipëri duke mbuluar gjendjen e vetë vlerësuar shëndetësore (seksioni 8.2), shëndetin riprodhues (8.3), çështje të përgjithshme shëndetësore si përdorimi i substancave dhe aftësitë e kufizuara (8.4) dhe vdekshmërinë (8.5). Censusi 2011 i Popullsisë dhe Banesave përfshin vetëm informacion të kufizuar në lidhje me shëndetin, në thelb vetëm informacion për aftësinë e kufizuar. Informacion dhe të dhëna të rëndësishme për këtë kapitull janë marrë nga anketa të tjera - si Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) dhe Studimi për Demografinë dhe Shëndetin si edhe publikime nga agjenci të tjera. Megjithatë, informacion i besueshëm i përditësuar është i pakët për shumicën e temave që mbulohen në këtë dokument.

8.2 GJENDJA SHËNDETËSORE

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) përcakton shëndetin si "gjendje të mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo vetëm si mungesë të sëmundjeve apo dobësive" që orienton tek natyra e saj shumëdimensionale. Përfshihen edhe mënyra të ndryshme të matjes së shëndetit si mbledhja e të dhënave objektive nga ofruesit e kujdesit shëndetësor ose të dhënave subjektive për funksionimin fizik, mirëqenien emocionale, dhimbjen ose shqetësimin dhe perceptimin e përgjithshëm për shëndetin.

Shëndeti i vetë-vlerësuar, nga natyra që ka, është subjektiv. Nocioni është i kufizuar me vlerësimin që bëhet nga individi. Edhe pse mund të ndikohet nga përshtypjet ose opinionet e të tjerëve, vlerësimi bëhet ndodh pas përpunimit të këtyre përshtypjeve nga individët në lidhje me besimin dhe sjelljen e tyre. I bëhet referencë shëndetit në përgjithësi dhe jo gjendjes aktuale shëndetësore.

Përgjithësisht, të rinjtë janë në kushte më të mira shëndetësore dhe ndihen më të shëndetshëm sesa grupmoshat më të rritura. Megjithatë, kjo periudhë e jetës kërkon vëmendje të veçantë sepse sjellja që lidhet me shëndetin përcaktohet gjatë adoleshencës dhe ndikohet fuqishëm nga faktorët socialë.

Shumica e të rinjve në Shqipëri e vlerësojnë veten në gjendje të mirë ose shumë të mirë shëndetësore

Të dhënat e AMNJ vërejnë një tendencë disi në rritje që në vitin 2002 të përqindjes së të rinjve që e vlerësojnë veten në gjendje të mirë ose shumë të mirë shëndetësore (*Figura 8.1*). Që në vitin 2002, 90 përqind e të rinjve deklarojnë që janë në gjendje të mirë ose shumë të mirë shëndetësore gjatë 2002-2012. Në vitin 2012, 96.5 përqind e të rinjve të grupmoshës 15-29 deklarojnë që janë në gjendje "të mirë", ose "shumë të mirë" (*Figura 8.2)*. Të rinjtë meshkuj përgjithësisht deklarojnë më shpesh që janë në gjendje të mirë ose shumë të mirë shëndetësore krahasuar me të rejat femra, por kjo diferencë gjinore është shumë e vogël: 51.5 përqind dhe 48.5 përqind përkatësisht.

Figura 8.1: Të rinjtë perceptojnë shëndetin si "të mirë" ose "shumë të mirë", 2002-2012 (në përqindje)



Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, 2002-2012

Figura 8.2: Të rinjtë sipas gjendjes shëndetësore të vetë-vlerësuar, 2012 (në përqindje)



Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, 2012

8.3 SHËNDETI RIPRODHUES

8.3.1 Përdorimi i kontraceptivëve

Me nivelin aktualisht më të ulët të lindshmërisë në vend (ISF 1.7: shihni seksionin 2.5), Shqipëria e ka realizuar tashmë tranzicionin e lindshmërisë. Një nga karakteristikat dalluese të këtij procesi në Shqipëri është ulja e lindshmërisë e cila ka ndodhur gjerësisht për shkak të përdorimit të metodave tradicionale kontraceptive e abstinencës dhe tërheqjes (Gjonca et al. 2008). Studimi shqiptar për Demografinë dhe Shëndetin 2008-08 (ADHS) konstaton që vetëm 10.6 përqind e grave të martuara kanë përdorur një metodë moderne kontraceptive, kundrejt 58.7 përqind që kanë përdorur një metodë tradicionale (*Figura 8.3a*) (INSTAT et al. 2010). Kjo shifër nënkupton një rritje të vogël të shkallës mbizotëruese të kontraceptivëve modernë me 8 përqind në vitin 2002. Mes grave të reja të martuara të grupmoshës 15-29, përqindja e atyre që përdorin kontraceptivët modernë është disi më e lartë në vitin 2008-09 me 12.9 përqind. Përdorimi aktual i kontraceptivëve modernë nga gratë jo të martuara por aktive seksualisht ka qenë mjaft më i lartë në atë kohë me 28.7 përqind.

Metoda moderne të planifikimit familjar momentalisht ofrohen nga sektorët publik dhe privat dhe nëpërmjet marketingut social. Në sektorin publik, metodat ofrohen falas që pas legjislacionit të planifikimit familjar në vitin 1992. Ofrimi i tyre organizohet në tre nivele të shërbimeve shëndetësore në të gjitha 36 rrethet: në qendra shëndetësore, në maternitet dhe qendra e konsultores në nivel rrethi, dhe në maternitete në qendrën spitalore universitare. Metodat e ofruara në sektorin publik janë pipula (mycrogynon dhe mycrolut), injeksione, DIU (diapozitiv intaruterin) dhe prezervativë (për meshkujt).

Për vitin 2014, Sistemi i informacionit dhe menaxhimit logjistik (SIML) i Institutit të Shëndetit Publik raportoi që nga të katër metodat, DIU ishte më e përdorura (34 përqind), e ndjekur nga pilulat (25 përqind) dhe injeksionet dhe prezervativët që përdoren më rrallë (secila me rreth 20 përqind). ADHS 2008-09 jep një panoramë shumë të ndryshme që mund të shpjegohet me një ndryshim në përdorimin e metodave kontraceptive në periudhën 2008-09 deri në 2014, por më shumë mund të shpjegohet me kontraceptivët që ofrohen nga sektori privat, përvec atij që ofrohet nga sektori publik. *Figura 8.3* tregon që nga të gjithë kontraceptivët modernë, prezervativi është metoda e përdorur më shumë dhe DIU ka më pak rëndësi. Dallimi ndërmjet shifrave në SIML dhe ADHS mund të tregojë që sektori privat është më i rëndësishëm për dhënien e kontraceptivëve sesa sektori publik, sidomos për prezervativët dhe pilulat.

Figura 8.3: Përdorimi aktual i kontraceptivëve nga (a) gra të martuara dhe (b) gra të pamartuara seksualisht aktive (2008-09) (në përqindje)



Burimi: Studimi Shqiptar për Demografinë dhe Shëndetin, 2008-09

ADHS 2008-09 tregon gjithashtu modele të ndryshme të përdorimit të kontraceptivëve nga gratë aktualisht të martuara (*Figura 8.3a)* dhe gratë e pamartuara seksualisht aktive (*Figura 8.3b*), edhe pse përqindja e mos-përdoruesve është relativisht e njëjtë në madhësi me rreth 30 përqind në çdo grup. Për të dy grupet, metodat tradicionale - pothuajse ekskluzivisht tërheqja- janë më të përdorurat, por më shumë nga gratë e martuara sesa nga grupi i të pamartuarave. Gratë e pamartuara seksualisht aktive praktikojnë ndjeshëm kontraceptivët më modernë se gratë e martuara (29 përqind kundrejt 11 përqind) dhe gjithashtu preferojnë prezervativët edhe më shumë (24 përqind kundrejt 4 përqind mes grave të martuara) dhe pipulat (5 përqind). Metodat afatgjata ose permanente me DIU dhe sterilizimi janë vërejtur vetëm tek gratë e martuara.

Arsyeja më e rëndësishme për mospërdorimin e kontraceptivëve nga gratë e moshës 15-29 vjeç në ADHS 2008-09 janë arsyet shëndetësore ose frika e pasojave anësore (45 përqind) dhe kundërshtimi ndaj përdorimit të kontraceptivëve (ose nga gruaja vetë ose nga partneri i saj) (33 përqind). Mungesa e aksesit në mjetet kontraceptive, kostoja dhe padija nuk shfaqen në masë të konsiderueshme.

Përdorimi i metodave moderne të kontraceptivëve nuk është rritur këto 2-3 vitet e fundit (Instituti i Shëndetit Publik 2014a). Është vënë re përdorim i qëndrueshëm, por në disa raste është treguar rënie e përdorimit të tyre. Shkalla e Mbulimit me Kontraceptivë (CPR) është jo më shumë se 4-5 përqind[40]. Aksesi i adoleshentëve në metoda moderne kontraceptive nga sektori publik paraqet vështirësi sepse nuk i frekuentojnë këto shërbime, sepse ato ofrohen në klinika dhe maternitete dhe akoma më pak në qendrat shëndetësore në zonat rurale. Në treg ka dy operatorë të tjerë si sektori Nesmark[41] dhe sektori privat. Por edhe nga këto dy sektorë raportohet përdorim i ulët i kontraceptivëve. Në disa raste (Instituti i Shëndetit Publik), të dhëna tregojnë që të rinjtë përdorin metodat kontraceptive e urgjencës në mënyrë të gabuar, por për këtë moshë nuk ka të dhëna për ITS, abortin dhe shtatzëninë e padëshiruar.

Shpjegimi për rënien e lindshmërisë, ndërsa ka rënë përdorimi i kontraceptivëve ndoshta kërkon studime specifike kërkimore për të gjetur arsyen e duhur.

8.3.2 Aborti

Që në vitin 1995, aborti i induktuar mund të bëhet ligjërisht gjatë 22 javëve të para për arsye shëndetësore dhe sociale dhe gjatë 12 javëve të para për arsye psikologjike. *Tabela 8.1* tregon abortet e regjistruara - të induktuara dhe spontane- të kryera në Shqipëri në periudhën 1994-2013. 6.4 mijë aborte të regjistruara në vitin 2013 nënkuptojnë një raport mjaft të lartë të aborteve:[42] për çdo një mijë lindje të gjalla në vitin 2013, ka pasur 180 aborte dhe një në gjashtë shtatzëni ka përfunduar me abort. Megjithatë, kjo shifër është shumë e ulët sesa ajo e 1994 kur kanë ndodhur 434 aborte për çdo njëmijë lindje. Fatkeqësisht, nuk ka shifra për abortin në moshë specifike për këtë analizë dhe, rrjedhimisht nuk mund të jepet përqindje për abortin e të rinjve.

40 Ky është një vlerësim indirekt sepse sistemi i informacionit për SIML të kontraceptivëve jep të dhëna vetëm për vitet e mbulimit me kontraceptivë të popullsisë (CYP) Sistemi i informacionit mbledh të dhëna agregate dhe për këtë arsye është e vështirë të llogaritet përdorimi i kontraceptivëve nga adoleshentët.
41 Programi Shqiptar për Tregtimin Social të Kontraceptivëve
42 Përqindja e abortit përkufizohet si numri i aborteve për një mijë lindje të gjalla.

Tabela 8.1: Lindje, aborte dhe raporti i aborteve[a], sipas vitit kalendarik (1994-2011)

Viti	Lindje	Aborte	Aborte/numri i lindjeve x 1000
1994	72,179	31,292	434
1995	72,081	32,268	448
1996	68,358	27,734	406
1997	61,739	22,133	358
1998	60,139	18,948	315
1999	57,948	16,360	282
2000	51,242	17,120	334
2001	53,205	15,700	295
2002	42,527	13,961	328
2003	45,313	12,087	267
2004	40,989	10,517	257
2005	38,898	9,403	242
2006	35,891	9,552	266
2007	34,448	9,030	262
2008	33,445	8,335	249
2009	34,114	8,139	239
2010	34,061	6,919	203
2011	34,285	7,042	205
2012	35,473	6,755	190
2013	35,750	6,442	180

[a] Numri i aborteve për një mijë lindje të gjalla

Burimi: Regjistri civil dhe ISHP

Sipas Institutit të Shëndetit Publik, një përqindje e vogël (10 përqind) e aborteve në Shqipëri janë kryer në sektorin privat (Instituti i Shëndetit Publik 2014a). Megjithatë, në mungesë të statistikave të besueshme për veprimtaritë në sektorin privat kjo deklaratë është e vështirë të verifikohet dhe numri aktual mund të jetë mjaft i lartë. Përvec kësaj, vlerësimi i të dhënave të abortit prodhon një rritje të dukshme - dhe të pamundur- në përqindjen e aborteve spontane, nga 18 përqind në 1996 në 66 përqind në vitin 2009. Instituti i Shëndetit Publik ka arsye për të dyshuar vlefshmërinë e kësaj rritjeje dhe kërkon hetim më të detajuar (Instituti i Shëndetit Publik 2014a).

Nisur nga varësia e madhe tek metodat e pabesueshme kontraceptive, ka shumë të ngjarë që në shumë raste abortet të përdoren si metoda të planifikimit familjar, si në shumë vende europiane lindore. Kjo do të tregonte një mangësi në performancën e sistemit shëndetësor për t'ju dhënë çifteve mjetet e besueshme për të planifikuar si duhet dhe për të kontrolluar shtatzënitë dhe lindjet e fëmijëve. Gjithashtu, analiza e bazuar në census nga INSTAT (2014c) jep prova bindëse për ndodhinë e aborteve përzgjedhëse të gjinisë për shkak të preferencës për meshkuj. Raporti në rritje i gjinisë në lindje (nga 160 djem për 100 vajza për lindjet e radhës së parë në 162 për lindje të katërt) është tregues i qartë i kësaj praktike. Një studim i mëparshëm nga World Vision dhe UNFPA (2012) arrin në të njëjtin përfundim. Të dyja çështjet- abortet përzgjedhëse të gjinisë dhe përdorimi i abortit si një metodë për planifikim familjar- kërkojnë vëmendje të politikave.

8.3.3 HIV/AIDS

Shqipëria konsiderohet akoma vend me prevalencë të ulët të HIV me 699 individë të diagnostikuar me HIV në vend në fund të 2013 (OBSH 2015a). Ky status lidhet me disa faktorë, përfshirë izolimin e vendit deri në 1990, prevalencën e ulët të punës seksuale dhe përdorimin e drogës përpara 1990, faktorët socialë dhe kulturorë që nuk inkurajojnë seksin paramartesor dhe në moshë të re si edhe marrëdhëniet seksuale me shumë partnerë dhe prezantimin e politikave dhe programeve HIV/AIDS (UNAIDS dhe Instituti i Shëndetit Publik, 2013). Megjithatë, duke qenë një vend me përqindje të madhe të të rinjve, normat sociale dhe kulturore që ndryshojnë shpejt dhe migracionin masiv, faktorët e rinj të riskut janë shfaqur në dy dekadat e fundit.

Numri vjetor i çështjeve të raportuara të HIV/AIDS është relativisht i ulët. Sipas Institutit të Shëndetit Publik (korrespondencë direkte), numri total i çështjeve HIV-pozitiv i raportuar në periudhën 1993-2013 është 699. Megjithatë, statistikat e ISHP tregojnë një tendencë në rritje të infeksioneve të reja (*Figura 8.4*). Viti i fundit 2013 shënon një shifër të lartë të raportuar ndonjëherë që me shfaqjen e HIV / AIDS në Shqipëri në 1993 me 124 raste të reja HIV. Numri i çështjeve të raportuara dhe llogaritjet e popullsisë bazuar në censusin e 2011 rezultojnë në një prevalencë të HIV 0.02 dhe incidencë të HIV 0.004 përqind. Këto shifra janë shumë nën shkallën e prevalencës 0.3 përqind dhe incidencës 0.02 për Europën Perëndimore dhe Qendrore dhe Amerikën Veriore (UNAIDS AIDSinfo). Megjithatë, numri aktual i çështjeve në Shqipëri besohet se është më i lartë sesa shifrat e raportuara, sidomos për rastet e pa raportuara ose të pa diagnostikuara mes meshkujve që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj, atyre që injektojnë droga dhe punëtorëve të seksit. Të dhënat sugjerojnë që shumica e atyre që jetojnë me HIV në Shqipëri nuk ka dijeni për infeksionin që kanë dhe kështu mund të transmetojnë në mënyrë aktive virusin dhe të paraqiten më vonë për trajtim dhe kujdes (OBSH 2015a).

Figura 8.4: Numri i rasteve të raportuara me HIV pozitiv, sipas gjinisë, 1993-2013



Burimi: UNAIDS dhe Instituti i Shëndetit Publik

Meshkujt e infektuar me HIV dominojnë ndaj grave, duke përbërë 70 përqind të numrit total të rasteve të raportuara me HIV. Mënyra më e zakonshme e transmetimit të HIV është kontakti heteroseksual me 83 përqind të rasteve të raportuara. Kontaktet homo-biseksuale përbëjnë 10 përqind të rasteve të reja, por kjo shifër besohet se është e nën-vlerësuar.

Figura 8.5 tregon shpërndarjen e moshës të totalit të rasteve të raportuara për periudhën 1993-2013. Në këtë periudhë, numri i rasteve të raportuara me HIV për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 154 ose në terma relative, rreth 22 përqind i numrit total të rasteve. Krahasuar me numrin e përgjithshëm, të rejat janë më të përfaqësuara në infeksionet e të rinjve, me 38 përqind kundrejt 30 përqind në përgjithësi. Transmetimi seksual është mënyra më e zakonshme e transmetimit të infeksionit HIV për të rinjtë: 95 përqind e personave të moshës 15-29 vjeç janë infektuar nëpërmjet kontaktit seksual, prej të cilëve 79 përqind kanë kontakte heteroseksuale dhe 16 përqind kontakte homo-biseksuale (*Figura 8.6*).

Figura 8.5: Rastet e raportuara me HIV sipas grupmoshës 1993-2013 (në përqindje)



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

Figura 8.6: Infektimi me HIV i personave të moshës 15-29 vjeç sipas mënyrës së transmetimit, 1993-2013 (në përqindje)



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

ADHS 2008-09 tregon që informimi për AIDS - edhe pse jo universal - është i lartë në Shqipëri me 93 përqind të grave dhe 94 përqind të burrave të cilët raportohet se kanë dëgjuar për AIDS (INSTAT et al. 2010). Për të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç shifrat janë njësoj me nivelet e përgjithshme të informimit. Megjithatë, njohuria e saktë për parandalimin e infeksionit ka qenë e ulët, rreth 70 përqind mes të pyeturve, me të rinj që kanë njohuri më të mirë. Njohuria gjithëpërfshirëse për transmetimin e HIV dhe AIDS[43] ka qenë edhe më e ulët. Vetëm 20 përqind e meshkujve dhe 28 përqind e grave kanë informacionin e duhur në këtë drejtim. Shifrat për të rinjtë meshkuj dhe femra kanë qenë disi të larta, 22 dhe 36 përqind përkatësisht. Përqindja që shpreh qëndrimin në lidhje me personat që kanë HIV/AIDS në një grup me katër pyetje[44] është e ulët si për meshkujt ashtu edhe për femrat, vetëm 6 përqind. Nisur nga informacioni në dispozicion për HIV/AIDS, OBSH rekomandon fuqishëm shtrirjen e testit HIV në vend, të kombinuar me informacionin e rëndësishëm të intensifikuar dhe fushatat e arsimit për të kuptuar më mirë epidemisë e HIV dhe AIDS në Shqipëri dhe rritjen e numrit të personave të trajtuar dhe nën kujdes. Gjithashtu konsiderohet i rëndësishëm përmirësimi i sistemeve të informacionit klinik dhe lehtësimi i disponueshmërisë së të dhënave të rëndësishme klinike.

43 Njohuri gjithëpërfshirëse domethënë të jesh në dijeni që përdorimi i vazhdueshëm i prezervativëve gjatë marrëdhënieve seksuale dhe të pasurit e një partneri që nuk është i infektuar me HIV dhe të mos pasurit e partnerëve të tjerë mund të ulë rrezikun e marrjes së virusit HIV, duke e ditur që një person në dukje i shëndetshëm mund të jetë me virusin AIDS, dhe duke refuzuar dy keqkuptimet më të zakonshme në vend për transmetimin ose parandalimin e AIDS.

44 Pyetjet e bëra ishin nëse i personi i pyetur do të kujdesej për një pjesëtar të familjes me HIV-pozitiv në shtëpinë e tij/saj, nëse do të blinte ushqime nga një shitës me AIDS, nëse do të lejonte mësuesen me HIV-pozitiv që të vazhdonte mësimdhënien, dhe nëse do të dëshironte të mbante sekret statusin HIV-pozitiv për një pjesëtar të familjes.

8.4 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE

8.4.1 Duhani dhe përdorimi i alkoolit

Duhan pirja është shkaku i vetëm më shumë i parandalueshëm i vdekshmërisë para kohe, që rrit rrezikun e numrit të sëmundjeve. Organizata Botërore e Shëndetit ka identifikuar duhan pirjen si shkak serioz të sëmundjeve dhe vdekjes para kohe. Ndikimi i kombinuar i nikotinës (droga kryesore që gjendet në duhan) dhe gazeve të tjera që hyjnë në mushkëri gjatë duhan pirjes rrit ndjeshëm rrezikun e sëmundjeve dhe shëndetit të keq. Gjithashtu pranohet që duhan pirja pasive ose dytësore mund të rrezikojë shëndetin e të tjerëve. Kjo është një nga arsyet pse duhan pirja është ndaluar me ligj në ambiente publike.

Duhan pirja shpesh fillon gjatë adoleshencës, por pasojat e shumta në shëndet nga duhani, përfshirë kancerin dhe sëmundjet koronare të zemrës, zakonisht shfaqen më vonë në moshë madhore ose edhe më vonë në pleqëri. Si rezultat, vese të pashëndetshme dhe rreziqe të vazhdueshme në sjellje (si duhani dhe alkooli), tek të rinjtë mund të ndikojnë të ardhmen e tyre. Duhan pirësve të rinj të përditshëm mund t'ju bëhet zakon dhe të bëhen të varur përpara se të arrijnë moshën madhore, duke i bërë më pak të aftë për të mposhtur këtë varësi dhe më shumë të prirur për të vuajtur nga komplikime shëndetësore që lidhen me duhan pirjen.

Në vitin 2010, duhan pirja përbën 22 përqind të të gjitha vdekjeve në Shqipëri. Në dy dekadat e fundit, gjatë tranzicionit të shpejtë politik dhe socio-ekonomik, shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet duhan pirjes pothuajse është dyfishuar për sëmundje të pa transmetueshme (Instituti i Shëndetit Publik 2014).

OBSH vlerëson që në vitin 2010 në Shqipëri, 24 përqind e personave të moshës 15 vjeç dhe lart kanë pirë duhan, 53 përqind e meshkujve të kësaj grupmoshe dhe 9 përqind të grave (OBSH 2015b), Llogaritjet korresponduese për të rinjtë e grupmoshës 14-25 vjeç janë disi më të ulëta: 38 përqind mes të rinjve meshkuj dhe 7 përqind mes të rejave femra. Gjithashtu duhan pirja e përditshme është disi më e ulët sesa përdorimi aktual, por mjaft më e lartë sesa shifrat e AMNJ. 41 për meshkuj të moshës 15 vjeç e lart dhe 7 përqind për gratë e moshës 15 vjeç e lart.

ADHS 2008-09 jep informacion të detajuar për duhan pirjen. Duhan pirja në moshën e adoleshencës dhe të rinjve të rritur po rritet ndjeshëm në mbi 50 përqind tek meshkujt, ndërsa prevalenca mes grave mbetet më e ulët (*Figura 8.7*). Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç, duhan pirja në përgjithësi praktikohet nga 30 përqind e meshkujve dhe 5 përqind e femrave.

Boshllëku gjinor në sjelljen e duhan pirjes nuk pasqyrohet vetëm në diferencën e madhe në përqindjen e duhan pirësve, por edhe në modele të tjera. Kështu, jo vetëm që më shumë meshkuj shqiptarë pinë duhan, por janë gjithashtu duhanpirës më të mëdhenj. Rreth 93 përqind e meshkujve duhanpirës pinë 10 ose më shumë cigare në 24 ditët e fundit, krahasuar me 61 femra duhanpirëse. Gjithashtu meshkujt fillojnë të pinë duhan më herët sesa femrat - me moshë medianë që fillon në 19.2 dhe 21.2 vjet përkatësisht - duke i ekspozuar për një periudhë më të gjatë ndaj rreziqeve shëndetësore. Një gjetje interesante e ADHS është që duhan pirja mes meshkujve lidhet negativisht me gjendjen pasurore, por që kjo lidhje është e përmbysur për femrat. Vetëm 1 përqind e grave në kuintilin më të ulët të të ardhurave pinë duhan, por kjo përqindje është rritur vazhdimisht në 12 përqind në kuintilin më të lartë.

Figura 8.7: Përqindja e popullsisë në grupmoshën 15 dhe 49 vjeç që pi duhan sipas gjinisë dhe moshës



Burimi: Studimi Shqiptar për Demografinë dhe Shëndetin, 2008-09

Ashtu si duhan pirja, përdorimi i alkoolit mund të fillojë në moshë të re dhe mund të bëhet lehtësisht abuzim substance, varësi dhe më tej sëmundje kronike, ndërsa kur kjo sjellje lidhet me drejtimin e makinës dhe veprimtari specifike në punë, shton në mënyrë dramatike rrezikun për aksidente dhe vdekje para kohe. Shkalla totale e vdekshmërisë dhe barra totale e sëmundjes për shkak të përdorimit të alkoolit është rritur 2.5 herë në Shqipëri gjatë dy dekadave të fundit. Në veçanti, shkalla e vdekshmërisë nga sëmundje kardiovaskulare dhe ciroza e mëlçisë për shkak të konsumimit të alkoolit është dyfishuar (Instituti i Shëndetit Publik 2014).

Të dhënat e mbledhura në Anketën AMNJ tregojnë që në muajin përpara intervistimit për anketë shumica e të rinjve kanë konsumuar alkool gjatë më pak se dhjetë ditëve (47 përqind) ose aspak (40 përqind) (*Figura 8.8*). Vetëm 2 përqind kanë konsumuar alkool çdo ditë dhe 10 përqind kanë konsumuar alkool 10 ditë dhe më shumë gjatë muajit të fundit. Ashtu si në rastin e duhan pirjes, të rinjtë ka më shumë të ngjarë të konsumojnë alkool. Rreth 3 përqind e të rinjve meshkuj raportojnë që pinë alkool çdo ditë, ndërsa përqindja e grave është e papërfillshme. Nga ana tjetër, rreth një e treta e meshkujve nuk ka pirë alkool muajin e fundit, krahasuar me rreth dy të tretat e grave.

Figura 8.8: Të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç sipas gjinisë dhe shpeshtisë së konsumimit të alkoolit në muajin përpara intervistës së anketës (në përqindje)



Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, 2012

8.4.2 Aftësia e kufizuar

Aftësia e kufizuar ka qenë gjithnjë pjesë e gjendjes njerëzore. Disa individë lindin me aftësi të kufizuar, ndërsa të tjerë bëhen me aftësi të kufizuara gjatë jetës për shkak të një sërë faktorësh, përfshirë sëmundjet infektive, sëmundjeve të trashëguara ose aksidenteve, si pasojë e keq-ushqyerjes, mungesës së kujdesit të duhur parandalues shëndetësor, ekspozimit ndaj ndotësve mjedisorë ose si pasojë e veprimeve të dhunshme. Adoleshentët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara janë mes personave më me nevojë në të gjithë popullsinë e botës. Të rinjtë me aftësi të kufizuara përballen vazhdimisht me izolim social, varfëri dhe diskriminim. Shpesh ata fshihen nga syri i publikut dhe aftësitë e tyre të kufizuara trajtohet si tragjedi personale. Gjithashtu, mbështetja e pamjaftueshme për familjet dhe prindërit e të rinjve me aftësi të kufizuara e shtrin më tej këtë përjashtim. Familjet shpesh nuk kanë informacion për ndihma specifike dhe kështu e mbyllin individin në një sërë pritshmërish të paracaktuara për atë që individi mund të bëjë dhe nuk mund të bëjë. Niveli i përjashtimit social dhe ekonomik është më i madh për të rinjtë me aftësi të kufizuara sesa për moshatarët e tyre. Në Shqipëri vetëm një numër i vogël i personave me aftësi të kufizuara jeton në pavarësi, edhe pse shpesh në ambiente të veçuara dhe në varfëri të thellë. Ashtu si të gjithë të rinjtë, ata me aftësi të kufizuara duhet te jetojnë në një mjedis të sigurt dhe mbështetës; ata kanë nevojë për arsim, shërbime shëndetësore dhe akses në aktivitete sportive dhe argëtim. Ata gjithashtu duhet të zhvillojnë aftësi të cilat do të bëjnë të mundur që të gjejnë punë dhe që kjo do t'ju shërbejë pozitivisht në vendin e punës. Është e rëndësishme të theksohen ngjashmëritë ndërmjet të rinjve me aftësi të kufizuara dhe moshatarëve të tyre për shkak se në shumë shtete nevojat e të rinjve me aftësi të kufizuara janë konsideruar të njëjta, për të mos thënë identike, me ato të të rriturve me aftësi të kufizuara.

Ky seksion jep një vështrim të përgjithshëm të të rinjve me aftësi të kufizuara, duke përdorur të dhënat të censusit 2011. Censusi përdor një grup me gjashtë pyetje të përkufizuara nga rekomandimet e Grupit të Uashingtonit për aftësitë e kufizuara: aftësia për të parë, për të dëgjuar, për të lëvizur, për t'u kujdesur për veten, për të kuptuar dhe për të komunikuar. Një individ konsiderohet me aftësi të kufizuara nëse ai ose ajo raporton një vështirësi të madhe ose aftësi të kufizuar për të kryer të paktën një nga veprimtaritë e mësipërme.

Mbizotërimi i aftësive të kufizuara lidhet shumë me moshën, grupet e moshës më të madhe që ndikohen më shumë nga vështirësitë në kryerjen e detyrave të përditshme për shkak të pasojës kumulative të sëmundjeve, dëmtimeve dhe degjenerimit. Pothuajse mbi 1 përqind e të rinjve vuan nga paaftësi fizike (me diferencë të vogël ndërmjet tre grupmoshave pesë-vjeçare brenda të rinjve), krahasuar me 25 përqind të të moshuarve 65 vjeç dhe lart, duke u rritur në 57 përqind për ata të moshës 95 vjeç e lart (*Figura 8.9*).

Figura 8.9: Përqindja e popullsisë me aftësi të kufizuara të moshës 15 vjeç e lart, sipas gjinisë dhe grupmoshës



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Megjithatë, për shkak të shifrave relativisht të mëdha të të rinjve, përqindja e të rinjve me aftësi të kufizuara në popullsinë e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara është 8 përqind (*Figura 8.10*), që përfaqëson rreth 11 mijë persona të rinj me aftësi të kufizuar. Në census raportohet se më shumë meshkuj sesa femra janë raportuar me aftësi të kufizuara. 6.3 mijë meshkuj (57 përqind të të rinjve me aftësi të kufizuara) kundrejt 4.6 mijë gra.

Figura 8.10: Popullsia me aftësi të kufizuara në moshën 15 vjeç e lart sipas grupmoshës (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Aftësitë e kufizuara më të zakonshme që hasen mes të rinjve janë problemet e komunikimit, kujdesit për veten dhe të të kuptuarit, ku secili llogaritet në rreth një të pestën e të gjitha aftësitë të kufizuara që janë raportuar *(Figura 8.11*). Krahasuar me grupmoshat më të mëdha, të rinjtë vuajnë relativisht më shpesh nga aftësi të kufizuara mendore (kuptim dhe komunikim) sesa nga lloje të aftësive të kufizuara fizike (shikimi, dëgjimi dhe lëvizja).

Figura 8.11: Të rinjtë me aftësi të kufizuara të moshës 15 deri në 29 vjeç, sipas llojit të aftësisë së kufizuar (në përqindje)



Burimi: Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011

8.5 VDEKSHMËRIA

8.5.1 Jetëgjatësia

Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë progres domethënës për të përmirësuar situatën e shëndetit të popullsisë së saj. Jetëgjatësia është rritur në mënyrë të qëndrueshme për të dy sekset gjatë dekadës së fundit. Ndryshimet e larmishme, mes të cilave ndryshimet demografike, kanë çuar në një tranzicion të qartë epidemiologjik në Shqipëri. Megjithatë, barra e sëmundjeve kronike si kanceri, sëmundjet kardiovaskulare, diabeti dhe SPOK janë pikë qendrore e problemit në Shqipëri me mundësinë për t'u rritur më tej në dekadat e ardhshme, nëse nuk do të merren masa serioze. Përveç organizimit të një sistemi për kujdes shëndetësor efektiv, të aksesueshëm dhe të përballueshëm, ekzistojnë mundësi për të parandaluar të rinjtë që të mos pinë duhan, që të mos abuzojnë me alkoolin, që të merren me ushtrime fizike dhe të përdorin dieta të shëndetshme me qëllim që të mos kontribuojnë në barrën e ardhshme të sëmundjeve kronike në Shqipëri. Ndërhyrjet për të përmbysur trendin e NCD duhet të fillojnë në fëmijëri me praktika të përmirësuara të ushqyerjes së foshnjës dhe fëmijës dhe, edhe më herët, me ofrimin e kujdesit për të gjitha gratë shtatzëna në fazën e hershme të shtatzënisë (Instituti i Shëndetit Publik 2014b).

Analiza e censusit vlerëson jetëgjatësinë në lindje në 79.4 për vajzat dhe 74.8 për djemtë (INSTAT 2014c), që janë shumë afër përllogaritjeve zyrtare të OKB-së. Këto shifra janë shumë më të lartë sesa do të pritej në bazë të niveleve mbizotëruese të vdekshmërisë të foshnjave dhe fëmijëve dhe treguesve të tjerë të zhvillimit. *Figura 8.12* tregon jetëgjatësinë në lindje si edhe numrin shtesë të viteve që pritet të jetojnë të rinjtë shqiptarë kur bëhen 15, 20 dhe 25 vjeç. Shifrat tregojnë që për shembull, një mashkull që po bëhet 25 vjeç mund të pritet që të jetojë edhe 52 vjet të tjera dhe të bëhet 77 vjeç, moshë e cila ka qenë jetëgjatësia e grave në lindje.

Figura 8.12: Jetëgjatësia në mosha të ndryshme sipas gjinisë (në vite)



8.5.2 Shkaqet e vdekjes

Nga viti 2001 deri në 2011, statistikat jetësore tregojnë numrin e vdekjeve të të rinjve që luhatet në rreth 800 në vit. Që atëherë, numri duket se ka rënë. Shumica mbi 50 vjeç vdesin për shkak të sëmundjeve të qarkullimit të gjakut dhe kancerit ndërsa të rinjtë përgjithësisht bëhen viktima ndaj faktorë të jashtëm nëse vdesin. Në vitin 2010, shkaqet e jashtme llogaritin 55.8 përqind të vdekjeve të të rinjve të moshës 15 deri në 29 vjeç (*Figura 8.13*). Dëmtimet e jashtme, helmimi dhe aksidentet janë shkaku kryesor i vdekjes të të rinjve.

Një grup faktorësh të parandalueshëm të riskut si duhan pirja, abuzimi me alkool, dieta e pashëndetshme dhe mungesa e veprimtarisë fizike kanë ndikim të madh në rritjen e vërejtur në barrën totale të sëmundjeve jo të transmetueshme si kanceri, sëmundje të zemrës, mëlçisë dhe mushkërive. Parandalimi i të rinjve shqiptarë nga duhan pirja dhe abuzimi me alkool dhe dieta e pashëndetshme dhe promovimi i aktivitetit të tyre fizik janë sfidat kryesore (Instituti i Shëndetit Publik 2014b).

Figura 8.13: Të rinjtë që kanë vdekur në moshën 15-29 vjeç sipas shkakut të vdekjes, 2010 (në përqindje)



Burimi: Statistikat vitale, 2010

9 PËRMBLEDHJE

9.1 HYRJE

Ky raport për kushtet e jetesës së të rinjve të moshës 15 deri në 29 vjeç në Shqipëri bazohet në burime të ndryshme informacioni. Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 përbën shtyllën e analizës. Të dhënat administrative dhe anketime të ndryshme plotësues dhe që japin më shumë detaje për informacionin e censusit. Megjithatë, për tema të ndryshme, informacioni i saktë i përditësuar është i pakët. Kjo ndihet veçanërisht në fushën e shëndetësisë dhe sidomos shëndetit riprodhues, i cili është me rëndësi të veçantë për të rinjtë.

Panorama e përgjithshme që shfaqet nga të dhënat në dispozicion është që të rinjtë shqiptarë përjetojnë- dhe dukshëm shkaktojnë- ndryshim social. Kjo lidhet në mënyrë të rëndësishme me lindshmërinë dhe migracionin, punësimin dhe jetesën. Në disa fusha mund të vërehet përmirësim i konsiderueshëm, edhe pse përgjithësisht kushtet e jetesës të të rinjve në Shqipëri mbeten pas shumicës së bashkëmoshatarëve të tyre në Europë. Sidomos shqetësuese është pozita e të rinjve në tregun e punës, i cili është gjithashtu faktori bazë për emigracionin me shkallë të gjerë dhe uljen e popullsisë në Shqipëri. Përmirësim i ndjeshëm gjithashtu garantohet në fushën e shëndetit riprodhues sidomos sa i përket uljes së rasteve të abortit të induktuar (përfshirë abortin specifik gjinor) dhe përdorimit të kontraceptivëve modernë dhe të besueshëm.

9.2 RINIA ËSHTË FAKTOR KYÇ NË NDRYSHIMIN DEMOGRAFIK...

Panorama e popullsisë shqiptare ka ndryshuar në mënyrë drastike në dy ose tre dekadat e fundit. Lëvizja e lirë e popullsisë, hapja e ekonomisë, rënia e lindshmërisë nën nivelin e zëvendësimit, plakja e popullsisë dhe emigracioni masiv dhe flukset vijuese të migracionit të kthimit ndryshojnë në mënyrë rrënjësore strukturën e popullsisë dhe shoqërisë në përgjithësi. Në këtë transformim dhe popullsi në rënie në përgjithësi, popullsia e të rinjve të moshës 15 deri në 29 vjeç ka mbetur e qëndrueshme me një rënie modeste nga 750 mijë persona në vitin 1979 (29 përqind e gjithë popullsisë) në 704 mijë në vitin 2011 (25 përqind). Në këtë kuptim numerik, të rinjtë zënë një pozicion të rëndësishëm nisur nga zhvendosja e madhe në këtë periudhë nga popullsia e më të rinjve tek ajo e më të vjetërve. Në vitin 1979, në Shqipëri jetonin 958 mijë fëmijë nën moshën 15 vjeç (37 përqind e gjithë popullsisë) dhe në vitin 2011 jetojnë vetëm 579 mijë fëmijë (21 përqind). Nga ana tjetër, numri i të moshuarve 65 vjeç e lart është më shumë se dyfishuar në të njëjtën periudhë, nga 136 mijë (vetëm 5 përqind) në 318 mijë (11 përqind). Sa i përket mundësive në të ardhmen, tendenca aktuale e plakjes do të vazhdojë. Deri në vitin 2030, raporti i të moshuarve do të jetë dyfishuar përsëri (në 21 përqind) dhe ai i fëmijëve nën 15 vjeç do të jetë vetëm 16 përqind. Në atë kohë, numri i të moshuarve (581 mijë) do të ketë tejkaluar numrin e fëmijëve (446 mijë).

Ky ndryshim i popullsisë ka ndikime kryesore në nivelin individual dhe të njësive ekonomike familjare, si edhe në nivelin shoqëror. Ndërsa në vitin 1979, ka pasur 73 persona në moshë më pak produktive të të rinjve dhe të të moshuarve në 100 banorë në moshë më shumë produktive, në vitin 2011 kjo shifër ka qenë vetëm 47. Me këtë raport të ulët varësie me 47 përqind, Shqipëria ndodhet në mes të dritares së mundësisë ekonomike. Nëse vendi përfiton apo jo nga ky episod i "dividentit demografik" - me një popullsi të madhe që mund të jetë në moshë produktive relative me numrin e vogël të të rinjve dhe të të moshuarve- varet nga masa e zbatimit të politikave të efektshme për të përgatitur si duhet forcën e punës për tregun e punës dhe nëse politika të duhura sociale dhe ekonomike zbatohen për t'ju ofruar njerëzve punë produktive. Kjo vlen veçanërisht për të rinjtë që kanë nevojë për arsim dhe përvojë dhe vende pune të përshtatshme kur hyjnë në tregun e punës.

Të rinjtë luajnë rol kyç në proceset në themel të ndryshimit të popullsisë. Dukshëm, ata përfitojnë nga përmirësimi i kushteve të jetesës dhe shërbimet shëndetësore, siç pasqyrohet në rritjen e jetëgjatësisë. Grupmosha 15-29 vjeç e më të rinjve mund të pritet që të jetojë mesatarisht 61.3 vjet të tjera në vitin 2005. Në vitin 2014 kjo është rritur në 64.2 vjet, duke shtuar 2.9 vjet në jetëgjatësinë e tyre. Por roli i të rinjve si agjentë kyç në ndryshimin e popullsisë

lidhet veçanërisht me rënien e lindshmërisë dhe migracionin. Pothuajse 74 përqind e të gjitha lindjeve ndodhin tek gratë e grupmoshës 15-29 vjeç. Për femrat e grupmoshës 20-29 vjeç, numri mesatar i fëmijëve të lindur prej tyre është vetëm 0.6 herë numri i fëmijëve të lindur nga femra të të njëjtës moshë në vitin 1989, që është faktori kryesor i rënies së Indeksit Sintetik të Fekonditetit në 1.7 fëmijë për femër në 2011, shumë më pak se niveli i zëvendësimit 2.1. Njëkohësisht, të dhënat e lindjeve tregojnë një rritje të vazhdueshme në lindshmërinë e të rinjve. Lindshmëria në moshë specifike nën 20 vjeç është rritur nga 0.016 në vitin 1989 në 0.018 në vitin 2001 dhe 0.020 në vitin 2011. Edhe pse numrat absolute të lindjeve nga adoleshentët janë relativisht të vogla - 2.8 mijë në vitin 2011- dhe po bien për shkak të shifrave në rënie të grave të grupmoshës 15-19 vjeç, tendenca në rritje e lindshmërisë të adoleshentëve është diçka që kërkon vëmendje nga politik-bërësit e fushës së shëndetësisë.

9.3 … DHE NË MIGRACION

Ashtu si për lindshmërinë, të rinjtë janë nxitësit kryesorë të migracionit, të brendshëm dhe ndërkombëtar. Heqja e barrierave ndaj emigracionit, trazirat sociale në vitet 1990, papunësia e lartë në vend dhe mundësi më të mira për punë dhe studime jashtë vendit gjenerojnë një fluks të vazhdueshëm emigracioni më së shumti drejt Greqisë dhe Italisë. Censusi 2011 tregoi që emigracioni ka qenë faktori më i rëndësishëm për humbjen neto të popullsisë me 269 mijë persona ndërmjet 2001 dhe 2011, të shprehur në përqindje si 8.8 përqind e popullsisë në vitin 2001. Gjatë kësaj periudhe vlerësohet që 482 mijë shqiptarë kanë ikur nga vendi. Ashtu siç ndodh zakonisht në migracion, grupmosha që u përfshi më shumë në përvojën e migracionit është ajo e të rinjve të rritur. Numri total i të rinjve që kanë emigruar në periudhën ndërmjet censuseve 2001-2011 vlerësohet 225 mijë persona dhe grupmosha 20-24 vjeç dhe 25-29 vjeç ka më shumë emigrantë sesa çdo grupmoshë tjetër pesë vjeçare. Duhet të thuhet që në periudhën e fundit ndërmjet censuseve, flukset e emigracionit kanë qenë të ekuilibruara dhe në vitet e fundit tregohet edhe në mbi-përfaqësim domethënës i grave, ndërsa në vitet 1990 meshkujt kanë emigruar më shumë se gratë. Ky zhvillim tregon që migracioni ka hyrë në një fazë më të pjekur: pas emigracionit të parë të dominuar nga meshkujt për punësim vijon diversifikimi që përfshin më shumë gra dhe fëmijë si edhe një larmi më e madhe e arsyeve të migracionit, si bashkimi familjar, migracioni për martesë dhe studime. Megjithatë, arsyet ekonomike për emigracionin mbizotërojnë akoma mes grave dhe burrave. Në censusin e vitit 2011, këto janë përcaktuar si arsyet kryesore për 74 përqind të të rinjve që kanë ikur nga shtëpia për të shkuar jashtë shtetit.

Në rastin e emigracionit me bazë të gjerë, gjenerohet edhe migracion kthimi i konsiderueshëm. Edhe ata që kthehen në Shqipëri përqendrohen shumë në moshat e të rinjve të rritur. Numri i meshkujve që kthehen, krahasuar me gratë që kthehen në Shqipëri është dyfishi, një pasqyrim i dominimit të meshkujve në emigracion gjatë dekadave të fundit. Profilet e të rinjve të kthyer japin dallime interesante ndërmjet migrantëve meshkuj dhe femra: meshkujt e rinj janë larguar nga vendi më së shumti si të papunë (68 përqind) ose studentë (24 përqind). Jashtë vendit, përpara kthimit në Shqipëri ata kanë qenë në punë (48 përqind) ose të papunë (46 përqind). Pas kthimit në Shqipëri, 66 përqind e tyre kanë qenë përsëri të papunë, 30 përqind kanë gjetur një punë - ose në punë ose të vetë-punësuar- dhe shumë pak kanë filluar shkollimin (3 përqind). Edhe pse për gratë pikënisja e emigracionit ka qenë më së shumti nga gra të papuna (46 përqind) dhe studentë (26 përqind), një përqindje e ndjeshme janë larguar edhe si shtëpiake (20 përqind). Statusi i veprimtarisë së tyre jashtë vendit ka qenë më shumë i larmishëm me 31 përqind të punësuara, 28 përqind të papuna, 21 përqind shtëpiake dhe një përqindje e rëndësishme (18 përqind) studente. Gjithashtu pas kthimit në Shqipëri, më shumë gra sesa burra kanë hyrë në sistemin arsimor (10 përqind), ndërsa 30 përqind janë bërë shtëpiake, 23 përqind kanë gjetur punë dhe 36 përqind kanë mbetur pa punë.

Shifrat e larta të papunësisë tregojnë që emigracioni është sfondi kryesor i emigracionit, që emigracioni nuk është garanci për punësim jashtë vendit dhe që pas kthimit shumë migrantë të rinj mbeten përsëri të papunë. Rrjedhimisht, nga këndvështrimi i punësimit, migrantët e rinj të kthyer duket se janë në një pozitë veçanërisht të pambrojtur. Si të tillë ata përfaqësojnë një grup të synuar për mbështetje më të madhe sistematike që t'i drejtojë në mundësitë për punë.

9.4 TË RINJTË NË TREGUN E PUNËS: SFIDA E POLITIKË BËRËSVE

Për shumë të rinj, emigracioni shërben si një valvë sigurie për presionin e papunësisë në nivele të larta në Shqipëri. Rinia shënon një fazë në jetë ku ndodh tranzicioni nga arsimi në punësim. Kjo tashmë paraqet sfidë në kushtet e favorshme të tregut të punës, por edhe më shumë në tregun e punës të Shqipërisë në vitet 1990 dhe më tej. Gjithashtu, punësimi edhe në Shqipëri edhe jashtë vendit është ndikuar negativisht nga kriza ekonomike që në 2008 e cila godit

fort punësimin e të rinjve.

Pjesëmarrja në tregun e punës në vitin 2011 ishte shumë e ulët mes popullsisë së të rinjve të moshës 15-19 vjeç. Norma e pjesëmarrjes në tregun e punës arrin nivel të konsiderueshëm në 60 përqind të popullsisë në moshë pune në grupmoshën e të rinjve më të rritur 25-29 vjeç me një dallim të matshëm ndërmjet normës për meshkuj dhe për femra (70 dhe 48 përqind, përkatësisht). Përgjithësisht, 46 përqind e të rinjve meshkuj janë aktivë në tregun e punës dhe 29 përqind e të rejave femra. Një vështrim jo inkurajues për mundësitë për punë mund të jetë faktor për pjesëmarrjen e ulët në tregun e punës nga të rinjtë, por normat e ulëta të pjesëmarrjes nuk janë a priori tregues negativ i performancës së dobët të tregut të punës. Një arsye pozitive për personat ekonomikisht inaktivë mund të jetë ndjekja e arsimit dhe trajnimit me kohë të zgjatur. Kjo ka qenë arsyeja kryesore për pothuajse dy të tretat (66 përqind) e të rinjve ekonomikisht inaktivë në vitin 2011. Për meshkujt kjo arsye ka qenë më e rëndësishme sesa për femrat (duke qenë arsyeja kryesore për 74 dhe 60 përqind përkatësisht), sepse vetëm për femrat edhe përgjegjësitë shtëpiake kanë qenë një arsye madhore dhe konkurruese (për 18 përqind) që të mos kërkojnë punë. Ky është tregues i roleve tradicionale gjinore që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare.

Në vitin 2011 norma e papunësisë për të rinjtë vlerësohet 22 përqind, duke sugjeruar që rreth 86 mijë persona të moshës 15-29 vjeç- 52 mijë të rinj meshkuj dhe 34 mijë të reja femra- nuk mund të gjenin punë. Kjo normë papunësie është dy herë më e lartë sesa për të rriturit që tregon pozicionin e pambrojtur të të rinjve në tregun e punës. Përveç papunësisë, një shtesë prej 14 përqind e forcës së punës së të rinjve është e nën-punësuar, punon në punë që nuk janë mjaft produktive dhe shpërblyese. Së bashku me të papunët, kjo rezulton në 36 përqind të forcës së punës së të rinjve - 142 mijë persona- të cilët nuk janë në punësim fitimprurës. Gjithashtu, analiza e tranzicionit të tregut të punës tregon që në vitin 2011, 58 përqind e të gjithë të rinjve ka përjetuar tranzicionin nga inaktiviteti në tregun e punës, por vetëm 9 përqind kanë bërë edhe tranzicionin për në punë të denjë.

Një përqindje e madhe (63 përqind) e të rinjve të papunë është gjithashtu e papunë prej një kohe të gjatë, kjo shifër është më e lartë se në çdo vend të BE-së dhe kërkon vëmendje të veçantë nga politik-bërësit. Kërkime empirike tregojnë që kohëzgjatja e papunësisë ndikon negativisht në mundësinë e gjetjes së një pune (të re), sepse nënkupton humbjen e aftësive të fituara dhe personi bëhet më pak tërheqës për punëdhënësit e mundshëm. Veçanërisht e rëndësishme për të rinjtë e papunë është fakti që papunësia e zgjatur në fillim të karrierës së dikujt mund të reduktojë përgjithmonë fitimet e ardhshme, të ulë mundësitë për punë dhe të vonojë fitimin e aftësive të çmuara në punë.

Marrëdhënia ndërmjet aftësisë për punë dhe nivelit të arritur arsimor është mjaft komplekse. Arsimi ka patur pak ndikim tek papunësia për të rinjtë meshkuj, por arsimi i lartë duket se ka ndikim negativ për të rejat femra. Me sa duket, arsimi i avancuar nuk është garanci për të gjetur punë, ose për të rritur pritshmëritë e punësimit përtej niveleve realiste. Kjo ngre pyetjen se deri në çfarë mase arsimi i lartë orientohet në mënyrë të efektshme drejt nevojave të tregut të punës. Kjo çështje theksohet më tej nga niveli i lartë i mospërputhjes së aftësive, që ndodh kur një person ka kualifikime arsimore më të larta ose më të ulëta sesa niveli që i caktohet punës së personit. Norma e mospërputhjes për punëtorët e rinj të arsimit të lartë ka rezultuar tepër e lartë në 34 përqind në vitin 2011. Meqë ky është grupi me arsimin më të lartë, mospërputhja nënkupton që personat janë të mbi-kualifikuar për punën e tyre. Këto norma të larta mospërputhjeje janë tregues ose i tregjeve të punës me papunësi të lartë ose përputhje e keqe ndërmjet atyre që dalin nga sistemi arsimor dhe kërkesës së tregut të punës ose kombinim i të dyjave. Kërkime të mëtejshme duhet të bëhen për të parë mundësitë që sistemi arsimor të përshtatet më mirë me kërkesat e tregut të punës.

Tjetër tregues i lidhur me arsimin për të matur potencialin e pashfrytëzuar të të rinjve është përqindja që nuk është në punësim, arsim ose trajnim (NEET). Këta të rinj janë veçanërisht në rrezik për tregun e punës dhe përjashtimin social sepse as nuk përmirësojnë aftësinë e tyre të punësimit në të ardhmen nëpërmjet investimit në aftësi, as nuk fitojnë përvojë përmes punësimit. Norma NEET e Shqipërisë në vitin 2011 tregon që 30 përqind e personave të moshës 15-29 vjeç nuk janë përfshirë në punësim, arsim ose trajnim dhe kjo është shumë e lartë krahasuar me vendet e BE-së.

Përqindja e të rinjve që kanë pasur punë në vitin 2001 vlerësohet në 43 përqind kundër 59 përqind për gjithë popullsinë në moshë pune. Shifra 43 përqind përfaqëson 307 mijë persona të rinj në punësim, që ka qenë 27 përqind e të gjithë të punësuarve në Shqipëri. Përqindja e madhe e të rinjve në punë janë në punësim të pambrojtur, sepse punojnë si punëtorë të papaguar të familjes ose si punëtorë për llogari të tyre. Këtyre punëve u mungon marrëveshja formale për punë dhe sigurimet e duhura shoqërore që janë kushte për punë të denjë. Në këtë drejtim, të rinjtë nuk dallohen shumë nga popullsia e rritur në punë.

Seria e Anketave të Forcës së Punës tregon një ulje të mëtejshme ndërmjet 2011 dhe 2014 në shumë tregues të tregut të punës për të rinjtë, përfshirë normën e pjesëmarrjes në tregun e punës (nga 43 në 28 përqind), normën e papunësisë (nga 22 në 33 përqind) dhe përqindjen e atyre jo në punësim, arsim ose trajnim (nga 30 në 35 përqind).

9.5 ARSIMI: PËRGATITJA PËR JETËN

Alfabetizmi, deri në moshën e vjetër, është pothuajse universal në popullsinë e Shqipërisë dhe arrin 99 përqind për popullsinë e të rinjve të moshës 15 deri në 29 vjeç. Nuk ka dallim në nivelin e arsimit të arritur që është përmirësuar ndjeshëm në dekadat e fundit. Në vitin 2011, përqindja me arsim të përfunduar të nivelit të lartë mes grupmoshës 25-29 vjeç që më së shumti kanë përfunduar arsimin e tyre- qëndron në 24 përqind, krahasuar me vetëm 8 përqind në vitin 2001. Pavarësisht këtyre përmirësimeve, Shqipëria mbetet pas në arritjet arsimore krahasuar me vendet e BE-së. Kështu, 82 përqind e popullsisë së BE të moshës 20-24 vjeç ka përfunduar të paktën nivelin dytësor të arsimit, por vetëm 59 përqind e shqiptarëve të kësaj moshe e ka përfunduar këtë nivel. Ashtu si në shumë vende të tjera Europiane, gratë kanë prirje që të vazhdojnë për të përfunduar arsimin e avancuar. Në vitin 2011, 17 përqind e grave ka përfunduar arsimin e avancuar krahasuar me 11 përqind të burrave.

Të dhënat e censusit 2011 tregojnë që pjesëmarrja në shkollë në arsim të detyruar- shkollë fillore dhe e mesme e ulët deri në klasë të nëntë- është pothuajse universale në Shqipëri. Megjithatë, pas kësaj, zakonisht duke filluar me moshën 15 vjeçare, norma e frekuentimit ka rënë ndjeshëm. Ndërsa shumica e 68 përqind të 15-19 vjeçarëve merr akoma pjesë në arsim, kjo përqindje është vetëm 26 përqind për grupmoshën 20-24 të të rinjve dhe 6 përqind për grupmoshën 25-29 vjeç të të rinjve të rritur. Me këto shifra, Shqipëria qëndron mjaft ulët nga normat përkatëse të BE-së. Megjithatë, të dhëna nga Ministria e Arsimit tregojnë që regjistrimi në arsim e lartë po rritet shpejt. Ndërsa norma bruto e regjistrimit në vitin shkollor 2009-10 ka qenë rreth 39 përqind, në vitin 2013-14 është rritur në rreth 70 përqind.

Norma e braktisjes së arsimit të lartë ndodh në tranzicion nga shkolla e mesme e ulët në të lartë (rreth 8 përqind) dhe sidomos ndërmjet arsimit të lartë dhe dytësor të lartë (rreth 17 përqind) Megjithatë, gjatë arsimit dytësor të lartë, janë vërejtur në census nivele të vazhdueshme të braktisjeve.

Arsimi i lartë paraqet dallimet e shënuara gjinore në regjistrim dhe frekuentim. Ndërsa në censusin e vitit 2011 numri i vajzave në arsimin dytësor të lartë ka qenë më i ulët se numri i djemtë (me indeksin e barazisë gjinore 0.93) në arsimin e lartë femrat janë më shumë të përfaqësuara, siç tregohet nga indeksi i barazisë gjinore 1.28. Shifrat e regjistrimit tregojnë dallim të njëjtë dhe madje në rritje për arsimin e lartë: regjistrimi bruto në vitin shkollor 2009-10 ishte 44 dhe 34 përqind për djem dhe vajza, përkatësisht, duke u rritur në 58 dhe 83 përqind në vitin 2013-14.

Fluksi në rritje në nivele të avancuara të arsimit nënkupton edhe që numri i viteve që shqiptarët do të arsimohen po rritet. Në vitin 2011, vitet e shkollimit ishin 13.8 vjet për një fëmijë 6 vjeçar në fillim të karrierës arsimore. Një 15 vjeçar mund të pritet që të qëndrojë mesatarisht 5.2 vjet në arsim.

9.6 SHËNDETI I TË RINJVE: ZGJEDHJE KRITIKE

Gjatë adoleshencës dhe viteve të të rinjve të rritur, janë bërë shumë zgjedhje që përfshijnë miratimin e stileve specifike të jetës. Këto, nga ana e tyre, janë njësoj të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien, jo vetëm gjatë fazës së jetës të të rinjve, por edhe më vonë gjatë jetës.

Studimi Shqiptar për Demografinë dhe Shëndetin (ADHS) 2008-09 tregon që gjatë viteve të fazës së jetës së të rinjve, duhan pirja rritet shpesh, edhe pse ka një dallim të madh ndërmjet meshkujve dhe femrave. Më shumë se gjysma e meshkujve (54 përqind) të moshës 25 deri në 29 vjeç në vitin 2008-09 krahasuar me 10 përqind të femrave në atë grup moshë. Norma e duhan pirjes për të rinjtë është 30 përqind për meshkujt dhe 5 përqind për femrat. Gjithashtu, meshkujt kanë filluar duhan pirjen më herët dhe kanë qenë duhan pirës më të mëdhenj se femrat. Krahasuar me duhan pirjen, përdorimi i alkoolit nga të rinjtë përgjithësisht duket se nuk është problem. Vetëm 2 përqind e të rinjve kanë thënë që pinë alkool çdo ditë.

Faktorët e riskut si duhan pirja, abuzimi me alkool, kanë ndikim të madh në rritjen e vërejtur në barrën totale të sëmundjeve jo të transmetueshme si kanceri, sëmundje të zemrës, mëlçisë dhe mushkërive. Parandalimi i të rinjve shqiptarë nga duhan pirja dhe abuzimi me alkool dhe dieta e pashëndetshme dhe promovimi i aktivitetit të tyre fizik janë sfidat kryesore. Sëmundshmëria dhe vdekshmëria që lidhen me këto zgjedhje të stilit të jetesës shpesh përjetohen vetëm më vonë gjatë jetës. Shkaqet e vdekjes të të rinjve janë më së shumti shkaqe të jashtme (56 përqind), si për shembull dëmtime, helmime dhe aksidente.

Të rinjtë gjithashtu përballen me zgjedhje të rëndësishme për shëndetin riprodhues. Në këtë drejtim, duhet të vërehet që rënia e lindshmërisë nën nivelin e zëvendësimit është arritur gjerësisht në mungesë të përdorimit të kontraceptivëve modernë. Shumica e çifteve kanë rregulluar shtatzëninë dhe lindjen duke u bazuar në metodat tradicionale të kontracepsionit- sidomos tërheqja- dhe aborti. ADHS 2008-09 gjen që mes grave të martuara të grup moshës 15 deri në 29 vjeç, vetëm 12 përqind kanë përdorur kontracepsionin modern. Përdorimi nga gra të pamartuara seksualisht aktive ka qenë më i madh me 29 përqind. Arsyeja më e rëndësishme për mospërdorimin e kontraceptivëve nga gratë janë arsyet shëndetësore ose frika e pasojave anësore (45 përqind) dhe kundërshtimi ndaj përdorimit të kontraceptivëve (ose nga gruaja vetë ose nga partneri i saj) (33 përqind). Rrjedhimisht, prezervativët janë metoda më e preferuar e kontracepsionit. Në këtë fushë të pasojave shëndetësore të kontraceptivëve, duket e nevojshme dhënia e informacionit më të detajuar dhe formimit për këto çështje.

7 mijë aborte të regjistruara në vitin 2011 nënkuptojnë një raport mjaft të lartë të aborteve: për çdo një mijë lindje të gjalla në vitin 2011, ka pasur 205 aborte dhe një në gjashtë shtatzëni ka përfunduar me abort. Megjithatë, kjo shifër është shumë e ulët sesa ajo e 1994 kur kanë ndodhur 434 aborte për çdo njëmijë lindje.

Shqipëria konsiderohet akoma vend me prevalencë të ulët të HIV me 699 individë të diagnostikuar me HIV në vend në fund të 2013. Informacioni në dispozicion tregon që prevalenca HIV është 0.02 përqind dhe incidenca HIV është 0.004 përqind. Këto shifra janë shumë më të ulëta sesa normat përkatëse për Europën Perëndimore dhe Qendrore. Megjithatë, numri aktual i çështjeve në Shqipëri besohet se është më i lartë sesa shifrat e raportuara, sidomos për rastet e pa raportuara ose të pa diagnostikuara mes meshkujve që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj, atyre që injektojnë droga dhe punëtorëve të seksit. Të dhënat sugjerojnë që shumica e atyre që jetojnë me HIV në Shqipëri nuk ka dijeni për infeksionin që kanë dhe kështu mund të transmetojnë në mënyrë aktive virusin dhe të paraqiten më vonë për trajtim dhe kujdes. Gjithashtu, statistikat e ISHP tregojnë një tendencë në rritje të infeksioneve të reja. Në vitin 2013, janë regjistruar 123 raste të reja me HIV, shifra më e lartë e raportuar që në regjistrimin e filluar e vitit 1993. Edhe pse shumica e të rinjve në Shqipëri kanë dëgjuar për HIV/AIDS, informacioni i saktë për parandalimin e infeksionit është më pak i përhapur në 2008-09 dhe informacioni gjithëpërfshirës për transmetimin e HIV dhe AIDS mes të rinjve është raportuar në vetëm 22 për meshkuj dhe 36 përqind për femra.

Censusi i vitit 2011 identifikon rreth 11 mijë të rinj me aftësi të kufizuara, 8 përqind të të gjithë personave me aftësi të kufizuara në vend. Numri i personave të rinj me aftësi të kufizuara nënkupton që disi më pak se një në çdo 100 të rinj ka pasur probleme serioze të kryerjen e detyrave të përditshme, për shkak të probleme funksionale me të parin, dëgjimin, lëvizjen, kujdesin për veten, të kuptuarin dhe komunikimin.

9.7 NDRYSHIMI NË STRUKTURËN E NjEF-ve

Ndryshimi demografik dhe social ka pasur ndikim në strukturën e NjEF-ve të të rinjve. Përgjithësisht, njësitë ekonomike familjare janë më të vogla sidomos për shkak të numrit më të vogël të fëmijëve dhe NjEF-ve me një bërthamë. Gjithashtu, përqindja e personave që nuk jetojnë në bërthama familjare - atyre që jetojnë në NjEF me një person ose që jetojnë me persona pa lidhje familjare me ata - fiton epërsi sidomos në grupmoshën e të rinjve 20-24 vjeçarë. Këto njësi ekonomike familjare shpesh përbëhen nga studentë dhe të rinj që janë larguar nga shtëpia e prindërve, por që nuk janë lidhur akoma në martesë dhe nuk kanë filluar familjen e tyre. Të rejat kanë prirje të jetojnë më shpesh të pavarura sesa meshkujt, ose si pjesë e një njësie ekonomike jo-familjare ose si të pamartuara ose kryefamiljare të ve.

Periudha e të rinjve shpesh shënon një nga tranzicionet më të rëndësishme në jetën e njerëzve në Shqipëria: martesa. Të dhënat e censusit 2011 tregojnë që në moshën 29 vjeçare, më shumë se gjysma e meshkujve (55 përqind) dhe tre të katërtat e femrave (76 përqind) janë lidhur në martesë gjatë rinisë. Dallimi gjinor në përqindjen e të martuarve shkaktohet nga një diferencë relativisht e madhe në moshën e martesës së parë: një burrë martohet mesatarisht në moshën 29 vjeç dhe një grua në moshën 25 vjeç.

Edhe pse për standardet europiane këto janë shifra relativisht të larta, ato shënojnë një rënie të rëndësishme krahasuar me censusin e vitit 2001. Në këtë kohë, përqindja e të martuarve në moshën 29 vjeç ka qenë 71 për meshkuj dhe 85 për femra. Kjo shtyrje e martesës ndoshta është e lidhur me vazhdimësinë e arsimit, zhvillimet në gjetjen e një pune të përshtatshme në tregun e punës dhe ndikimit të përvojave të migracionit gjatë fazës së jetës të të rinjve të rritur. Gjithashtu ka tregues që përqindje në rritje e personave zgjedhin të mos martohen dhe që parimi i martesës universale po sfidohet.

Norma e divorceve mes të rinjve është e ulët, më së shumti sepse janë ekspozuar ndaj rrezikut të divorcit për një kohë shumë të shkurtër. Megjithatë, norma e divorcit të të rinjve të moshës 25 dhe 29 vjeç është më shumë se dyfishuar në periudhën e fundit ndërmjet censuseve, një tendencë që pritet të forcohet nisur nga përvoja e vendeve të tjera europiane.

9.8 KUSHTET E JETESËS: DUKE U PËRMIRËSUAR, POR PËRSËRI TË KËQIJA

Përgjithësisht, kushtet materiale të jetesës të të rinjve shqiptarë janë përmirësuar gjatë dekadave të fundit, edhe pse sipas standardeve europiane, kushtet janë të këqija. Sipas të dhënave të Anketës për Matjen e Nivelit të jetesës 2012, rreth 15 përqind e të rinjve të moshës 15 deri në 29 vjeç jetojnë në kushte që janë të pamjaftueshme për të prodhuar nivelin minimal të mirëqenies materiale. Edhe pse nuk ka në dispozicion statistika të krahasueshme me të shkuarën, ka mundësi që përqindja e të varfërve të ketë rënë krahasuar me dekadat e mëparshme. Të paktën, zotërimi i pajisjeve afatgjata në shtëpi me pjesëtarë të rinj është rritur ndjeshëm ndërmjet censusit 2001 dhe 2011, jo vetëm për lloje të reja të pajisjeve, si kondicioner dhe kompjuter, por edhe për pajisje më të zakonshme si frigoriferi, makina larëse dhe makinat. Në vitin 2012, 22 përqind e të rinjve kanë jetuar në njësi ekonomike familjare ku kanë pasur një kompjuter dhe 13 përqind në shtëpi me lidhje interneti.

Sa i përket karakteristikave kyç të cilësisë së strehimit, përmirësimi thelbësor është arritur në lidhje me aksesin në ujë rrjeti dhe tualet të përshtatshëm. Ndërsa në vitin 2001 vetëm 40 përqind e të rinjve kanë jetuar në njësi ekonomike familjare që ka ujë rrjeti në banesë, në vitin 2011 kjo përqindje është rritur në 62 përqind. Po kështu, popullsia e të rinjve me akses në tualet me ujë të rrjedhshëm është rritur në periudhën ndërmjet censuseve nga 65 në 92 përqind. Përqindja e të rinjve që jetojnë në banesë të mbipopulluar- me tre ose më shumë persona në dhomë - ka rënë nga 26 në 9 përqind.

Një zhvendosje e dallueshme ka ndodhur në statusin e zotërimit të banesës me kryefamiljar të ri, një ndryshim që ndoshta lidhet me urbanizimin: përqindja e njësive ekonomike familjare të të rinjve që kanë marrë me qira banesën e tyre është rritur nga 7 përqind në vitin 2001 në 23 përqind në vitin 2011.

ANEKSI I

Koncepte dhe përkufizime

Punëtorë kontribues në familje. Ata punëtorë që janë të vetë-punësuar në një aktivitet të orientuar nga tregu të ngritur nga një person i afërm që jeton në të njëjtën njësi ekonomike familjare, i cili nuk mund të konsiderohet partner, sepse shkalla e tyre e angazhimit në funksionimin e aktivitetit, sa i përket kohës së punës ose faktorëve të tjerë që duhet të përcaktohen nga rrethanat kombëtare, nuk është në nivel të krahasueshëm me atë të drejtuesit të aktivitetit.

Banesë. Censusi bën dallimin ndërmjet dy llojeve kryesore të banesave: ndërtesë për qëllime banimi dhe ndërtesë për qëllime jo banimi. Ndërtesat për qëllime banimi përkufizohen si dhoma të pavarura ose suita me dhoma dhe pjesët e tjera (për shembull, salla, korridore) në një ndërtesë të përhershme ose pjesë të ndara të asaj strukture të cilat, nga mënyra si janë ndërtuar, rindërtuar ose transformuar, janë projektuar për banim gjatë gjithë vitit. Shtëpitë dhe apartamentet janë shembuj të zakonshme të banesave.

Disa njësi strehimi nuk përfshihen plotësisht në kategorinë e "ndërtesave për qëllime banimi", ose për shkak se janë të lëvizshme, gjysmë-të përhershme ose të improvizuara, ose nuk janë projektuar për banim të përhershëm nga njeriu, por që sidoqoftë janë përdorur në census si vendbanime të zakonshme të një ose më shumë personave.

Arritje arsimore. Niveli më i lartë i përfunduar me sukses në sistemin arsimor të vendit ku është ofruar arsimi, edhe nëse arsimi është kryer në shkolla dhe universitete jashtë vendit.

Të punësuar. Të gjithë personat që gjatë javës së referencës, (1) kanë punuar për pagesë ose përfitim, ose (2) nuk kanë punuar, por kanë pasur punë prej të cilave janë larguar përkohësisht për shkak të lejes së lindjes, sëmundjeve ose paaftësisë së përkohshme për të punuar, trajnimit të lidhur direkt me punën e tyre aktuale etj.

Raporti punësim me popullsi. Përqindja e popullsisë në moshë pune që është e punësuar.

Indeksi i barazisë gjinore (ndjekja e arsimit). Raporti i numrit të studenteve femra që ndjekin arsimin fillor, dytësor dhe të lartë me numrin e studentëve meshkuj në çdo nivel (bazuar në normat bruto të regjistrimit).

Norma Bruto e Regjistrimit. Numri i studentëve të regjistruar në një vend në një nivel arsimi, pavarësisht moshës, të shprehur si një përqindje e popullsisë në grupmoshën zyrtare që i korrespondon këtij niveli arsimi.

Kryefamiljari. Personi që konsiderohet kreu i familjes nga pjesëtarët e njësisë ekonomike familjare. Zakonisht është fitimprurësi kryesor i të ardhurave dhe vendimmarrësi për njësinë ekonomike familjare.

Indeksi i varfërisë. Përqindja e popullsisë me shpenzime mujore për konsum për frymë nën linjën e varfërisë.

Njësi ekonomike familjare. Një grup personash, të lidhur ose të palidhur mes tyre, që jetojnë së bashku si një njësi e vetme në kuptimin që ata janë të sistemuar së bashku në familje, pra ndajnë ose mbahen me një buxhet të përbashkët. Ata jetojnë së bashku, bashkojnë të ardhurat dhe konsumojnë të paktën një vakt së bashku çdo ditë.

Popullsi inaktive ose persona që nuk janë në forcën e punës. Të gjithë personat, që gjatë javës së referencës, as nuk kanë qenë të punësuar as të papunë, si për shembull nxënësit/studentët, kujdestarët e shtëpive, personat e dalë në pension, personat me aftësi fizike, të papunët e pa inkurajuar etj.

Forca e punës. Popullsia ekonomikisht aktive - të punësuarit dhe të papunët- në moshë pune (15-64)

Shkalla e pjesëmarrjes së forcës së punës. Raporti i forcës së punës me popullsinë e moshës së punës (15-64) i shprehur si përqindje.

Alfabetizmi. Aftësia për shkrim e këndim. Një person që mund të lexojë dhe të shkruajë një deklaratë të shkurtër, të thjeshtë për jetën e tij të përditshme nuk është analfabet.

Papunësia afatgjatë. Papunësia që zgjat 12 muaj ose më shumë.

Shkalla e papunësisë afatgjatë. Numri i persona të papunësuar për 12 muaj ose më shumë si përqindje e forcës së punës në të njëjtën periudhë.

Norma neto e regjistrimit. Numri i nxënësve të grupit me moshë shkolle për një nivel të caktuar arsimi, të shprehura në përqindje të gjithë popullsisë në atë grupmoshë.

Profesioni. Disa punë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore për të cilat karakterizohen nga një shkallë e lartë ngjashmërie. Personat klasifikohen sipas profesionit nëpërmjet marrëdhënies së tyre me një pune në të shkuarën, të tashmen ose të ardhmen.

Punëtor për llogari të vet. Ata punëtorë që punojnë për llogari të tyre ose me një ose më shumë partnerë kanë llojin e punës të përkufizuar si vetëpunësim dhe nuk kanë përfshirë vazhdimisht punëtorë që të punojnë për ata gjatë periudhës së referencës.

Boshllëku i varfërisë. Distanca mesatare ndërmjet niveleve të konsumit të të varfërve dhe linjës së varfërisë.

Ndjekja e shkollës. Ndjekja rregullisht e një institucioni ose programi arsimor të akredituar, privat ose publik, për mësimdhënien e organizuar në çdo nivel të shkollimit.

Statusi në punësim. Statusi i një personi ekonomikisht aktiv në lidhje me punësimin e tij ose të saj, ose llojin e kontratës së punësimit të shprehur apo të nënkuptuar me persona ose organizata të tjera që ka personi në punën e tij/saj.

Indeksi Sintetik i Fekonditetit. Indeksi Sintetik i Fekonditetit është numri mesatar i fëmijëve që do të lindë gjallë një grua gjatë gjithë jetës së saj në qoftë se ajo do t'i kalonte vitet e saj të riprodhimit në përputhje me koeficientet e lindshmërisë të një viti të dhënë.

Të nënpunësuar. Personat e punësuar në moshë pune, që kanë punuar gjatë javës së referencës 35 orë ose më pak në të gjitha llojet e punëve, dhe që janë të gatshëm të punojnë më shumë orë.

Të papunë. Të gjithë personat në moshë pune që gjatë javës së referencës

- as nuk kanë pasur punë as nuk kanë qenë në punësim (për një orë ose më shumë) të paguar ose të vetë-punësuar, dhe
- kanë qenë në kërkim të punës në mënyrë aktive, dhe
- kanë qenë në dispozicion për punë.

Shkalla e papunësisë. Numri i të papunëve si përqindje e forcës së punës.

Moshë pune. Mosha 15 deri në 64.

Raporti i varësisë së të rinjve. Raporti ndërmjet numrit të të rinjve nën 15 vjeç me numrin e personave në moshë më produktive të grupmoshës 15-64, i shprehur në përqindje.

Të rinjtë. Popullsia e grupmoshës 15-29 vjeç.

Shkalla e alfabetizmit të të rinjve. Përqindja e personave të grupmoshës 15-24 që dinë shkrim e këndim.

ANEKS II

Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Statistikave të Arsimit (ISCED)

Klasifikimi ndërkombëtar Standard i Statistikave të Arsimit (ISCED) është instrument i përshtatshëm për të mbledhur, përpunuar dhe paraqitur statistikave të krahasueshme dhe tregues për arsimin. Ai paraqet koncepte standarde, përkufizime dhe klasifikime dhe mbulon të gjitha mundësitë e organizuara dhe të miratuara të të mësuarit për fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit përfshirë arsimin për nevoja të veçanta, pavarësisht institucionit ose subjektit që e ofron ose formës në të cilën ofrohet.

NIVELI 0 — Program parashkollor: programe në nivelin 0 (parashkollor) të përkufizuara si faza fillestare e mësimdhënies së organizuar të hartuara kryesisht për të prezantuar fëmijët e vegjël me një mjedis të përafërt me shkollën pra për të siguruar urën ndërmjet ambientit shtëpiak dhe atij shkollor. Me përfundim të këtyre programeve, fëmijët vijojnë shkollimin në nivelin 1 (arsimi fillor).

NIVELI 1 — Arsimi fillor ose faza e parë e arsimit bazë: programet në nivelin 1 janë hartuar në bazë të mësimit ose projektit për t'i dhënë nxënësit njohuritë bazë për lexim, shkrim dhe matematikë së bashku me të kuptuarin elementar të lëndëve të tjera si histori, gjeografi, shkenca natyrore, shkenca sociale, art dhe muzikë. Në disa raste, përfshihet edhe orientimi fetar.

NIVELI 2 — Faza e dytë ose dytësore e ulët e arsimit bazë: përmbajtja e arsimit në këtë fazë është hartuar veçanërisht për të plotësuar ofrimin e arsimit bazë i cili filloi në nivelin 1 të ISCED. Në shumë për të mos thënë në të gjitha vendet, qëllimi i arsimit është të ngrejë themelin për të mësuarin gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e njerëzimit mbi të cilin vendet mund të zgjerojnë, në mënyrë sistematike, mundësitë e mëtejshme arsimore. Programet në këtë nivel zakonisht ndjekin një model të orientuar më shumë drejt lëndës duke përdorur mësues të specializuar dhe më shpesh disa mësues e zhvillojnë orën e mësimit në fushën e tyre të specializimit. Përfundimi i këtij niveli shpesh përputhet me përfundimin e arsimit të detyruar nëse ekziston.

NIVELI 3 — Arsimi i mesëm: ky nivel i arsimit fillon në përfundim të arsimit të detyruar me kohë të plotë në ato vende që kanë sistemin e arsimit të detyruar. Në këtë nivel vërehet më shumë specializim sesa në nivelin 2 të ISCED dhe shpesh mësuesit duhet të jenë më shumë të kualifikuar ose të specializuar sesa në nivelin 2 ISCED. Mosha e pranimit në këtë nivel është 15 ose 16 vjeç. Programet e mësimdhënies të përfshira në këtë nivel kërkojnë përfundimin e arsimit të plotë nëntë vjeçar (që me fillimin e nivelit 1), për pranim ose kombinimin e arsimit dhe përvojës profesionale ose teknike me përfundimin e nivelit 2 si kërkesë minimale për pranim ose aftësinë e provuar për të kryer programet e këtij niveli.

NIVELI 4 — Arsimi jo i lartë pas arsimit dytësor Niveli 4 i ISCED përfshin programet që ndajnë kufirin ndërmjet arsimit dytësor të lartë dhe arsimit pas arsimit dytësor nga këndvështrimi ndërkombëtar, edhe pse qartazi mund të konsiderohen si programe të arsimit dytësor të lartë ose pas arsimit dytësor në kontekstin kombëtar. Programet e nivelit 4 të ISCED nisur nga përmbajtja e tyre nuk mund të konsiderohen si programe të larta. Shpesh ato nuk janë më të avancuara sesa programet e nivelit 3 ISCED, por shërbejnë për të zgjeruar njohuritë e pjesëmarrësve që kanë përfunduar tashmë një program në nivelin 3.

NIVELI 5 — Faza e parë e arsimit të lartë (nuk çon direkt në kualifikim kërkimor të avancuar): ky nivel konsiston në programe të larta që kanë përmbajtje arsimore më të avancuar sesa ato të nivelin 3 dhe 4. Pranimi në këto programe normalisht kërkon përfundimin me sukses të nivelit 3A ose 3B të ISCED ose një kualifikim të ngjashëm të nivelit 4A të ISCED. Të gjitha diplomat dhe kualifikimet janë klasifikuar sipas llojit të programeve, pozicionit në diplomën kombëtare ose strukturat e kualifikimit (shihni më poshtë) dhe kohëzgjatja kumulative e arsimit të lartë. Ka një dallim ndërmjet programeve që bazohen në teori/përgatitje kërkimore (histori, filozofi, matematike etj) ose që japin akses në profesione me kërkesa për kualifikim të lartë (psh mjekësi, stomatologji, arkitekturë etj) dhe programeve që janë praktike/teknike/specifike për profesionin. Lloji i parë quhet 5A, i dyti 5B.

NIVELI 6 — Faza e dytë e arsimit të lartë (që çon në një kualifikim të avancuar kërkimor): ky nivel është i rezervuar për programet të larta që çojnë në një kualifikim të avancuar kërkimor. Programet i kushtohen studimit të avancuar dhe kërkimit origjinal dhe nuk bazohen vetëm në punën gjatë kursit.

REFERENCA

- BBloom, D.E., D. Canning and J. Sevilla 2003. The demographic dividend: a new perspective on the economic consequences of population change. RAND Population Matters Program MR-1274, Santa Monica CA.EC (2013), Working together for Europe's young people. A call to action on youth unemployment. Brussels, EC.
- Carletto, G., Davis, B., Stampini, M. and Zezza, A. 2006. A country on the move: international migration in post-communist Albania. *International Migration Review*, 40(4): 767-85.
- Eurostat (2009), *Të rinjvë në Europë*. Luksemburg, Eurostat. http://eapyouth.eu/sites/default/files/documents/eurostat_2009_report.pdf
- Eurostat (2011), 6.5% e popullsisë së BE-së janë të huaj dhe 9.4% kanë lindur jashtë vendit. *Statistikat në fokus,* 34/2011.
- Eurostat (2015a), Punësimi i të rinjve, Statistikat e 2012. të shpjeguara http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/ - Accessed 23/06/2015
- Eurostat (2015b), Struktura dhe plakja e popullsisë http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Population_structure_and_ageing Accessed 15/08/2015
- Eurostat (2015c), Statistika të arsimit të lartë. http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Tertiary_education_statistics Accessed 20/08/2015.
- Eurostat (2015d), Regjistrimi në shkollë dhe ata që braktisin arsimin dhe formimin përpara kohe http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/School_enrolment_and_early_leavers_from_education_and_training - Accessed 20/08/2015
- Eurostat (2015e), *Të jesh i ri në Europë sot*. Botimi 2015. Luksemburg, European Union.
- Eurostat (2015f), *Cilësia e jetës, Fakte dhe këndvështrime*. Luksemburg, Eurostat.
- Ferré, C., E. Galanxhi and O. Dhono (2015), *Profili i Popullsisë me aftësi të kufizuara në Shqipëri*. Tiranë, UNDP.
- Gjonca, A., A. Aassve dhe L. Mencarini 2008. *Shqipëria: Tendenca dhe modele, përcaktues të përafërt dhe politikat e ndryshimit të fertilitetit*. Studim Demografik 19(11): 261-292.
- ICLS (1982), *Resolution concerning statistics of the economically active population, employment, unemployment and underemployment, adopted by the Thirteenth International Conference of Labour Statisticians*. Geneva, ILO.
- ILO (2008), *Child labour statistics. Report III. 18th International Conference of Labour Statisticians Geneva*, 24 November–5 December 2008. ILO Geneva.
- ILO (2012), *The youth employment crisis: time for action*. Geneva, ILO.
- ILO dhe INSTAT (2012), Working children in the Republic of Albania. The results of the 2010 National Child Labour Survey. Geneva, ILO.
- ILO (2014a), *Key Indicators of the Labour Market*. Eighth edition. Geneva, ILO.
- ILO (2014b), *Skills mismatch in Europe*. Geneva, ILO.
- INSTAT (2004), *Projeksione të popullsisë për Shqipërinë 2001-2021*. INSTAT, Tiranë.
- INSTAT (2010), *Studimi Shqiptar mbi Demografinë dhe Shëndetin 2008-09*. INSTAT, Tiranë.
- INSTAT (2014a), *Tregu i punës 2013*. Tiranë, INSTAT.
- INSTAT (2014b), *Dinamika e tregut të punës në Shqipëri 2001-2011*. Tiranë, INSTAT.
- INSTAT (2014c), *Popullsia dhe dinamika e popullsisë në Shqipëri. Horizonte të reja demografike?* Tiranë, INSTAT.

- INSTAT (2014d), *Projeksione të popullsisë në Shqipëri 2011-2031*. Tiranë, INSTAT.
- INSTAT (2014e), *Migracioni në Shqipëri*. Tiranë, INSTAT.
- INSTAT (2015), *Gra dhe burra në Shqipëri 2015*. Tiranë, INSTAT.
- INSTAT dhe IOM (2014), *Migracioni i kthimit dhe riintegrimi në Shqipëri*. Tiranë, INSTAT.
- INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF Macro (2010), *Studimi shqiptar mbi Demografinë dhe Shëndetin 2008-09*. Tiranë, INSTAT.
- Instituti i Shëndetit Publik (2014a), *Buletini i Shëndetit Nr. 1 2014*. Tiranë, Instituti i Shëndetit Publik.
- Instituti i Shëndetit Publik (2014b), *Raporti Kombëtar i Shëndetit. Tiranë*, Instituti i Shëndetit Publik.
- Lesthaeghe, R. 2010. *The Unfolding Story of the Second Demographic Transition. Population and Development Review 36(2)*: 211-251.
- Lesthaeghe, R., L. Neidert and J. Surkyn (2007), Household Formation and the "Second Demographic Transition" in Europe and the US: Insights from Middle Range Models.
- Ministria e Shëndetit (2015), *Dokument politik i strategjisë shqiptare për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve alkool-lidhura* (2011-2015). Tiranë, Ministria e Shëndetësisë.
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2014), Progame të Nxitjes së Punësimit në Shqipëri: Vlerësim i cilësisë në formulim dhe proceset e zbatimit (2008-2014).
- Pipero, P., A. Ylli, E. Gjebrea, A. Spaho, J. DaVanzo, M. Pipero (2015), Sjellje të rrezikshme për shëndetin mes të rinjve shqiptarë: Duhanpirja, Alkooli, Indeksi i Masës Trupore (BMI) Lidhja mes tyre. *International Journal of Science and Research*, Vol. 4, No. 1, pp. 846-855.
- UNAIDS dhe Instituti i Shëndetit Publik (2003), *Le të mbajmë Shqipërinë një vend me prevalencë të ulët të HIV. Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kontrollin e HIV/AIDS në Shqipëri 2004 – 2010*.
- UN-HABITAT (2007), *The state of the world's cities 2006-7*. London, Earthscan.
- UNICEF (1999), *An Overview of Young People Living ëith Disabilities: Their needs and their rights*. New York, UNICEF
- UNICEF (2006), S*HQIPËRIA Adoleshentët dhe të rinjtë më të rrezikuar, HIV dhe përdorimi i substancave Raport i Misionit për Vendin*. UNICEF Romenia.
- UNICEF, UNAIDS and WHO (2002): *Young people and HIV/AIDS Opportunity in Crisis.*
- Van de Kaa, D.J. 1987. Europe's Second Demographic Transition. *Population Bulletin*, 42(1), Population Reference Bureau, Washington (D.C.).
- WHO (2012), *HIV/AIDS Country Profiles*, 2011. Geneva, ILO.
- WHO (2015a), HIV Programme Review in Albania: Antiretroviral therapy and procurement and supply management. Copenhagen, WHO.
- WHO (2015b), *WHO global report on trends in prevalence of tobacco smoking 2015*. Geneva, ILO. http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/156262/1/9789241564922_eng.pdf.
- Banka Botërore 2007. *Shqipëria: Zhvillimi Urban, migracioni dhe ulja e varfërisë: Vlerësim i varfërisë*. Raporti Nr. 40071- AL. Tiranë, Banka Botërore.
- World Vision dhe UNFPA (2012), *Sex imbalances in Albania*. UNFPA, Tirana.

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Bul. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri
Tel: +(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
Fax: +(355) 4 2228300
E-mail: info@instat.gov.al
Web: www.instat.gov.al

ISBN 978-9928-188-34-2
9 789928 188342